FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 120

Tiranë – E premte, 30 korrik 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 81/2021, datë 24.6.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar	12167
Ligj nr. 82/2021, datë 24.6.2021	Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar	12170
Ligj nr. 83/2021, datë 24.6.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për projektin e rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë–Orikum)	12183
Ligj nr. 84/2021, datë 24.6.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2019, për projektin "Transport i qëndrueshëm në Tiranë (DKTI)"	12196
Ligj nr. 92/2021, datë 1.7.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për linjën e kredisë për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave	12198
Dekret i Presidentit nr. 13167, datë 26.7.2021	Për shpallje ligji	12213
Ligj nr. 93/2021, datë 1.7.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri – faza I	12213
Dekret i Presidentit nr. 13168, datë 26.7.2021	Për shpallje ligji	12225

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 30.6.2021	Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe procedurat e përjashtimit të tyre.....	12225
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 279, datë 14.7.2021	Për rregullat dhe mënyrat e zbatimit të sanksioneve administrative për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit.....	12243
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 13, datë 9.7.2021	Për organizimin dhe zhvillimin e sesionit të dytë të provimeve të maturës shtetërore 2021 dhe të maturës shtetërore profesionale 2021....	12255
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 183/4, datë 20.5.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar.....	12256
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 183/5, datë 14.6.2021	Për një ndryshim dhe disa shtesa në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar.....	12256
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 349, datë 26.7.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar.....	12257
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 134, datë 21.7.2021	Për ndryshimin e referencës ligjore në standardet kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara.....	12257
Urdhër i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 139, datë 29.7.2021	Për delegim kompetencash.....	12265
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilir Ndini.....	12265

LIGJ
Nr. 81/2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 102/2015, "PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas pikës 13 shtohen pikat 13/1 dhe 13/2 me këtë përmbajtje:

"13/1. "Gaz Natyror i Lëngëzuar" (GNL) është gazi metan CH4, i cili kthehet në lëng në presionin 1 atm dhe temperaturë minus 161 gradë celsius.

13/2. "Gaz Natyror i Komprimuar" (GNK) është gazi metan CH4, i cili komprimohet në presionin 200 atm.".

2. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1 me këtë përmbajtje:

"17/1. "Impiant me përmasa të vogla" është njësia lëvizëse që përdoret për prodhimin/ depozitimin, transportimin dhe/ose shpërndarjen e sasive të vogla të GNL-së dhe/ose GNK-së.".

3. Pas pikës 38 shtohet pika 38/1 me këtë përmbajtje:

"38/1. "Klient i mbrojtur në kuadrin e solidaritetit" është klienti familjar i cili është i lidhur me një rrjet shpërndarjeje të gazit dhe gjithashtu përfshin një ose të dyja rastet e mëposhtme:

a) instalimi i ngrohjes qendrore nëse është një "klient i mbrojtur" në vend dhe vetëm në atë masë që u shërben klientëve familjarë ose shërbimeve themelore sociale, përveç arsimit dhe shërbimeve të administratës publike;

b) një shërbim thelbësor shoqëror nëse është një "klient i mbrojtur" në vend, përveç arsimit dhe shërbimeve të administratës publike.".

Neni 2

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6
Siguria e furnizimit me gaz natyror

1. Ministria përgjegjëse për energjinë, pasi konsultohet me shoqëritë e gazit natyror, organizatat përkatëse që përfaqësojnë interesat e klientëve të gazit, familjarë dhe industrialë, përfshirë prodhuesit e energjisë elektrike, operatorët e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, në rastet e deklarimit të një gjendjeje krize në furnizimin me gaz natyror sipas përcaktimeve të nenit 6/1 të ligjit, harton:

a) një plan veprimi parandalues, që përmban masat e nevojshme për të eliminuar ose zbutur rreziqet e identifikuara, duke përfshirë efektet nga zbatimi i eficiencës së energjisë dhe masat e nxitjes së kërkesës në vlerësimet e rrezikut të zakonshëm dhe kombëtar dhe në përputhje me përcaktimet e pikave 3 dhe 4 të këtij neni;

b) një plan emergjence që përmban masat që duhen marrë për të eliminuar ose zbutur ndikimin e një ndërprerjeje të furnizimit me gaz në përputhje me përcaktimet e pikave 3 dhe 5 të këtij neni.

2. Masat për të garantuar sigurinë e furnizimit me gaz që përmban një plan veprimi parandalues dhe një plan emergjence duhet të përcaktohen qartë, në mënyrë transparente, proporcionale, jodiskriminuese, të verifikueshme, të mos shtrembërojnë padrejtësisht konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit dhe të mos rrezikojnë sigurinë e furnizimit me gaz të vendeve që janë palë e Komunitetit të Energjisë ose të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton:

a) planin e emergjencës të hartuar sipas pikës 1 të këtij neni, në të cilin përcaktohen standardet minimale të sigurisë së furnizimit me gaz natyror, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm;

b) planin e veprimit parandalues, të hartuar sipas pikës 1 të këtij neni, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme për të eliminuar ose zbutur rreziqet e identifikuara në sigurinë e furnizimit me gaz natyror, por edhe standardet minimale të sigurisë së furnizimit me gaz natyror, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm.

4. Plani i veprimit parandalues përmban:

a) një përshkrim të efekteve të masave të përfshira në plan për funksionimin e tregut të brendshëm të energjisë, përfshirë detyrimet e përmendura në shkronjën "c" të kësaj pike;

b)detyrimet e ndërmarrjeve të gazit natyror dhe organeve të tjera përkatëse, që mund të ndikojnë në sigurinë e furnizimit me gaz;

c) informacion mbi të gjitha detyrimet e shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit me gaz;

ç)masat, vëllimet dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur standardin e infrastrukturës dhe standardin e furnizimit me gaz;

d) masa të tjera parandaluese të programuara për të adresuar rreziqet e identifikuara në vlerësimin e rrezikut, siç janë ato që lidhen me nevojën:

i. për të forcuar ndërlidhjet midis vendeve palë të Komunitetit të Energjisë;

ii. për të përmirësuar më tej efikasitetin e energjisë dhe për të zvogëluar kërkesën për gaz;

iii. për të diversifikuar rrugët e gazit, burimet e furnizimit me gaz dhe përdorimin rajonal të kapaciteteve ekzistuese të depozitimit dhe të GNL-së, si dhe për të ruajtur sa më shumë furnizim me gaz sa të jetë e mundur për të gjithë klientët.

5. Plani i emergjencës përmban:

a) instrumentet dhe masat që garantojnë në mënyrë të saktë e të qartë furnizimin e klientëve të mbrojtur në rastet:

i. e një ndërprerjeje të pjesshme të furnizimit;

ii. e kushteve atmosferike ekstremisht të ftohta në periudhën e ngarkesës maksimale;

iii. kur ka kërkesë shumë të lartë për gaz gjatë periudhës më të ftohtë të dimrit.

b) programin për reduktimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të kategorive të veçanta të klientëve në rast krize;

c) rolin dhe përgjegjësitë e shoqërive të gazit natyror e të klientëve jofamiljarë, duke mbajtur parasysh shkallën në të cilën ata mund të jenë dëmtuar nga një krizë e mundshme në sektorin e gazit natyror;

ç) kërkesat për impiantet e depozitimit, me qëllim realizimin e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontributin e mundshëm të depozitës, kur kjo e fundit është në Shqipëri apo në ndonjë vend anëtar të Komunitetit të Energjisë;

d) masa dhe veprime të tjera, të cilat ndërmerren në mënyrë që të heqin ose të pakësojnë pasojat e ndërprerjes së furnizimit me gaz natyror, në varësi të shkallës së krizës.

6. Pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror planifikojnë dhe marrin masat për një furnizim të sigurt me gaz natyror, në përputhje me standardet, ashtu siç parashikohet në pikën 3 të këtij neni, si dhe janë përgjegjës për furnizimin me gaz natyror brenda qëllimit të veprimtarisë.

7. ERE është autoriteti përgjegjës për monitorimin e sigurisë së furnizimit.

8. Plani i veprimit parandalues dhe plani i emergjencës i vihen në dispozicion Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

9. Kur vendi ka një nivel të përshtatshëm të interkonjeksionit, ministria ose shoqëria përgjegjëse e gazit natyror mund të marrë masat e duhura në mënyrë që të arrihen standardet e sigurisë së furnizimit, duke përdorur impiantet e depozitimit të vendosura në territorin e palës tjetër kontraktuese. Për këtë qëllim mund të bashkëpunohet me autoritetet dhe/ose shoqëritë e gazit natyror të një vendi të BE-së ose të një pale tjetër të Komunitetit të Energjisë, përfshirë këtu lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe. Aplikimi i këtyre masave nuk duhet të pengojë funksionimin normal të tregut vendas.

10. Plani i veprimit parandalues dhe plani i emergjencave përditësohen çdo katër vjet ose më shpesh në rastet kur siguria e furnizimit me gaz vendoset në rrezik ose me kërkesë të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.".

Neni 3

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 6/1
Deklarimi i një gjendjeje krize në furnizimin me gaz natyror

1. Tri nivelet e gjendjes së krizës janë si më poshtë:

a) niveli i paralajmërimit të hershëm (paralajmërimi i hershëm), kur ka informacion konkret, serioz dhe të besueshëm se mund të ndodhë një ngjarje që ka të ngjarë të rezultojë në përkeqësim të konsiderueshëm të situatës së furnizimit me gaz dhe ka të ngjarë të çojë në alarm ose të shkaktojë nivelin e emergjencës. Niveli i paralajmërimit të hershëm mund të aktivizohet nga një mekanizëm i paralajmërimit të hershëm;

b) niveli i alarmit (alarmi), nëse ndodh një ndërprerje e furnizimit me gaz ose një kërkesë jashtëzakonisht e lartë për gaz, që përkeqëson seriozisht situatën e furnizimit me gaz, por tregu është ende në gjendje të menaxhojë atë ndërprerje ose kërkesë pa pasur nevojë të përdorë masa jo të bazuara në treg;

c) niveli i emergjencës (emergjenca), kur ka kërkesa jashtëzakonisht të larta për gaz, ndërprerje të konsiderueshme të furnizimit me gaz ose përkeqësim tjetër të rëndësishëm të situatës së furnizimit me gaz dhe të gjitha masat përkatëse të bazuara në treg janë zbatuar, por furnizimi me gaz nuk është i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesën e mbetur, kështu që duhet të futen masat shtesë jo të bazuara në treg me qëllim, në veçanti, për të mbrojtur furnizimet e gazit për klientët e mbrojtur në përputhje me standardet e furnizimit me gaz.

2.Ministria, pas marrjes së miratimit me vendim nga Këshilli i Ministrave, deklaron një nga nivelet e krizave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, si dhe autoritetet kompetente të vendeve palë të Komunitetit të Energjisë ose të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, me të cilat është e lidhur drejtpërdrejt dhe u transmeton atyre të gjitha informacionet e domosdoshme, në veçanti, për veprimet që synon të ndërmarrë.

3. Nëse ministria ka deklaruar një "emergjencë" dhe ka treguar se veprimi ndërkufitar është i nevojshëm, çdo rritje në standardin e furnizimit me gaz ose detyrime shtesë të imponuar për ndërmarrjet e gazit natyror reduktohet përkohësisht në nivelin e përcaktuar në planin e emergjencës.

Detyrimet e përmendura në paragrafin e parë të kësaj pike pushojnë së zbatuari menjëherë pasi ministria pas njoftimit dhe marrjes edhe të miratimit nga Këshilli i Ministrave deklaron përfundimin e gjendjes së "emergjencës", ose kur Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka dalë në konkluzionin se deklarimi i gjendjes së "emergjencës" nuk ekziston ose nuk është më e justifikuar.

4. Kur ministria pas njoftimit dhe marrjes së miratimit edhe nga Këshilli i Ministrave shpall një "emergjencë", ajo ndjek veprimet e paracaktuara në planin e emergjencës dhe menjëherë informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare me të cilat është e lidhur drejtpërdrejt, veçanërisht në lidhje me veprimet që ajo synon të ndërmarrë. Në rrethana të jashtëzakonshme e të justifikuara, ministria mund të ndërmarrë veprime që devijojnë nga plani i emergjencës të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ministria informon menjëherë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian me të cilat është e lidhur drejtpërdrejt, për veprime të tilla dhe e justifikon atë devijim.

5. Nëse ministria pas njoftimit dhe marrjes edhe të miratimit nga Këshilli i Ministrave deklaron përfundimin e një prej niveleve të krizave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, ajo informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian me të cilat është e lidhur drejtpërdrejt.".

Neni 4

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9
Bashkëpunimi rajonal dhe solidariteti

1. Për të garantuar një furnizim të sigurt në tregun e brendshëm të gazit natyror, ministria dhe autoritetet përgjegjëse vendase gjatë procesit të hartimit të vlerësimeve të rrezikut dhe planit të veprimit parandalues dhe planit të emergjencës bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse të vendeve fqinje, anëtare të BE-së, si dhe të palëve të tjera të Komunitetit të Energjisë për të nxitur

bashkëpunimin rajonal dhe dypalësh. Ky bashkëpunim mund të përfshijë, veçanërisht, identifikimin e bashkëveprimin e korrelacionit të rreziqeve dhe konsultimeve për të siguruar koherencën ndërkufitare të planeve të veprimit parandalues dhe planeve emergjente.

2. Nëse gjatë procesit të hartimit të vlerësimeve të rrezikut, të planit të veprimit parandalues dhe planit të emergjencës, për të garantuar një furnizim të sigurt në tregun e brendshëm të gazit natyror, kërkohet zbatimi i masës së solidaritetit me një vend që është palë e Komunitetit të Energjisë ose është shtet anëtar i Bashkimit Evropian, me të cilin është vendosur lidhja direkte me rrjetin e gazit natyror, ministria ose Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që furnizimi me gaz në të gjithë territorin e vendit për klientët, me përjashtim të "klientëve të mbrojtur në kuadër të solidaritetit", të zvogëlohet ose të mos vazhdojë në masën e duhur për sa kohë që furnizimi me gaz për "klientët e mbrojtur në kuadër të solidaritetit" nuk është i kënaqshëm.

Ministria dhe autoritetet e tjera përgjegjëse në zbatim të planit të veprimit parandalues dhe planit te emergjencës do të sigurojnë që vëllimi përkatës i gazit të shpërndahet në mënyrë efektive për klientët e mbrojtur në kuadër të solidaritetit në të gjithë territorin e vendit.

3.Në funksion të garantimit të një furnizimi të sigurt me gaz natyror, përfshirë edhe bashkëpunimin dhe solidaritetin rajonal, Shqipëria si palë e Komunitetit të Energjisë do të bashkërendojë veprimtaritë me vendet e tjera palë të Komunitetit të Energjisë, si dhe do të informojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për planin e veprimit parandalues dhe planin e emergjencës, si dhe për masën e solidaritetit, nëse një hap i tillë do të ndërmerret.".

Neni 5

Në nenin 22, në pikën 2, pas shkronjës "e" shtohen shkronjat "ë" dhe "f" me këtë përmbajtje:

"ë) operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla;

f) operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla.".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 24.6.2021.

LIGJ
Nr. 82/2021

PËR PËRKTHIMIN ZYRTAR DHE PROFESIONIN E PËRKTHYESIT ZYRTAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për organizimin e funksionimin e shërbimit të përkthimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë dhe për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e kushteve për mirëfunksionimin e shërbimit të përkthimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë, si dhe mbrojtjen e garantimin e ushtrimit të profesionit të përkthyesit zyrtar.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë përkthyesit zyrtarë në rastet kur kryejnë përkthim zyrtar në territorin e Republikës e Shqipërisë.

2. Ky ligj zbatohet edhe për interpretuesit e gjuhës së shenjave ose lehtësuesit e komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur e në të dëgjuar në rastet kur caktohen nga organet proceduese, sipas legjislacionit procedural në fuqi, ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Gjuha e burimit" është gjuha e prodhimit të një teksti ose dokumenti të shkruar nga i cili është kryer përkthimi në gjuhën e synuar;

b) "Gjuha e synuar" është gjuha në të cilën një tekst ose dokument i shkruar është përkthyer nga gjuha e burimit;

c) "Ministri" është ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;

ç) "Ministria" është ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;

d) "Përkthim zyrtar" është kalimi i kuptimit të një teksti, dokumenti zyrtar ose i një akti normativ të miratuar në Republikën e Shqipërisë, i një marrëveshjeje ndërkombëtare ose normave të nxjerra nga organizatat ndërkombëtare, me shkrim, nga gjuha e burimit në gjuhën e synuar, duke ruajtur plotësisht kuptimin e fjalisë dhe përmbajtjen e akteve të përkthyera. Përkthimi zyrtar përfshin edhe përkthimin me gojë, kur palët nuk dinë gjuhën shqipe, gjatë hetimit të një çështjeje penale, si dhe gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore civile, penale ose administrative, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese;

dh) "Përkthyes zyrtar" është personi që është certifikuar për kryerjen e veprimtarisë së përkthimit zyrtar dhe është regjistruar në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj;

e) "Interpretues ose interpret i gjuhës së shenjave" është personi i certifikuar për kryerjen e veprimtarisë së interpretimit të gjuhës së shenjave dhe i regjistruar në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj, i cili mundëson komunikimin me një person që nuk dëgjon dhe/ose nuk flet, pjesërisht ose plotësisht, nga gjuha e shenjave në gjuhën e folur dhe të shkruar shqipe, gjatë hetimit të një çështjeje penale, si dhe gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore civile, penale ose administrative, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese;"

ë) "Regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë" është baza e të dhënave shtetërore për të gjithë përkthyesit zyrtarë dhe për interpretët e gjuhës së shenjave shqipe, që përmban të gjithë informacionin për certifikimin, veprimtarinë e masat disiplinore në fuqi;

f) "Tarifat e përkthimit" janë tarifa profesionale për kryerjen e veprimtarisë së përkthimit zyrtar, në të cilat përcaktohet masa e shpërblimit në rastet kur kryhet shërbimi i përkthimit me shkrim ose me gojë, si dhe i interpretimit të gjuhës së shenjave.

Neni 5
Parimet

Përkthyesi zyrtar gjatë ushtrimit të profesionit udhëhiqet nga parimet bazë të profesionalizmit, të etikës, të integritetit, besnikërisë ndaj tekstit burimor, paanshmërisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, si dhe të mosdiskriminimit e të trajtimit të barabartë.

KREU II
SHËRBIMI I PËRKTHIMIT ZYRTAR

Neni 6
Shërbimi i përkthimit zyrtar

1. Shërbimi i përkthimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë kryhet vetëm nga përkthyesit zyrtarë të certifikuar në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Shërbimi i përkthimit zyrtar organizohet nën mbikëqyrjen e ministrit, i cili kujdeset e mbështet garantimin e këtyre shërbimeve me profesionalizëm dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

3. Çdo përkthim zyrtar përmban:

a) përkthimin e saktë të tekstit nga gjuha e burimit në gjuhën e synuar dhe anasjelltas, të shoqëruar me vulën e përkthyesit zyrtar që ka kryer përkthimin;

b) deklaratën e nënshkruar prej përkthyesit zyrtar të certifikuar se e ka përkthyer atë me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.

4. Mungesa e vulës ose e deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar sipas pikës 3 të këtij neni, e bën përkthimin të pavlefshëm. Forma dhe përmbajtja e deklaratës që i bashkëlidhet çdo përkthimi zyrtar miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 7
Profesioni i përkthyesit zyrtar

1. Profesioni i përkthyesit zyrtar është një profesion i pavarur me karakter publik, i cili ushtrohet nëpërmjet kryerjes së shërbimit të përkthimit zyrtar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Profesioni i përkthyesit zyrtar mund të ushtrohet vetëm nga personi që është certifikuar për kryerjen e kësaj veprimtarie dhe është regjistruar në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj.

3. Çdo person tjetër që nuk është certifikuar për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar nuk lejohet:

a) të kryejë përkthim të dokumenteve zyrtare ose të akteve normative të miratuara në Republikën e Shqipërisë, të marrëveshjeve ndërkombëtare ose të normave të nxjerra nga organizatat ndërkombëtare me shkrim nga gjuha e burimit në gjuhën e synuar;

b) të caktohet si përkthyes zyrtar nga gjykatat ose prokuroritë në proceset gjyqësore civile, penale ose administrative, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi, ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 8
Organizimi i përkthyesve

1. Përkthyesi zyrtar mund të ushtrojë veprimtarinë në mënyrë individuale ose në bashkëpunim me përkthyes zyrtarë të tjerë, të organizuar në zyra përkthimi, ose si i punësuar pranë një zyre përkthimi.

2. Kur përkthyesit ushtrojnë veprimtarinë të organizuar në zyra përkthimi, kanë detyrimin e regjistrimit në regjistrin tregtar në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

3. Në çdo rast shërbimi i përkthimit zyrtar kryhet vetëm nga subjektet që janë të pajisura me certifikatën përkatëse, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 9
Papajtueshmëritë

1. Përkthyesi zyrtar nuk mund të kryejë njëkohësisht funksione ose detyra të tjera, të cilat ndalohen me ligje të veçanta.

2. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave nuk merr përsipër kryerjen e një përkthimi zyrtar ose të interpretimit në rastet kur:

a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar ose të interpretimit të gjuhës së shenjave në çështjen ose në rastin në shqyrtim;

b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në çështjen ose në rastin në shqyrtim;

c) përkthyesi, interpreti ose personat e përmendur në shkronjën "b" të këtij neni kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të veprimtarisë së përkthimit zyrtar ose të interpretimit të gjuhës së shenjave në çështjen ose në rastin në shqyrtim;

ç) përkthyesi, interpreti ose personat e përmendur në shkronjën "b" të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në çështjen ose në rastin në shqyrtim;

d) në çdo rast tjetër kur parashikohet nga legjislacioni procedural në fuqi.

Neni 10
Regjistri elektronik

1. Regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave (në vijim, regjistri elektronik) krijohet e administrohet nga ministria.

2. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale që ndodhen në regjistrin elektronik bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Rregullat e hollësishme për të dhënat që përmban regjistri elektronik, për dhënësit e informacionit, për ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Autoriteti publik ose organi procedues cakton si përkthyes zyrtar ose interpret të gjuhës së shenjave personin e regjistruar në regjistrin elektronik. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave caktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe të legjislacionit procedural në fuqi.

Neni 11
Tarifat e shërbimit

1. Për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave paguhen tarifat e përkthimit të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

2. Ministri dhe ministri përgjegjës për financat miratojnë me udhëzim të përbashkët rregulla për përjashtimin apo uljen e tarifave të shërbimit të përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12
Përgjegjësitë e ministrit dhe të ministrisë

1. Ministri ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

a) kujdeset dhe mbështet garantimin e shërbimit të përkthimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë;

b) kontrollon zbatimin e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore lidhur me veprimtarinë e shërbimit të përkthimit zyrtar;

c) jep, pezullon ose heq certifikatën për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar;

ç) jep, pezullon ose heq certifikatën e interpretit të gjuhës së shenjave sipas këtij ligji;

d) nis hetimin disiplinor ndaj përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave, sipas parashikimeve të këtij ligji;

dh) miraton aktet nënligjore në zbatim të dispozitave të këtij ligji;

e) miraton kodin e etikës të përkthyesit zyrtar;

ë) miraton listën e gjuhëve të huaja, të cilat përfshihen në shërbimin e përkthimit zyrtar;

f) organizon kurse trajnimi profesionale për përkthyesit zyrtarë, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe shoqatat përkatëse;

g) kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

2. Në fushën e përkthimit zyrtar, ministria realizon veçanërisht:

a) përkthimin e dokumentacionit zyrtar të nevojshëm për ekstradimin e shtetasve shqiptarë nga shtetet e huaja;

b) përkthimin e letërporosive dhe të ndihmës juridike në fushën penale e civile të autoriteteve gjyqësore shqiptare drejtuar autoriteteve homologe të shteteve të huaja;

c) përkthimin e akteve gjyqësore, siç janë vendimet e gjykatave të vendit apo të huaja, akteve të prokurorisë, në kuadrin e ekzekutimit të letërporosive, të transferimit të procedimeve penale, të transferimit të të dënuarve shqiptarë apo të huaj në vendet e tyre;

ç) përkthimin e akteve të autoriteteve gjyqësore të huaja, të ministrisë, të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, të Interpolit, vendimeve, urdhrave të ekzekutimit të prokurorive, procesverbaleve dhe shkresave zyrtare të organeve të drejtësisë drejtuar autoriteteve vendase, në kuadrin e ndihmës së ndërsjellë juridike dypalëshe ose shumëpalëshe;

d) përkthimin e dispozitave ligjore shqiptare dhe të huaja, të cilave u referohen autoritetet shqiptare e të huaja;

dh) certifikimin e tekstit të përkthyer të marrëveshjeve ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe, që lidhen në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, si dhe të akteve e normave të nxjerra prej një organizate ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është vend anëtar ose ka filluar procedurat e anëtarësimit në të;

e) përkthimin dhe pasqyrimin në regjistrin gjyqësor penal të dispozitivit të vendimeve penale të shtetasve shqiptarë të dënuar penalisht jashtë shtetit, që paraqiten në ministri nga autoritetet gjyqësore të huaja.

3. Ministria, për nevoja të ushtrimit të kompetencave, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe

organet që ligji u ka njohur të drejtën për përkthimin zyrtar të akteve ose dokumenteve sipas këtij ligji, përzgjedhin përkthyes zyrtar nga regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë. Kriteret e rregullat për përzgjedhjen, kontraktimin, shpërblimin dhe mënyrën e kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III
HYRJA NË PROFESION

Neni 13
Organi certifikues

Ministri është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili u jep certifikatën individuale për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar shtetasve që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si përkthyes zyrtarë, në përputhje me rregullat e procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 14
Kriteret për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar

1. Të drejtën për t'u certifikuar si përkthyes zyrtar në Republikën e Shqipërisë e ka çdo shtetas që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës, ose të zotërojë një diplomë të të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

i. për një vepër penale të kryer me dashje për të cilën nuk është rehabilituar;

ii. për një vepër penale të kryer me pakujdesi për të cilën nuk është rehabilituar e që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përkthyesit zyrtar.

ç) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur kjo masë disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm;

d) të ketë kaluar me sukses provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar.

2. Shtetasi i huaj, përveç kushteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të provojë që zotëron gjuhën shqipe me anë të paraqitjes së një dokumenti të lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ministri mund t'i japë certifikatën e ushtrimit të profesionit të përkthyesit zyrtar shtetasit që, pavarësisht se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat "b" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni, provohet se njeh një nga gjuhët e huaja për të cilën në listën e përkthyesve zyrtarë ka jo më shumë se 3 (tre) përkthyes zyrtarë të certifikuar.

4. Personi ka të drejtë për t'u certifikuar si përkthyes zyrtar në më shumë se një gjuhë të huaj.

5. Kandidatët për përkthyes zyrtarë paraqesin çdo dokumentacion të nevojshëm, që vërteton përmbushjen e kritereve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 ose në pikën 3 të këtij neni. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve, nuk është i plotë, i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, ministria mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik.

6. Rregulla më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 15
Kriteret për certifikimin e interpretuesit të gjuhës së shenjave

1. Interpretuesit e gjuhës së shenjave certifikohen si interpretues të gjuhës së shenjave sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Të drejtën për t'u certifikuar si interpretues në Republikën e Shqipërisë e ka çdo shtetas që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje për të cilën nuk është rehabilituar;

c) të ketë kaluar me sukses provimin e kualifikimit për interpretues të gjuhës së shenjave.

3. Ministri mund t'i japë certifikatën e interpretuesit të gjuhës së shenjave shtetasit që,

pavarësisht se nuk plotëson kriterin e përcaktuar në shkronjën "c" të pikës 2 të këtij neni, provohet se njeh gjuhën e shenjave shqip dhe në regjistrin elektronik ka jo më shumë se 6 (gjashtë) interpretues të gjuhës së shenjave të certifikuar.

4. Rregulla më të hollësishme për paraqitjen e trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 16
Provimi i kualifikimit

1. Kandidati për përkthyes zyrtar ose për interpret të gjuhës së shenjave, që plotëson kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15 të këtij ligji, ka të drejtë t'i nënshtrohet provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar ose për interpret të gjuhës së shenjave.

2. Provimi i kualifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, organizohet nga ministria 1 (një) herë në 2 (dy) vjet. Në raste përjashtimore, kur justifikohet nevoja e ngutshme, provimi i kualifikimit mund të zhvillohet përpara këtij afati.

3. Provimi i kualifikimit për përkthyes zyrtar zhvillohet për çdo gjuhë të huaj, sipas listës së gjuhëve të huaja të miratuar nga ministri.

4. Provimi i kualifikimit për përkthyes zyrtar për çdo gjuhë të huaj organizohet nga komisioni i posaçëm për gjuhën përkatëse me këtë përbërje:

a) dy përfaqësues nga ministria;

b) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja.

5. Provimi i kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave organizohet nga komisioni i posaçëm me këtë përbërje:

a) dy përfaqësues nga ministria;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;

c) dy përfaqësues nga radhët e interpretëve të gjuhës së shenjave ose nga trajnerët e certifikuar të programit të interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe.

6. Kandidati për përkthyes zyrtar mund t'i nënshtrohet provimit të kualifikimit deri në 3 (tre) herë për të njëjtën gjuhë.

7. Ministri ka të drejtë të përjashtojë nga detyrimi për dhënien e provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar:

a) kandidatin që ka punuar jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet pa ndërprerje si personel akademik në fakultetet e gjuhëve të huaja dhe që zotëron grada ose tituj shkencorë në fushën e përkthimit të gjuhës së huaj përkatëse;

b) kandidatin që ka punuar pa ndërprerje jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet si përkthyes në institucionet qendrore të administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë;

c) kandidatin që ka punuar për jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet si përkthyes në organizata ndërkombëtare ose në institucionet e Bashkimit Evropian.

8. Rregullat e hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, organizimin e zhvillimin e provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, tarifat për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve përcaktohen me urdhër të ministrit.

9. Masa e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve të posaçme caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas rregullave të përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

Neni 17
Certifikata e përkthyesit zyrtar

1. Kandidati për përkthyes zyrtar ose për interpret të gjuhës së shenjave dorëzon kërkesën për pajisjen me certifikatën e ushtrimit të profesionit pranë ministrisë pas kalimit me sukses të provimit të kualifikimit brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit. Ministri jep certifikatën e përkthyesit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave brenda 45 ditëve nga dorëzimi i kërkesës.

2. Certifikata e ushtrimit të profesionit të përkthyesit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave është pa afat dhe e patjetërsueshme.

3. Nëse kandidati për përkthyes zyrtar ose për interpret të gjuhës së shenjave, që ka kaluar me sukses provimin e kualifikimit, nuk paraqet kërkesën për pajisjen me certifikatën e ushtrimit të

profesionit në afatin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, pa shkak të arsyeshëm, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për t'u pajisur me certifikatën e ushtrimit të profesionit dhe humb të drejtën për të marrë pjesë në provimet e kualifikimit që do të zhvillohen në 5 vitet e ardhshme.

Neni 18
Vula dhe karta e identifikimit e përkthyesit zyrtar

1. Ministria pajis përkthyesin zyrtar me vulë, shpenzimet e së cilës përballohen prej tij.

2. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave pajiset me kartën identifikuese të përkthyesit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave, e cila lëshohet nga Ministria e Drejtësisë. Karta identifikuese përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

3. Forma, përmbajtja dhe karakteristikat e tjera të vulës dhe rregullat për pajisjen dhe administrimin e tyre, si dhe forma e kartës së identifikimit përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 19
Pajisja me certifikatë sigurie

1. Përkthyesi zyrtar, që përkthen dokumente shtetërore të klasifikuara, pajiset me certifikatë sigurie në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.

2. Përkthimi i një dokumenti dhe/ose një materiali të klasifikuar përmban të gjitha shenjëzimet e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" dhe trajtohet si i tillë.

KREU IV
PEZULLIMI, HEQJA E CERTIFIKATËS DHE ÇREGJISTRIMI NGA REGJISTRI ELEKTRONIK

Neni 20
Pezullimi i përkohshëm me kërkesë

1. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave ka të drejtë të kërkojë pezullimin e ushtrimit të profesionit për arsyet e mëposhtme:

a) për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi;

b) përkujdesje për fëmijën e tij të mitur derisa fëmija të mbushë moshën 3-vjeçare;

c) zgjedhje ose emërim në një funksion publik ose kur ushtron një detyrë tjetër që, sipas legjislacionit të posaçëm, është i papajtueshëm me ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar ose interpretimit.

2. Për rastet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, pezullimi zgjat për një periudhë deri në 3 (tre) vjet. Në rastet e përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij neni, periudha e pezullimit është sa kohëzgjatja e funksionit publik ose e detyrës, por në çdo rast jo më shumë se 9 (nëntë) vjet.

3. Kërkesa e arsyetuar për pezullimin e përkohshëm i drejtohet ministrit dhe përmban kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit. Ministri vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të ushtrimit të profesionit. Vendimi i ministrit për pezullimin e përkohshëm publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

4. Përkthyesi zyrtar ose interpreti mund të bëjë kërkesë tjetër për pezullim të përkohshëm, por jo më parë se 4 (katër) vjet nga data e rifillimit të ushtrimit të profesionit, me përjashtim të rastit të parashikuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, ose kur pezullimi kërkohet për një fëmijë tjetër, sipas parashikimeve të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni.

5. Kur me kalimin e 2 (dy) muajve nga mbarimi i detyrës ose i funksionit, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, përkthyesi zyrtar ose interpreti nuk paraqet kërkesë për rifillimin e veprimtarisë, ai çregjistrohet nga regjistri elektronik.

6. Rregullat e hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 21
Pezullimi nga detyra për shkaqe të tjera

1. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave mund të pezullohet përkohësisht nga detyra nga ministri kur:

a) ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal me arrest për vepra penale që lidhen me "shpërdorimin e detyrës";

b) ndaj tij ka filluar një procedurë për çregjistrim nga regjistri elektronik, kur ka dyshime të arsyeshme se certifikimi është bërë në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj;

c) ndaj tij ka filluar një procedurë për heqjen e zotësisë për të vepruar;

ç) i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) nuk mund të kërkojë pezullim vullnetar, sipas nenit 20 të këtij ligji, ose zgjatje të periudhës së pezullimit vullnetar për shkak të një sëmundjeje ose paaftësie fizike apo mendore.

2. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente kundër urdhrit të ministrit në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 22
Çregjistrimi nga regjistri elektronik

Përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave i hiqet certifikata dhe çregjistrohet nga regjistri në rastet, kur:

a) heq dorë me kërkesën e tij nga ushtrimi i profesionit;

b) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) dënohet penalisht me një vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas përcaktimeve të shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 14, ose të shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 15 të këtij ligji;

ç) ndaj tij jepet masa disiplinore e heqjes së certifikatës së ushtrimit të profesionit;

d) nuk paraqet kërkesë për rifillimin e veprimtarisë ose nuk plotëson kushtet për rifillimin e kësaj veprimtarie sipas parashikimeve të këtij ligji;

dh)vërtetohet se në momentin e marrjes së certifikatës e ka marrë atë në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

e) humb jetën.

KREU V
TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Neni 23
Kujdesi në ushtrimin e veprimtarisë

Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave, në kryerjen e veprimtarisë së përkthimit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave, duhet të veprojë me kujdesin e duhur dhe në përputhje me ligjin, kodin e etikës e rregullat e ushtrimit të profesionit.

Neni 24
Detyrat e përkthyesit zyrtar dhe të interpretit të gjuhës së shenjave

Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave gjatë ushtrimit të veprimtarisë kryen detyrat e mëposhtme:

a) kryen veprimtarinë e përkthimit zyrtar ose të interpretimit të gjuhës së shenjave me profesionalizëm, korrektësi, paanshmëri, besnikëri dhe integritet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) ruan sekretin profesional dhe konfidencialitetin e të dhënave për të cilat është vënë në dijeni nga faktet, rrethanat ose dokumentet e vëna në dispozicion për përkthim, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor, si dhe mban përgjegjësi për përkthimin konform tekstit në gjuhën e burimit apo të ndryshimit të përmbajtjes së tekstit me dashje;

c) përmirëson në mënyrë të vazhdueshme kualifikimet profesionale në fushën e përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën e huaj dhe anasjelltas, ose në fushën e interpretimit të gjuhës së shenjave, si dhe merr pjesë në trajnime të organizuara për këtë qëllim nga ministria, institucionet e arsimit të lartë apo shoqatat;

ç) kthen çdo dokumentacion që i jepet për përkthim në gjuhën e synuar në përfundim të kryerjes së këtij shërbimi;

d) deklaron pranë ministrisë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë, çdo ndryshim të të dhënave që përmban regjistri elektronik, sipas parashikimeve të këtij ligji. Mosrespektimi i këtij afati përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor sipas këtij ligji;

dh) përmbush detyrimet që burojnë nga legjislacioni i fushës së taksave dhe tatimeve;

e) mban arkivin dokumentar dhe elektronik të ushtrimit të veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ë) mban adresë zyrtare elektronike sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të ministrit.

f) çdo detyrë tjetër sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 25
Detyrimi për të kryer përkthimin

Përkthyesit zyrtarë nuk mund të refuzojnë kryerjen e një përkthimi zyrtar përveç rasteve kur gjenden në kushte papajtueshmërie ose konflikti interesi, kur ka një pengesë ligjore për kryerjen e përkthimit zyrtar, sipas legjislacionit procedural në fuqi, si dhe përjashtimisht për shkak të pamundësisë për kryerjen e përkthimit brenda afatit të kërkuar.

Neni 26
Të drejtat e përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave

Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka të drejtë:

a) të ofrojë shërbimin e përkthimit zyrtar ose të interpretimit të gjuhës së shenjave në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në mënyrë të lirë dhe të pavarur, pa kufizime;

b) të organizohet si zyrë përkthimi sipas legjislacionit në fuqi;

c) të kërkojë pranë ministrisë pezullimin e përkohshëm të ushtrimit të profesionit në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) të shpërblehet korrektësisht për punën e kryer në përputhje me tarifat e miratuara.

Neni 27
Mbrojtja e veçantë e përkthyesit dhe interpretit të gjuhës së shenjave

Shteti garanton mbrojtje të veçantë për përkthyesit dhe interpretin e gjuhës së shenjave kur u rrezikohet jeta, familja ose prona gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj. Kriteret dhe procedura e përfitimit të mbrojtjes së veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI
PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 28
Fillimi i hetimit disiplinor

1. Ministri vendos të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar ose të arkivojë një ankesë brenda 3 (tre) muajve nga marrja e ankesës.

2. Ministri brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur komisionit disiplinor raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore ose merr vendim për mbylljen e hetimit.

3. Ministri mund të zgjasë afatin e hetimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni në raste komplekse për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Në rastet kur pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, ministri riçel hetimin me kushtin që të mos jenë parashkruar afatet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 29
Ankesat

1. Çdo person fizik ose juridik, si dhe organi procedues ka të drejtë t'i paraqesë ministrit ankesa të arsyetuara me shkrim për përkthyesit zyrtarë ose për interpretët e gjuhës së shenjave.

2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave mund të ketë kryer shkelje disiplinore, çdo funksionar publik që ka dijeni duhet të informojë ministrin.

3. Ministri ka detyrimin të shqyrtojë të gjitha ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Ministri i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Ministri i njofton ankuesit vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

5. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës dhe mbylljen e hetimit të filluar nëse ministri vlerëson që ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij.

6. Ankesat mund të bëhen brenda 1 (një) viti nga data e sjelljes ose veprimit të përkthyesit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave apo nga data e konstatimit të sjelljes ose veprimit të përkthyesit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave, por në çdo rast jo më vonë se 2 (dy) vjet nga momenti i kryerjes së shkeljes. Pas kalimit të këtij afati, ankuesi ka të drejtë të kërkojë pranë ministrit rivendosjen në afat në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

7. Formularët e ankesave publikohen në faqen zyrtare të ministrisë.

Neni 30
Fillimi i hetimeve kryesisht

1. Ministri ka të drejtë të fillojë hetimin kryesisht bazuar në të dhëna, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se mund të jetë kryer shkelja.

2. Ministri nxjerr urdhër të arsyetuar për fillimin e hetimit kryesisht, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme. Urdhri në çdo rast i njoftohet edhe përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave.

Neni 31
Bashkimi i hetimeve, shtimi dhe ndryshimi i objektit të hetimit

1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se mund të ketë ndodhur një shkelje tjetër, ministri urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit në zbatim të nenit 30 të këtij ligji dhe njofton ankuesin e përkthyesin zyrtar ose interpretin e gjuhës së shenjave, sipas rastit.

2. Ministri bashkon hetimet në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit përkthyes zyrtar ose interpret të gjuhës së shenjave.

Neni 32
Pezullimi i hetimeve

1. Ministri urdhëron pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:

a) në të cilin njëra nga palët është përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave; si dhe

b) kur shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte për të cilat do të merret vendimi.

2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga autoriteti përgjegjës.

3. Ankuesi, përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave, gjykata, prokuroria dhe komisioni disiplinor përkatës njoftohen me shkrim për urdhrin e pezullimit. Gjykata, prokuroria ose institucione të tjera i dërgojnë ministrit pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit e procesit përkatës.

4. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, në favor të përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave, nuk pengon hetimin nga ministri për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave.

5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit, të parashikuara nga neni 39 i këtij ligji.

Neni 33
Të drejtat e përkthyesit zyrtar dhe interpretit të gjuhës së shenjave gjatë hetimit

1. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave ka të drejtë të njohë dosjen e hetimit në atë masë që nuk cenon sekretin e hetimit.

2. Ministri mund të kërkojë nga përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave informacione, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.

3. Ministri i njofton përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave ose përfaqësuesit të tij vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit.

Neni 34
Përfundimi i hetimit

1. Në përfundim të hetimit, nëse ka dyshime të arsyeshme që përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave ka kryer shkelje disiplinore, ministri fillon procedimin disiplinor duke paraqitur pranë komisionit disiplinor përkatës raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

2. Ministri mbyll hetimin nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;

b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor, përveç rasteve kur paraqiten fakte ose prova të reja;

c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi për shkak të kalimit të afateve;

ç) përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave ka ndërruar jetë.

3. Përjashtimisht, në rastet e parashikuara në pikën 6 të nenit 39 të këtij ligji, ministri vendos vetë nëse është kryer shkelje dhe jep masën disiplinore përkatëse.

Neni 35
Komisionet disiplinore

1. Komisioni disiplinor për përkthyesit zyrtarë është organ kolegjial, i cili përbëhet nga:

a) dy përfaqësues nga ministria;

b) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja.

2. Komisioni disiplinor për interpretët e gjuhës së shenjave është organ kolegjial, i cili përbëhet nga:

a) dy përfaqësues nga ministria;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;

c) dy përfaqësues nga radhët e interpretëve të gjuhës së shenjave ose nga trajnerët e certifikuar të programit të interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe.

3. Kryetari i komisionit disiplinor respektiv është një nga përfaqësuesit e zgjedhur nga ministri sipas shkronjës "a" të pikës 1 dhe shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni. Kryetari dhe anëtarët e komisioneve disiplinore zgjidhen për një mandat katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Komisioni disiplinor shqyrton rastin dhe merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore pranë tij. Vendimi i arsyetuar i njoftohet ankuesit dhe përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave, palë në procesin disiplinor.

5. Rregullat e hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve disiplinore, për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive prej tyre dhe për zhvillimin e procedimit disiplinor përcaktohen me urdhër të ministrit.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve disiplinore caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas rregullave të përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

Neni 36
Parimet e procedimit disiplinor

1. Masat disiplinore arsyetohen dhe merren sipas një procedure transparente dhe në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur. Parimi i proporcionalitetit është bazë në përcaktimin e masës disiplinore.

2. Palët në procedim disiplinor kanë të drejtë të paraqiten dhe të japin shpjegime në seancë vetë ose nëpërmjet përfaqësimit me të tretë. Nëse njëra ose të dyja palët nuk paraqiten në seancë pa shkaqe të arsyeshme, komisioni disiplinor përkatës shqyrton çështjen dhe merr vendim në mungesë të tyre.

3. Shpjegimet e palëve dhe dëshmitë në seancë mund të jepen me gojë ose me shkrim.

4. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave, subjekt i procedimit disiplinor, duhet të paraqesë me shkrim shpjegimet e tij për ankesën brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit. Njoftimi për këtë qëllim mund të bëhet në rrugë shkresore ose elektronike. Mosparaqitja e shpjegimeve nga ana e përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave nuk përbën shkak për mosvazhdimin e procedimit disiplinor përkatës.

5. Komisioni disiplinor përkatës pranon deklaratat nga dëshmitarët e dokumentet e paraqitura para tij, në cilësinë e provës, dhe i çmon ato sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit në tërësi të tyre. Procedimi disiplinor duhet t'i përmbahet vetëm objektit të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor.

Neni 37
Pezullimi i procedimit disiplinor

Rregullat për pezullimin e hetimit disiplinor, sipas nenit 32 të këtij ligji, zbatohen për aq sa është e mundur për pezullimin e procedimit disiplinor.

Neni 38
Vendimmarrja e komisionit disiplinor për çështjet disiplinore

Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, komisioni disiplinor përkatës vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose

b)pranimin e kërkesës, marrjen e një ose më shumë masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit ministrit, me qëllim nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor.

KREU VII
SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 39
Shkeljet dhe masat disiplinore

1. Përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave kryen një shkelje disiplinore në rastet kur:

a) vepron në kundërshtim me dispozitat ligjore ose nënligjore;

b) kryen veprime ose mosveprime që përbëjnë "shërbime të papërshtatshme profesionale", ku përfshihen veprime apo mosveprime ndaj palëve, të cilat janë në kundërshtim me kodin e etikës ose me shkronjën "a" të nenit 24 të këtij ligji.

2. Shkelje disiplinore janë edhe veprimet ose mosveprimet që përbëjnë vepër penale, pavarësisht faktit nëse vepra penale është shlyer, nëse ndjekja penale nuk është filluar ose nuk mund të vazhdojë, nëse përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave është rehabilituar ose ka përfituar nga falja apo amnistia, me kushtin që të mos kenë kaluar më shumë se 5 (pesë) vjet nga momenti i shkeljes.

3. Për shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit dhe veprimtarinë e përkthimit zyrtar ose interpretimit të gjuhës së shenjave, përkthyesit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave i jepet masat disiplinore si më poshtë:

a) paralajmërim me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim për heqjen e certifikatës për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave;

c) gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

ç) urdhër për të marrë pjesë në kurset profesionale që organizohen nga ministria, nga institucionet e arsimit të lartë ose nga shoqatat;

d) pezullim nga detyra për një periudhë nga 1 një deri në 5 (pesë) vjet;

dh) heqje përfundimtare e certifikatës për ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave dhe çregjistrim nga regjistri elektronik.

4. Masa disiplinore e dhënë ndaj një përkthyesi zyrtar ose një interpreti të gjuhës së shenjave jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) shkallën e fajit;

b) shpeshtësinë e kryerjes së shkeljes;

c) rrethanat e kryerjes së shkeljes, mundësinë dhe ardhjen e pasojave nga shkelja.

5. Gjoba mund të shoqërohet në mënyrë kumulative me masa të tjera disiplinore, të parashikuara nga shkronjat "a", "b" dhe "ç" të pikës 3 të këtij neni.

6. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat "a" "b", "c" dhe "ç" të pikës 3 të këtij neni jepen nga ministri. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat "d" e "dh" të pikës 3 të këtij neni jepen vetëm me vendim të komisionit disiplinor përkatës.

7. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 (pesë) vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja.

Neni 40
E drejta e ankimit për masat disiplinore

1. Kundër urdhrit të ministrit ose vendimit të komisionit disiplinor përkatës për dhënien e masave disiplinore mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit ose urdhrit.

2. Ankimi kundër urdhrit të ministrit ose vendimit të komisionit disiplinor nuk pezullon zbatimin e urdhrit ose vendimit të ankimuar, derisa

vendimi gjyqësor për ankimin të marrë formë të prerë.

3. Vendimi i komisionit disiplinor përkatës, pas kalimit të afatit të ankimit, ose kur lihet në fuqi nga gjykata, regjistrohet në regjistrin elektronik.

Neni 41
Ekzekutimi i vendimit

1. Ministria mbikëqyr zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor.

2. Ministria siguron zbatimin e masave disiplinore:

a) brenda 1 (një) muaji, në rast paralajmërimi me shkrim, në rast të një vërejtjeje me paralajmërim për heqjen e certifikatës ose në rastin e gjobës;

b) brenda 2 (dy) javëve në rastet e tjera, duke nxjerrë urdhrin përkatës, sipas vendimmarrjes së komisionit disiplinor përkatës.

Neni 42
Regjistrimi i masave disiplinore

1. Ministria shënon në regjistrin elektronik vendimet për masat disiplinore.

2. Këto masa shuhen dhe fshihen nga regjistri elektronik kur:

a) ka kaluar 1 (një) vit nga vendosja e masës disiplinore të paralajmërimit me shkrim;

b) kanë kaluar 2 (dy) vjet nga pagesa e gjobës;

c) kanë kaluar 3 (tre) vjet nga data e ekzekutimit të masës disiplinore të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarisë.

3. Masa disiplinore e heqjes së certifikatës së ushtrimit të profesionit të përkthyesit zyrtar ose të interpretit të gjuhës së shenjave nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri elektronik.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 43
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 3; 12, pika 3; 16, pika 9; 27 dhe 35, pika 6, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 4; 11, pikat 1 dhe 2; 12, pika 1, shkronjat "e" dhe "ë"; 14, pika 6; 15, pika 4; 16, pika 8; 18, pika 3; 20, pika 6; 24, shkronja "ë"; 29, pika 7, dhe 35, pika 5, të këtij ligji.

Neni 44
Dispozitë kalimtare

1. Të gjitha subjektet, që janë të licencuara ose të autorizuara nga Ministria e Drejtësisë si përkthyes zyrtarë, konsiderohen *ipso lege* të certifikuara për ushtrimin e veprimtarisë së përkthimit zyrtar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Interpretët e gjuhës së shenjave, që janë caktuar nga organi procedues në të paktën 5 (pesë) procedime si interpretë të gjuhës së shenjave, konsiderohen *ipso lege* të certifikuar si interpretë të gjuhës së shenjave, për qëllime të këtij ligji.

3. Brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha subjektet, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, paraqesin kërkesë pranë ministrisë për regjistrimin e tyre në regjistrin elektronik, duke paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara për pasqyrimin e tyre në këtë regjistër.

Neni 45
Penalitetet

1. Cilido që kryen shërbimin e përkthimit zyrtar ose të interpretimit të gjuhës së shenjave, në kuptim të këtij ligji, pa qenë i pajisur me certifikatën përkatëse, ose nuk vepron në përputhje me parashikimet e nenit 44 të këtij ligji, dënohet me masë administrative me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

2. Gjoba e vendosur kundër subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e përkthimit zyrtar ose të interpretimit të gjuhës së shenjave, sipas pikës 1 të këtij neni, arkëtohet në buxhetin e shtetit.

Neni 46
Shfuqizime

Dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë profesionin e përkthyesit zyrtar, por që

bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 47
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 24.6.2021.

LIGJ
Nr. 83/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT DHE NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE NË AFËRSI TË RRUGËS BREGDETARE (VLORË-ORIKUM)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për projektin e rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum) në shumën prej 112 500 000 (njëqind e dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) rialësh sauditë sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 24.6.2021

Fondi Saudit për Zhvillim
P.O.BoX 50483 Riad 11523
Mbretëria e Arabisë Saudite

MARRËVESHJE HUAJE
PROJEKTI I REHABILITIMIT DHE I NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE NË AFËRSI TË RRUGËS BREGDETARE (VLORË – ORIKUM) NDËRMJET FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

HUAJA NR. 4/777
NËNSHKRUAR MË 23.8.1441 A.H.
QË KORRESPONDON ME: 5.4.2021 A.D.

MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJE e datës 23.8.1442 A.H. që korrespondon me 5.4.2021 A.D.

Ndërmjet:

1. Fondi Saudit për Zhvillim, Riad, Mbretëria e Arabisë Saudite (referuar në vijim si "Fondi"); dhe
2. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (referuar në vijim si "Huamarrësi")

HYRJE

A. Duke pasur parasysh se Huamarrësi i ka kërkuar Fondit që t'i japë një Hua për ta ndihmuar me financimin e Projektit të Rehabilitimit dhe Ndërtimit të Objekteve në Afërsi të Rrugës Bregdetare (Vlorë–Orikum) i përshkruar në skedulin nr. 2 të kësaj Marrëveshjeje (referuar në vijim si "Projekti");

B. Duke pasur parasysh se kjo hua është rialokim i shumës së marrëveshjes së Huas nr. 3/693 për Projektin e rehabilitimit të rrugës së lumit të Vlorës në Republikën e Shqipërisë nga Rezoluta e Bordit të Drejtorëve nr. (14/116/2211) në përgjigje të kërkesës së huamarrësit për përdorimin e shumës së Huas për Projektin e Rehabilitimit dhe Ndërtimit të Objekteve në Afërsi të Rrugës Bregdetare (Vlorë–Orikum);

C. Sa më lart, duke pasur parasysh se Bordi i Drejtorëve të Fondit ka rënë dakord, në bazë të rezolutës së tij nr. 9/125/2380 që t'i japë Huamarrësit një hua sipas kushteve dhe termave të përcaktuar në vijim;

D. Duke pasur parasysh se qëllimi i Fondit është t'i ndihmojë vendet në zhvillim që të zhvillojnë ekonomitë e tyre dhe t'u japë huat e nevojshme për zbatimin e projekteve dhe të programeve të tyre për zhvillim;

E. duke pasur parasysh se Fondi është i bindur për rëndësinë e Projektit dhe ndikimet e tij të dobishme për zhvillimin ekonomik dhe social të popullit mik shqiptar,

aktualisht, Palët e kësaj marrëveshjeje bien dakord si më poshtë:

Neni I
Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

Seksioni 1.01 Palët e kësaj Marrëveshjeje pranojnë të gjitha dispozitat e Kushteve të Përgjithshme të Zbatueshme për Marrëveshjet e Huas së Fondit, të lëshuara me anë të Rezolutës së Bordit të Drejtorëve të Fondit nr. 11/14, të datës Rajab 29, 1396 AH, e cila korrespondon me datën 26 korrik 1976 PK, me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht në këtë marrëveshje (të specifikuara Kushte të Përgjithshme të Zbatueshme për Marrëveshjet e Huas së Fondit që në vijim referohen si "Kushtet e përgjithshme").

Seksioni 1.02 Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti përcakton ndryshe, termat e ndryshëm të përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme dhe në Preambulën e kësaj Marrëveshjeje kanë përkufizimet përkatëse të përcaktuara këtu dhe termi "Agjenci ekzekutuese" i referohet Fondit Shqiptar për Zhvillim të Huamarrësit.

Neni II
Huaja

Seksioni 2.01 Fondi bie dakord t'i japë Huamarrësit hua, sipas termave dhe kushteve në Marrëveshjen e Huas së përcaktuar ose të referuar në shumën prej njëqind e dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë (112,500,000) rialë sauditë.

Seksioni 2.02 Huamarrësi mund të tërheqë shumën e Huas, nëpërmjet FSHZH-së, në përputhje me dispozitat e skedulit nr. 1 të kësaj Marrëveshjeje, skedul i cili mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit për shpenzimet e kryera në lidhje me kostot e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huas.

Seksioni 2.03 Huamarrësi ndërmerr të përdorë, nëpërmjet FSHZH-së, të ardhurat e Huas vetëm për financimin e kostove të arsyeshme të punimeve, mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për zbatimin e Projektit. Prokurimi i këtyre punimeve, mallrave dhe shërbimeve kryhet në përputhje me udhëzimet për prokurimin e mallrave dhe kontraktimin e punimeve të zbatimit", dhe me përdorimin e konsulentëve të anëtarëve të institucioneve për zhvillim të grupit të koordinimit. Huamarrësi do të sigurojë, nëpërmjet FSHZH-së miratimin e Fondit para lidhjes së kontratave që do të financohen me të ardhurat e Huas dhe para kryerjes së ndryshimeve materiale të tyre në të ardhmen.

Seksioni 2.04 Data e përfundimit është 31.12.2024 ose një datë e mëvonshme sipas përcaktimit të Palëve me shkrim.

Seksioni 2.05 Huamarrësi paguan një tarifë huaje në normën prej dy për qind (2%) në vit të shumës së principalit të Huas së tërhequr dhe të pashlyer herë pas here.

Seksioni 2.06 Tarifa e Huas dhe tarifat e tjera paguhen një herë në gjashtë muaj në datat 15 mars dhe 15 shtator të çdo viti.

Seksioni 2.07 Afati i Huas është 25 vjet, duke përfshirë një periudhë pesëvjeçare (5-vjeçare) pa pagesë principali. Huamarrësi shlyen shumën e principalit të Huas në përputhje me skedulin e amortizimit të përcaktuar në skedulin nr. 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III
Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01 a) Huamarrësi zbaton Projektin nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese me efikasitet dhe përkushtim dhe në përputhje me praktikat e duhura administrative, financiare dhe inxhinierike dhe ofron menjëherë, sipas nevojës, fondet, lehtësirat/ambientet, shërbimet dhe burimet e tjera të nevojshme për zbatimin e Projektit.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafit "a" të këtij seksioni, Huamarrësi: 1. mundëson menjëherë, sipas nevojës, përveç të ardhurave të kësaj huaje, të gjitha fondet e tjera që nevojiten për zbatimin e projektit (duke përfshirë të gjitha fondet që mund

të nevojiten për të mbuluar çdo shtim të kostos përtej kostove të llogaritura në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje), të cilat do të vihen në dispozicion sipas termave dhe kushteve të pranuara nga Fondi; 2. kryen alokime të mjaftueshme buxhetore vjetore për të përmbushur pjesën e tij të kostove të Projektit.

Seksioni 3.02 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese t'i mundësojë Fondit, menjëherë pas përgatitjes së tyre, studimet, projektimet, specifikimet, raportet, dokumentet e kontratës dhe skedulet e ndërtimit dhe prokurimit për Projektin, si dhe ndryshimet ose shtesat përkatëse në detajet e kërkuara nga Fondi në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 3.03 Për zbatimin e Projektit, Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të caktojë kontraktues të kualifikuar dhe me përvojë të pranueshëm nga Fondi. Konsulentët inxhinierikë tashmë të kontraktuar për mbikëqyrjen e shërbimeve, sipas Projektit të Rrugës së Lumit të Vlorës, do të realizojnë shërbimet e mbikëqyrjes në kuadër të këtij Projekti.

Bazuar në parashikimin e përcaktuar në preambulën B të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha shërbimet e faturuara tashmë nga konsulenti i mësipërm, do të kryhen nga Agjencia Ekzekutuese gjatë afatit të kësaj huaje.

Seksioni 3.04 Për zbatimin e Projektit, Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të punësojë konsulentë inxhinierikë, kontraktues dhe furnizues të aftë dhe të kualifikuar për Fondin, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Fondin.

Seksioni 3.05 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të sigurojë që mallrat e importuara që do të financohen nga të ardhurat e Huas të sigurohen kundër rreziqeve të lidhura me blerjen, transportin dhe dorëzimin përkatës në pikën e përdorimit apo instalimit dhe, për këtë siguracion, çdo dëmshpërblim është i pagueshëm në një valutë të përdorur lirisht nga Huamarrësi për zëvendësimin apo riparimin e këtyre mallrave.

Seksioni 3.06 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të përdorë të gjitha punimet, mallrat dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huas vetëm për zbatimin e Projektit.

Seksioni 3.07 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të mbajë regjistra të përshtatshëm për paraqitjen e ecurisë së Projektit (duke përfshirë kostot përkatëse) për identifikimin e punimeve, mallrave dhe shërbimeve të financuara nga të ardhurat e Huas dhe për informimin mbi përdorimin e tyre në Projekt, si dhe për të pasqyruar të gjitha veprimtaritë, burimet dhe shpenzimet e lidhura me Projektin.

Seksioni 3.08 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese t'u krijojë të gjitha mundësitë e arsyeshme përfaqësuesve të akredituar të Fondit që të kryejnë vizita për qëllime të lidhura me huan, për të shqyrtuar Projektin, punimet, mallrat dhe shërbimet e financuara nga fondet e Huas dhe regjistrat dhe dokumentet përkatëse.

Seksioni 3.09 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese t'i ofrojë Fondit informacionin që Fondi kërkon në mënyrë të arsyeshme në lidhje me Projektin, shpenzimet e të ardhurave të Huas dhe mallrat e shërbimet e financuara nga këto të ardhura.

Seksioni 3.10 Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, merr të gjitha masat e nevojshme për blerjen, kur është e nevojshme, të të gjithë tokës dhe të drejtave të lidhura me tokën, për zbatimin e Projektit.

Seksioni 3.11 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të caktojë një inxhinier të kualifikuar dhe me përvojë si menaxher Projekti për të koordinuar dhe për të ndjekur të gjitha aktivitetet e ekzekutimit të projektit me ndihmën e një ekipi të kualifikuar me përvojë që përbën të gjitha specialitetet e nevojshme teknike.

Neni IV
Marrëveshje të veçanta

Seksioni 4.01 a) Huamarrësi dhe Fondi konfirmojnë marrëveshjen ndërmjet tyre se asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të ketë përparësi mbi huan nëpërmjet një barre të krijuar në lidhje me asetet qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi ndërmerr që, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe nga ana e Fondit, nëse do të krijohet një barrë mbi ndonjë aset të Huamarrësit, si garanci për ndonjë borxh të jashtëm, kjo barrë do të sigurojë në mënyrë të barabartë dhe proporcionale, dhe si e tille pa kosto për Fondin, shlyerjen e principalit të Huas, tarifën e Huas dhe pagesat e tjera të lidhura me huan dhe që në krijimin e kësaj barre do të hartohet një dispozitë shprehimisht për këtë qëllim.

b) Sipërmarrja e parashikuar në paragrafin "a" të këtij seksioni nuk zbatohet, për:

i. ndonjë barrë mbi pronat në kohën e blerjes së tyre, të krijuar vetëm si garanci për pagimin e çmimit të blerjes për këtë pronë;

ii. ndonjë barrë mbi mallra tregtare për të siguruar një borxh që maturohet jo më vonë se një vit pas datës në të cilën është krijuar fillimisht dhe që shlyhet nga të ardhurat nga shitja e këtyre mallrave tregtare; ose

iii. ndonjë barrë që rezulton në rrjedhën normale të transaksioneve bankare dhe për sigurimin e një borxhi që maturohet jo më vonë se një vit nga data e krijimit.

Seksioni 4.02 Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese, vijon projektin në përputhje me standardet e duhura inxhinierike. Nëpërmjet FSHZH-së, Huamarrësi i ofron Fondit, si dhe kur kërkohet, një program për mirëmbajtjen e lartpërmendur.

Seksioni 4.03 Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese, mban ose merr masa për mbajtjen e regjistrave të duhur, në përputhje me praktikat e mira të kontabilitetit, veprimtarive, burimeve dhe shpenzimeve në lidhje me Projektin e Agjencisë Ekzekutuese dhe Drejtorive dhe Agjencive të tjera të Huamarrësit përgjegjëse për zbatimin e Projektit ose të ndonjë pjese të tij.

Seksioni 4.04 Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese, prodhon një pllakatë falënderimi me përmasa të përshtatshme, nga çimento ose metal i përshtatshëm dhe që do të vendoset në një vend të dukshëm në një prej ambienteve të Projektit, për të treguar kontributin e Fondit në financimin e Projektit.

Seksioni 4.05 Menjëherë pas realizimit të Projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit ose një datë të mëvonshme për të cilën Fondi bie dakord, Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese përpilon dhe i ofron Fondit raportin e realizimit të Projektit, në format dhe detaje të arsyeshme, sipas kërkesave të Fondit, lidhur me ekzekutimin dhe operimin fillestar të Projektit, kostot dhe përfitimet e tij që lindin dhe që do të lindin, përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit dhe Agjencisë Ekzekutuese sipas Marrëveshjes së Huas dhe arritjen e objektivave të Huas.

Neni V
Mjetet ligjore të Fondit

Seksioni 5.01 Për qëllimet e seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme, rastet shtesë më poshtë specifikohen sipas paragrafit "f" të asaj pike:

a) Në bazë të nënseksionit "b" të këtij seksioni:

i. e drejta e Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat nga çfarëdolloj huaje dhënë Huamarrësit për financimin e Projektit të jetë e pezulluar, anuluar apo ndërprerë plotësisht ose pjesërisht, sipas kushteve të marrëveshjes që e parashikon atë; ose

ii. çdo hua e tillë do të jetë bërë e kërkueshme dhe e pagueshme para maturimit të saj të rënë dakord.

b) Nënseksioni "a" i kësaj pike nuk zbatohet nëse Huamarrësi vërteton, duke plotësuar kërkesat e Fondit, se: 1. ky pezullim, anulim, ndërprerje ose maturim i parakohshëm nuk është shkaktuar nga mospërmbushja prej Huamarrësit të ndonjë prej detyrimeve të tij, sipas marrëveshjes specifike; dhe 2. Huamarrësit i mundësohen fonde të përshtatshme për Projektin nga burime të tjera me terma dhe kushte që përputhen me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02 Për qëllimet e seksionit 7.01 të Kushteve të Përgjithshme, rasti i mëposhtëm specifikohet, sipas paragrafit (d) të këtij seksioni dhe, përkatësisht, nëse ndodh rasti i përcaktuar në paragrafin (a)(ii) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI
Data e hyrjes në fuqi – e përfundimit

Periudha prej 6 (gjashtë) muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni VII
Përfaqësuesi i Huamarrësit, adresat

Seksioni 7.01 Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Huamarrësit përcaktohet si përfaqësuesi i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 7.02 Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllimet e seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

PËR FONDIN
Fondi Saudit për Zhvillim
Kutia Postare 50483
Riad 11523
Mbretëria e Arabisë Saudite

Tel.: +966-11-2794000
Telefaks : +966-11-4647450
***Email*: info@sfd.gov.sa**

PËR HUAMARRËSIN
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tel.: 0035542228405
***Email*: sekretariamin@financa.gov.al**
Tiranë, Republika e Shqipërisë

PËR AGJENCINË EKZEKUTUESE
Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga "Sami Frashëri", nr. 10
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel.: +35542234885
Telefaks: +35542234885
Email: adf@albaniandf.org

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar ligjërisht, nënshkruan këtë Marrëveshje me emrat e përfaqësuesve, në qytetin e _____, në ditën, muajin dhe vitin e shkruar më lart në dy origjinale, në gjuhët arabe dhe angleze dhe secili prej tyre përbën një origjinal. Një kopje e Kushteve të Përgjithshme në të dyja gjuhët i është dhënë Huamarrësit. Nëse ndonjë dispozitë e versionit në gjuhën arabe të Marrëveshjes së Huas dhe/ose Kushteve të Përgjithshme nuk përputhet me dispozitën përkatëse të versionit në gjuhën angleze të Marrëveshjes së Huas dhe/ose Kushteve të Përgjithshme, versioni në gjuhën arabe do të ketë përparësi.

PËR FONDIN SAUDIT PËR ZHVILLIM
Sultan A.AlMarshad
Zëvendësshef ekzekutiv

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Anila Denaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

SKEDULI NR. 1
TËRHEQJA E FONDEVE TË HUAS

Tabela më poshtë përcakton kategoritë e zërave që do të financohen me fondet e Huas, caktimin e vlerës së Huas për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për zërat që do të financohen në çdo kategori.

Kategoria		Vlera e caktuar e Huas (e shprehur në rial saudit)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1	Punime civile	103,750,000	100% e shpenzimeve të përgjithshme
2	Shërbime këshillimi	7,500,000	100% e shpenzimeve të përgjithshme
3	Kontigjenca	1,250,000	
TOTAL		**112,500,000**	

B. Pavarësisht dispozitave të paragrafit A më lart, nuk do të kryhet asnjë tërheqje në lidhje me pagesat e kryera për:

1. Shpenzime para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur thuhet ndryshe në dispozitën specifike të kësaj marrëveshjeje; dhe

2. Tatime të caktuara nga ose në territorin e Huamarrësit për mallra ose shërbime ose mbi importin, prodhimin, prokurimin apo furnizimin e tyre.

C. Pavarësisht caktimit të një shume të Huas ose disbursimit të përqindjeve të përcaktuara në tabelën në paragrafin A më lart, nëse Fondi ka llogaritur në mënyrë të arsyeshme se vlera e Huas e caktuar për kategorinë është e pamjaftueshme për financimin e përqindjes së dakordësuar të të gjitha shpenzimeve në atë kategori, Fondi, me kërkesë të Huamarrësit, mund të:

i. rialokojë në këtë kategori, në masën e kërkuar për të plotësuar mangësinë e llogaritur, fonde të Huas që në atë moment nuk janë të caktuara ose janë të caktuara për një kategori tjetër dhe që, sipas opinionit të Fondit, nuk janë të nevojshme për të realizuar shpenzimet të tjera; dhe

ii. nëse ky rialokim nuk mund të përmbushë plotësisht mangësinë e llogaritur, të reduktojë disbursimin e përqindjes të zbatueshme në atë moment për këto shpenzime, në mënyrë që tërheqjet e ardhshme në kuadrin e kategorisë të

mund të vijojnë derisa të jenë kryer të gjitha shpenzimet përkatëse.

SKEDULI NR. 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti synon të rrisë standardet e ofrimit të shërbimit për zonën pranë plazhit – rruga bregdetare (Vlorë–Orikum) me gjatësi 10-km, i cili përfshin ndërtimin e një korsie biçikletash, trotuarit për këmbësorët, parkimeve, rehabilitimin e kopshteve dhe objekteve publike.

Projekti është i përbërë nga pjesët e mëposhtme:

1. Punime civile: Ky komponent përfshin të gjitha punimet civile, elektrike dhe arkitekturore, të nevojshme për përmirësimin, rehabilitimin dhe ndërtimin e strukturave në zonën turistike pranë rrugës. Gjatësia e përgjithshme e ndërhyrjes është afërsisht 10 km breg dhe përbëhet nga dy pjesë, secila nga rreth 5 km, si më poshtë:

1.1 Seksioni i parë fillon nga tuneli i Vlorës dhe përfundon pranë zonës së Hotel Soleado.

1.2 Seksioni i dytë fillon pranë Hotel Soleado dhe përfundon pranë Marinës në fshatin Radhimë.

Rëndësia dhe kompleksiteti i të dyja segmenteve janë pothuajse të njëjta, të cilat përfshijnë si në vijim:

A. Ndërtimin e një korsie biçikletash me gjerësi 3 metra në anën e djathtë të rrugës.

B. Ndërtimin e trotuareve me gjerësi 2–4 metra përgjatë plazhit.

C. Ndërtimin e parkimeve publike në të dyja anët e rrugës ekzistuese, me një kapacitet prej rreth 500 makinash.

D. Peizazhe dhe objekte publike përgjatë plazhit.

E. Rehabilitimin e plazheve aktuale dhe shtimin e aksesorëve estetikë, dekorimeve dhe shkallëve në disa zona të projektit.

F. Rehabilitimin e objekteve publike (ujësjellës, energji elektrike, dhe kanalizime).

2. Shërbimet e këshillimit:

Shqyrtimi i projekteve të detajuara; përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe mbikëqyrja e zbatimit të projektit.

Kostoja e përgjithshme e projektit është 30 milionë dollarë amerikanë, e cila është e barabartë me rreth 112,500 milionë rialë saudit, dhe projekti pritet të përfundojë në fund të vitit 2023.

SKEDULI NR. 3
AFATET E AMORTIZIMIT

Kësti nr.	Data e shlyerjes	Vlera e kështit (e shprehur në rialë saudite)
1	15 shtator 2025	2,793,000
2	15 mars 2026	2,813,000
3	15 shtator 2026	2,813,000
4	15 mars 2027	2,813,000
5	15 shtator 2027	2,813,000
6	15 mars 2028	2,813,000
7	15 shtator 2028	2,813,000
8	15 mars 2029	2,813,000
9	15 shtator 2029	2,813,000
10	15 mars 2030	2,813,000
11	15 shtator 2030	2,813,000
12	15 mars 2031	2,813,000
13	15 shtator 2031	2,813,000
14	15 mars 2032	2,813,000
15	15 shtator 2032	2,813,000
16	15 mars 2033	2,813,000
17	15 shtator 2033	2,813,000
18	15 mars 2034	2,813,000
19	15 shtator 2034	2,813,000
20	15 mars 2035	2,813,000
21	15 shtator 2035	2,813,000
22	15 mars 2036	2,813,000
23	15 shtator 2036	2,813,000
24	15 mars 2037	2,813,000
25	15 shtator 2037	2,813,000
26	15 mars 2038	2,813,000
27	15 shtator 2038	2,813,000
28	15 mars 2039	2,813,000
29	15 shtator 2039	2,813,000
30	15 mars 2040	2,813,000
31	15 shtator 2040	2,813,000
32	15 mars 2041	2,813,000
33	15 shtator 2041	2,813,000
34	15 mars 2042	2,813,000
35	15 shtator 2042	2,813,000
36	15 mars 2043	2,813,000
37	15 shtator 2043	2,813,000
38	15 mars 2044	2,813,000
39	15 shtator 2044	2,813,000
40	15 mars 2045	2,813,000
		112,500,000

Fondi Saudit për Zhvillim
RIAD, MBRETËRIA E ARABISË SAUDITE

KUSHTET E PËRGJITHSHME
TË ZBATUESHME PËR MARRËVESHJET
E HUAS

Nxjerrë nga rezoluta nr. 11/14 e Bordit të Drejtorëve të Fondit, e datës Rajab 29, 1396 A.H,
datë e cila korrespondon me datën 26 korrik 1976, A.D.

MBRETËRIA E ARABISË SAUDITE
FONDI SAUDIT PËR ZHVILLIM

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË
ZBATUESHME PËR MARRËVESHJET
E HUAS

TABELA E PËRMBAJTJES

Neni I Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme të Marrëveshjeve të Huas
Seksioni 1.01 Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme
Seksioni 1.02 Mospërputhja me Marrëveshjet e Huas
Neni II Përkufizimet; titujt
Seksioni 2.01 Përkufizimet
Seksioni 2.02 Referencat
Seksioni 2.03 Titujt
Neni III Llogaria e Huas; tarifa e Huas dhe tarifa të tjera; shlyerja; vendi i kryerjes së pagesës
Seksioni 3.01 Llogaria e Huas
Seksioni 3.02 Tarifa e Huas dhe Tarifa të tjera
Seksioni 3.03 Llogaritja e tarifës së Huas dhe tarifave të Tjera
Seksioni 3.04. Shlyerja
Seksioni 3.05. Vendi i kryerjes së pagesës
Neni IV Dispozitat e monedhës
Seksioni 4.01 Monedha me të cilët bëhen tërheqjet
Seksioni 4.02 Monedha me të cilën principali, tarifa e Huas dhe tarifa të tjera janë të pagueshme
Seksioni 4.03 Përcaktimi i monedhave
Neni V Tërheqjet e të ardhurave të Huas
Seksioni 5.01 Tërheqja nga llogaria e Huas
Seksioni 5.02 Angazhimi i veçantë nga Fondi
Seksioni 5.03 Aplikimi për tërheqjen për angazhimin e veçantë
Seksioni 5.04 Dokumentet që dëshmojnë autoritetin për të nënshkruar aplikimet për tërheqje
Seksioni 5.05 Dëshmi mbështetëse
Seksioni 5.06 Mjaftueshmëria e aplikimeve dhe e dokumenteve
Seksioni 5.07 Pagesa nga fondi i shumave të tërhequra
Neni VI Anulimi dhe pezullimi
Seksioni 6.01 Anulimi nga Huamarrësi
Seksioni 6.02 Pezullimi nga Fondi
Seksioni 6.03 Anulimi nga Fondi
Seksioni 6.04 Shumat subjekt i angazhimit të veçantë, që nuk preken nga anulimi apo pezullimi nga Fondi
Seksioni 6.05 Zbatimi i anulimit të maturimeve të Huas
Seksioni 6.06 Efektiviteti i dispozitave pas pezullimit apo anulimit
Neni VII Përshpejtimi i maturimit
Seksioni 7.01 Ngjarjet e përshpejtimit
Neni VIII Taksat dhe kufizimet; imunitetet dhe privilegjet e Fondit
Seksioni 8.01 Taksat
Seksioni 8.02. Kufizimet
Seksioni 8.03 Privilegji për të dhënat dhe komunikimet
Seksioni 8.04 Imuniteti i aseteve
Neni IX Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit
Seksioni 9.01 Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit
Neni X Zbatueshmëria e Marrëveshjes të Huas; Mosushtrimi i të drejtave;
Arbitrazhi
Seksioni 10.01 Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Huas
Seksioni 10.02 Mosushtrimi i të Drejtave
Seksioni 10.03. Arbitriazhi
Neni XI Dispozita të ndryshme
Seksioni 11.01 Njoftimet dhe Kërkesat
Seksioni 11.02 Dëshmi e autoritetit për të ndërmarrë veprime në emër të Huamarrësit
Seksioni 11.03 Veprim në emër të Huamarrësit
Seksioni 11.04 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Huas në kopje
Neni XII Data efektive; përfundimi para kohe i Marrëveshjes së Huas
Seksioni 12.02 Opinionet ligjore të certifikatave
Seksioni 12.03 Data efektive

Seksioni 12.04 Përfundimi i Marrëveshjes së Huas, pasi nuk është bërë efektive

Seksioni 12.05 Përfundimi i Marrëveshjes së Huas mbi Pagesën e Plotë

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR MARRËVESHJET E HUAS

Neni I
Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme për Marrëveshjet e Huas

Seksioni 1.01 Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme. Këto Kushte të Përgjithshme përcaktojnë afatet dhe kushtet e caktuara, përgjithësisht të zbatueshme për huat e bëra nga Fondi Saudit për Zhvillim. Ata zbatohen për çdo marrëveshje huaje që parashikon një hua të tillë në një masë të tillë, sikurse parashikohet në një marrëveshje të tillë.

Seksioni 1.02 Mospërputhshmëria me Marrëveshjet e Huas. Nëse ndonjë dispozitë e një marrëveshjeje huaje nuk është në përputhje me një dispozitë të këtyre Kushteve të Përgjithshme, do të mbizotërojë dispozita e marrëveshjes së Huas.

Neni II
Përkufizimet, titujt

Seksioni 2.01 Përkufizimet. Termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme, kurdoherë që përdoren në këto Kushte të Përgjithshme:

1. Termi "Fond" do të thotë Fondi Saudit për Zhvillim.

2. Termi "Marrëveshje Huaje" do të thotë marrëveshja e veçantë e Huas, ndaj së cilës këto Kushte të Përgjithshme do të ishin bërë të zbatueshme, pasi kjo marrëveshje mund të ndryshohet herë pas here; dhe ky term përfshin këto Kushte të Përgjithshme të zbatueshme, të gjitha marrëveshjet plotësuese të Marrëveshjes së Huas dhe të gjitha skedulet e Marrëveshjes së Huas.

3. Termi "Hua" do të thotë huaja e parashikuar në Marrëveshjen e Huas.

4. Termi "Huamarrës" do të thotë shteti, qeveria e të cilit është palë në Marrëveshjen e Huas.

5. Termi "Saudi Riyals" dhe "Riyals" do të thotë monedha e Mbretërisë së Arabisë Saudite.

6. Termi "llogari e Huas" do të thotë llogaria e hapur nga Fondi në librat e tij, në emrin e Huamarrësit të cilit i është kredituar shuma e Huas.

7. Termi "Projekt" do të thotë projekti ose programi për të cilin jepet Huaja, sikurse përshkruhet në Marrëveshjen e Huas dhe sikurse përshkrimi i saj mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

8. Termi "mallra" do të thotë pajisje, furnizime, punime dhe shërbime të tjera, të cilat kërkohen për Projektin. Kurdoherë që bëhet referencë për koston e ndonjë malli, kjo kosto do të çmohet se përfshin koston e importimit të këtyre mallrave në territoret e Huamarrësit.

9. Termi "datë efektive" do të thotë data kur Marrëveshja e Huas hyn në fuqi dhe efekt, sikurse parashikohet në nenin 12.03.

10. Termi "taksat" përfshin detyrimet doganore, detyrimet, tarifat dhe tatimet e çdo natyre, në efekt në datën e Marrëveshjes së Huas apo të vendosura më vonë.

11. Termi "datë e mbylljes" do të thotë data e specifikuar në Marrëveshjen e Huas, ku Fondi me një njoftim dërguar Huamarrësit mund të ndërpresë të drejtën e Huamarrësit të tërheqë nga Llogaria e Huas ndonjë shumë deri më tani të patërhequr.

Seksioni 2.02 Referencat. Referencat në këto Kushte të Përgjithshme për "nenet e seksioneve" janë për nenet e seksioneve të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 2.03 Titujt. Titujt e neneve dhe seksioneve dhe tabela e përmbajtjes janë futur vetëm për lehtësi të referencës dhe nuk janë një pjesë e këtyre Kushteve të Përgjithshme.

Neni III
Llogaria e Huas; tarifa e Huas dhe tarifa të tjera; shlyerja; vendi i kryerjes së pagesës

Seksioni 3.01 Llogaria e Huas. Shuma e Huas do të kreditohet në Llogarinë e Huas dhe mund të tërhiqet prej saj nga Huamarrësi sikurse parashikohet në Marrëveshjen e Huas dhe në këto Kushte të Përgjithshme dhe në përputhje me procedurat për tërheqjen e përcaktuar nga Fondi.

Seksioni 3.02 Tarifa e Huas dhe tarifa të tjera: a) Huamarrësi do të paguajë një tarifë të Huas në normën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas mbi shumën e principalit të Huas të tërhequr dhe të

papaguar herë pas here. Tarifa e Huas do të shtohet nga datat përkatëse mbi të cilat tërhiqen shumat.

b) Huamarrësi do të paguajë një tarifë shtesë në normën një e dyta e një për qind (1/2 e 1%) në vit mbi shumën e principalit të çdo angazhimi të veçantë të lidhur nga Fondi në zbatim të seksionit 5.02 dhe të papaguar herë pas here.

Seksioni 3.03 Llogaria e tarifës së Huas dhe tarifave të tjera. Tarifa e Huas dhe tarifat e tjera llogariten në bazë të një viti 360 ditë për 12 muaj 30 ditë secila për çdo periudhë më pak se një vit.

Seksioni 3.04 Shlyerja: a) Huamarrësi paguan shumën e principalit të Huas së tërhequr nga Llogaria e Huas, në përputhje me skedulin e amortizimit të Marrëveshjes së Huas.

b) Huamarrësi ka të drejtë, me kryerjen e pagesës së të gjithë tarifës së shtuar të Huas dhe të gjitha tarifave të tjera dhe me njoftimin paraprak dërguar Fondit jo më pak se dyzet e pesë ditë, të paguajë paraprakisht maturimin: i. e të gjithë shumës së principalit të Huas në kohën e papaguar; ose iii. e të gjithë shumës së principalit të një apo më shumë maturimeve, me kusht që në datën e një parapagese të tillë nuk do të ketë mbetur e papaguar ndonjë pjesë e Huas, e cila maturohet pasi pjesa të jetë parapaguar.

Seksioni 3.05 Vendi i kryerjes së pagesës. Principali dhe tarifa e Huas dhe tarifat e tjera mbi Huan paguhen në vendet që do të vendosë Fondi.

Neni IV
Dispozitat e monedhës

Seksioni 4.01. Monedha që përdoret për Tërheqjet: a) Tërheqjet e të ardhurave të Huas do të bëhen në monedhën Saudi Riyals.

b) Fondi, me kërkesë dhe duke vepruar si një agjent, i Huamarrësit, blen me Riayls të tërhequra nga llogaria e Huas monedha të tilla, sikurse do të kërkohet që pagesa të financohet nga të ardhurat e Huas, me kusht që këto monedha të përdoren nga Agjencia Monetare e Arabisë Saudite në transaksionet e saj.

Seksioni 4.02 Monedha me të cilën principali, tarifa e Huas dhe tarifa të tjera janë të pagueshme: a) Principali i Huas dhe tarifa e Huas dhe tarifa të tjera do të paguhen në Saudi Riyals.

b) Fondi, sipas kërkesës dhe duke vepruar si një agjent i Huamarrësit, do të blejë Riyals që nevojitet nga blerësi për shlyerjen e principalit dhe pagimin e tarifës së Huas dhe tarifa të tjera të cilat kërkohen sipas Marrëveshjes së Huas, me pagimin në kohë nga Huamarrësi të fondeve të mjaftueshme në një monedhë apo monedha të pranueshme për Fondin. Huamarrësi çmohet se ka kryer çdo pagesë të kërkuar sipas Marrëveshjes së Huas vetëm kur dhe në masën që Fondi të ketë marrë pagesën në Riyals.

Seksioni 4.03 Vleftësimi i Monedhave. Kurdoherë që do të konsiderohet e nevojshme për qëllimet e Marrëveshjes së Huas për të përcaktuar vlerën e një monedhe në termat e një tjetre, kjo vlerë do të përcaktohet nga Agjencia Monetare e Arabisë Saudite.

Neni V
Tërheqja e të ardhurave të Huas

Seksioni 5.01 Tërheqjet nga llogaria e Huas. Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga Llogaria e Huas ekuivalencën në Riyals të shumave të shpenzuara ose nëse Fondi bie dakord, të shumave që duhet të shpenzohen për Projektin, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huas dhe të këtyre Kushteve të Përgjithshme dhe sipas rregullave dhe procedurave të caktuara nga Fondi.

Seksioni 5.02 Angazhimi i veçantë nga Fondi. Me kërkesën e Huamarrësit dhe kur këto afate dhe kushte të bihen dakord ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit, Fondi mund të lidhë angazhime të veçanta me shkrim për t'i paguar shumat Huamarrësit apo të tjerëve, në lidhje me shpenzimet që duhet të financohen, sipas Marrëveshjes së Huas, pavarësisht ndonjë pezullimi apo anulimi të mëtejshëm nga Fondi apo Huamarrësi, në zbatim të nenit VI.

Seksioni 5.03 Aplikimet për tërheqjen apo angazhimin e veçantë. Kur Huamarrësi dëshiron të tërheqë ndonjë shumë nga llogaria e Huas apo t'i kërkojë Fondit të lidhë një angazhim të veçantë në zbatim të seksionit 5.02, Huamarrësi do t'i japë Fondit një aplikim me shkrim në këtë formë, duke përfshirë deklaratat dhe marrëveshjet, që Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme. Aplikimet për tërheqjen, me dokumentacionin e nevojshëm, sikurse parashikohet më poshtë në këtë nen, do të bëhen menjëherë në lidhje me shpenzimet për Projektin.

Seksioni 5.04 Dokumentet që dëshmojnë Autoritetin për të nënshkruar aplikimet për

tërheqje. Huamarrësi i jep Fondit dëshmi të autoritetit të personit apo personave të autorizuar të nënshkruajnë aplikime për tërheqjen dhe nënshkrimin model të vërtetuar të një personi të tillë.

Seksioni 5.05 Dëshmi mbështetëse. Huamarrësi i jep Fondit dokumente dhe dëshmi të tjera në mbështetje të aplikimit, sipas kërkesës së Fondit. Fondi ka të drejtë të kërkojë ndonjë dokument apo dëshmi tjetër përpara ose pasi Fondi të ketë lejuar ndonjë tërheqje të kërkuar në aplikim.

Seksioni 5.06 Mjaftueshmëria e aplikimeve dhe e dokumenteve. Çdo aplikim dhe dokumentet shoqërues dhe dëshmi të tjera duhet të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje, me qëllim që Fondi të jetë i bindur se Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga Llogaria e Huas shumën e aplikuar dhe se shuma që duhet të tërhiqet nga Llogaria e Huas duhet të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuara në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 5.07. Pagesa nga Fondi i shumave të tërhequra. Fondi paguan shumat e tërhequra nga Huamarrësi nga Llogaria e Huas vetëm për ose sipas porosisë së Huamarrësit.

Neni VI
Anulimi dhe pezullimi

Seksioni 6.01 Anulimi nga huamarrësi. Huamarrësi, me një njoftim dërguar Fondit, mund të anulojë çdo shumë të Huas që Huamarrësi nuk ka tërhequr përpara dhënies së një njoftimi të tillë, me përjashtim të asaj që Huamarrësi nuk mund të anulojë ndonjë shumë të Huas, në lidhje me të cilin Fondi ka lidhur një angazhim të veçantë në zbatim të seksionit 5.02.

Seksioni 6.02 Pezullimi nga fondi. Nëse ndonjë nga këto ngjarje ka ndodhur dhe vazhdon, Fondi me një njoftim dërguar Huamarrësit, mund të pezullojë të gjithë ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e Huas:

a) Huamarrësi nuk ka mundur të kryejë pagesën e principalit apo tarifën e Huas apo ndonjë pagesë tjetër që kërkohet, sipas Marrëveshjes së Huas apo ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje të lidhur ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit;

b) Huamarrësi nuk ka mundur të përmbushë ndonjë detyrim tjetër sipas Marrëveshjes së Huas;

c) Fondi ka pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje të lidhur ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit për shkak të mospërmbushjes nga ana e Huamarrësit për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje;

d) si rezultat i ngjarjeve të cilat kanë ndodhur pas datës së Marrëveshjes së Huas, ka lindur një situatë e jashtëzakonshme që do bëjë të pamundur zbatimin e Projektit apo që Huamarrësi të mund të kryejë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Huas;

e) pas datës së Marrëveshjes së Huas dhe përpara Datës Efektive, ka ndodhur një ngjarje që do t'i kishte dhënë Fondit të drejtën të pezullojë të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Huas nëse Marrëveshja e Huas do të ishte bërë efektive në datën kur ka ndodhur një ngjarje e tillë;

f) ka ndodhur ndonjë ngjarje tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllimet e këtij Seksioni.

E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Huas do të vazhdojë të jetë e pezulluar në tërësi apo pjesërisht, sipas rastit, deri kur ngjarja apo ngjarjet që kanë krijuar pezullimin, nuk ekzistojnë më, vetëm në rast se Fondi ka njoftuar Huamarrësin se e drejta për të bërë tërheqje është rivendosur; me kusht, megjithatë, që në rast se një njoftim i tillë për rregullimin e të drejtës për të bërë tërheqje rregullohet deri në masën dhe sipas kushteve të specifikuara në këtë njoftim, dhe një njoftim i tillë nuk do të prekë apo dëmtojë ndonjë të drejtë, tagër apo mjet juridik të Fondit, në lidhje me ndonjë ngjarje të mëpasshme të përshkruar në këtë seksion.

Seksioni 6.03 Anulimi nga Fondi. Nëse: a) e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Huas do të jetë pezulluar lidhur me ndonjë shumë të Huas për një periudhë të vazhdueshme për gjashtë dhjetë ditë; ose b) në çdo kohë kur Fondi vendos, pas konsultimit me Huamarrësin, se një shumë e Huas nuk do të kërkohet për të financuar kostot e Projektit për t'u financiar nga të ardhurat e Projektit; ose c) pas datës së mbylljes një shumë e Huas do të mbetet e pa tërhequr nga Llogaria e Huas, Fondi me një njoftim dërguar Huamarrësit, mund të ndërpresë të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje lidhur

me këtë shumë. Me dhënien e këtij njoftimi kjo shumë e Huas anulohet.

Seksioni 6.04 Shumat subjekt i angazhimit të veçantë që nuk preken nga anulimi apo Pezullimi nga Fondi. Asnjë anulim apo pezullim nga Fondi nuk do të zbatohet për shumat subjekt i ndonjë angazhimi të veçantë të lidhur nga Fondi në zbatim të seksionit 5.02, me përjashtim sikurse parashikohet në një angazhim të tillë.

Seksioni 6.05 Aplikimi i anulimit të maturimeve të Huas. Me përjashtim sikurse parashikohet ndryshe ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit, çdo anulim do të zbatohet në mënyrë proporcionale në disa maturime të shumës së principalit të Huas që do të maturohet pas datës së një anulimi të tillë.

Seksioni 6.06 Efikasiteti i dispozitave pas pezullimit apo anulimit. Pavarësisht ndonjë anulimi apo pezullimi, të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Huas do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë me përjashtim sa parashikohet në mënyrë specifike në këtë nen.

Neni VII
Përshpejtimi i maturimit

Seksioni 7.01 Ngjarjet e përshpejtimit. Nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme ndodhin dhe vazhdojnë për periudhën e specifikuar më poshtë në lidhje me të, atëherë në çdo kohë të mëtejshme gjatë vazhdimit të tij, Fondi, sipas zgjedhjes së tij, duke i dhënë një njoftim Huamarrësit, mund të deklarojë principalin e Huas të papaguar që duhet të paguhet dhe të bëhet e pagueshme menjëherë së bashku me tarifën e Huas dhe tarifa të tjera dhe me një deklaratë të tillë principali, së bashku me tarifën e Huas dhe tarifa të tjera, bëhen për t'u paguar dhe menjëherë të pagueshme, në rastet kur:

a) ndodh një mospërmbushje në pagesën e principalit apo tarifën e Huas apo ndonjë pagesë tjetër që kërkohet sipas Marrëveshjes së Huas dhe një mospërmbushje e tillë vazhdon për një periudhë gjashtëdhjetë ditë.

b) ndodh një mospërmbushje në pagesën e principalit apo tarifën e Huas apo ndonjë pagese tjetër, që kërkohet sipas ndonjë marrëveshje tjetër huaje të lidhur ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit dhe një mospërmbushje e tillë vazhdon për një periudhë gjashtëdhjetë ditë.

d) Ndodh një mospërmbushje në kryerjen e ndonjë detyrimi nga ana e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas dhe një mospërmbushje e tillë vazhdon për një periudhë nëntëdhjetë ditë pasi njoftimi i është dhënë Fondit nga Huamarrësi.

e) Ka ndodhur një ngjarje tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllimet e këtij seksioni dhe kjo ngjarje vazhdon për periudhën, nëse ka ndonjë, të specifikuar në Marrëveshjen e Huas.

Neni VIII
Taksat dhe kufizimet; imunitetet dhe privilegjet e Fondit

Seksioni 8.01 Taksat: a) Principali dhe tarifa e Huas dhe tarifat e tjera mbi Huan paguhen pa zbritje dhe pa ndonjë taksë të vendosur nga apo në territoret e Huamarrësit. Këto taksa, nëse ka ndonjë, do të jenë për llogari dhe do të paguhen nga Huamarrësi.

b) Marrëveshja e Huas nuk do të ketë ndonjë taksë të vendosur nga apo në territorin e Huamarrësit mbi apo në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin dhe regjistrimin e saj.

Seksioni 8.02. Kufizimet. Principali dhe tarifa e Huas dhe tarifat e tjera mbi Huan do të paguhen pa kufizimet e vendosura, sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve në efekt në territoret e tij.

Seksioni 8.03 Privilegji i të dhënave dhe komunikimet. Të gjitha dokumentet, të dhënat, korrespondenca dhe materiale të kësaj natyre të Fondit do të konsiderohen nga Huamarrësi si çështje konfidenciale. Huamarrësi do t'i japë Fondit të gjithë imunitetin nga censurimi dhe kontrolli i publikimeve.

Seksioni 8.04 Imuniteti i aseteve. Të gjitha pronat, asetet dhe të ardhurat e Fondit në territoret e Huamarrësit do të jenë imune nga blerja, konfiskimi, shpronësimi, konfiskimi dhe sekuestrimi.

Neni IX
Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit

Seksioni 9.01 Bashkëpunimi dhe Shkëmbimi i Informacionit. a). Fondi dhe Huamarrësi do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar se qëllimet e Huas do të përmbushen. Në këtë drejtim:

i. Fondi dhe Huamarrësi herë pas here, me kërkesë të njërit prej tyre, do të shkëmbejnë këndvështrime nëpërmjet përfaqësuesve të tyre

lidhur me ecurinë e Projektit, përfitimet që rrjedhin nga Projekti dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse, sipas Marrëveshjes së Huas dhe çështje të tjera lidhur me qëllimet e Huas; dhe

ii. Fondi dhe Huamarrësi, herë pas here, me kërkesë të njërit prej tyre, do t'i japin njëri-tjetrit të gjithë informacionin që pala do të kërkojë lidhur me ecurinë e Projektit, përfitimet që rrjedhin nga projekti dhe statusin e përgjithshëm të Huas.

b) Fondi dhe Huamarrësi do të informojnë njëri-tjetrin menjëherë për çdo kusht që ndërhyn në ose kërcënon të ndërhyjë në ecurinë e Projektit, përmbushjen e qëllimeve të Huas (duke përfshirë rritjen thelbësore në koston e Projektit), mirëmbajtjen e shërbimit të Projektit apo përmbushjen nga njeri prej tyre i detyrimeve sipas Marrëveshjes së Huas.

c) Huamarrësi do të bëjë të gjitha përpjekjet që përfaqësuesit e akredituar të Fondit të vizitojnë ndonjë pjesë të territorit të tij për qëllimet lidhur me Huan.

d) Huamarrësi do t'u ofrojë lehtësirat e nevojshme përfaqësuesve të akredituar të Fondit të ngarkuar me detyrat lidhur me Huan në territorin e Huamarrësit, dhe do t'u japë këtyre përfaqësuesve të gjitha imunitetet e ngjashme me ato që iu janë dhënë anëtarëve të misioneve diplomatike.

Neni X

Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Huas; mosushtrimi i të drejtave; arbitrazhi

Seksioni 10.01 Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Huas. Të drejtat dhe detyrimet e Fondit dhe Huamarrësit, sipas Marrëveshjes së Huas do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre pavarësisht ndonjë ligji të Huamarrësit apo ndonjë të nënndarjeve të tij politike në të kundërtën. As Fondi dhe as Huamarrësi nuk kanë të drejtë, sipas ndonjë rrethane të pohojnë ndonjë pretendim që ndonjë dispozitë e këtyre Kushteve të Përgjithshme apo të Marrëveshjes së Huas është e pavlefshme apo e pazbatueshme për ndonjë arsye.

Seksioni 10.02 Mosushtrimi i të drejtave. Asnjë vonesë në ushtrimin apo mosveprimi për të ushtruar ndonjë të drejtë, tagër apo mjet ligjor që i shtohet secilës palë sipas Marrëveshjes së Huas mbi ndonjë mospërmbushje, nuk do të prekë ndonjë të drejtë, tagër apo mjet ligjor apo të interpretohet si heqje dorë prej tyre apo pranim i heshtur në këtë mospërmbushje dhe as ndonjë veprim i kësaj pale, në lidhje me këtë mospërmbushje apo ndonjë pranim nga ana e tij në ndonjë mospërmbushje, ndikon apo dëmton ndonjë të drejtë, tagër apo mjet ligjor të kësaj pale në lidhje me ndonjë mospërmbushje tjetër apo të mëpasshme.

Seksioni 10.03 Arbitrazhi. Çdo mospërputhje ndërmjet Palëve të Marrëveshjes së Huas dhe çdo pretendim nga kjo palë ndaj palës tjetër, që lind sipas Marrëveshjes së Huas do të zgjidhet me marrëveshje të palëve dhe nëse kjo nuk ndodh mosmarrëveshja apo pretendimi do t'i nënshtrohen arbitrazhit nga një Gjykatë Arbitrazhi sikurse parashikohet më poshtë.

a) Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra që caktohen si më poshtë: një arbitër caktohet nga Fondi; një arbitër i dytë caktohet nga Huamarrësi; dhe një arbitër i tretë (në vijim ndonjëherë referuar si gjyqtar arbitrazhi) caktohet me marrëveshje të palëve ose nëse palët nuk bien dakord, nga Presidenti i Organizatës së Konferencës Islamike. Nëse asnjëra prej palëve nuk arrin të caktojë një arbitër, një arbitër i tillë caktohet nga Presidenti i Organizatës së Konferencës Islamike me kërkesë të palës tjetër. Në rast se një arbitër i caktuar në përputhje me këtë seksion jep dorëheqje, ndërron jetë apo bëhet i paaftë për të vepruar, caktohet një arbitër pasardhës në të njëjtën mënyrë sikurse përshkruhet këtu për caktimin e arbitrit origjinal dhe ky arbitër pasardhës do të ketë të gjitha tagrat dhe detyrat e një arbitri të tillë origjinal.

b) Procedura e arbitrazhit mund të fillojë sipas këtij seksioni, pas njoftimit që pala që fillon një procedurë të tillë i jep palës tjetër. Ky njoftim përmban një deklaratë ku përcaktohen natyra e polemikës apo e pretendimit që duhet t'i nënshtrohet arbitrazhit dhe natyra e ndihmës të kërkuar dhe emri i arbitrit të caktuar nga pala që fillon këtë procedurë. Brenda tridhjetë ditësh pas këtij njoftimi, pala tjetër i njofton palës që fillon procedurën emrin e arbitrit të caktuar nga kjo palë tjetër.

c) Nëse brenda gjashtëdhjetë ditësh pas njoftimit për fillimin e procedurës së arbitrazhit palët nuk kanë rënë dakord mbi një gjyqtar arbitrazhi, çdo palë mund të kërkojë caktimin e një gjyqtar arbitrazhi sikurse parashikohet në paragrafin (a) të këtij seksioni.

d) Gjykata e Arbitrazhit mblidhet në kohën dhe vendin që caktohet nga gjyqtar arbitrazhi. Më pas, Gjykata e Arbitrazhit përcakton vendin dhe orën kur do të mblidhet.

e) Gjykata e Arbitrazhit vendos mbi të gjitha çështjet lidhur me kompetencën e saj dhe sipas dispozitave të këtij seksioni dhe me përjashtim kur palët bien dakord ndryshe, përcakton procedurën e tij. Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të merren me votën e shumicës.

f) Gjykata e Arbitrazhit do t'u ofrojë palëve një seancë të drejtë dhe do të japë vendimin e saj me shkrim. Ky vendim mund të jepet në mungesë. Vendimi i nënshkruar nga shumica e Gjykatës së Arbitrazhit do të përbëjë vendimin e kësaj Gjykate. Secilës palë do t'i dërgohet një kopje e nënshkruar e vendimit. Një vendim i tillë i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij seksioni do të jetë përfundimtare dhe detyruese mbi palët e Marrëveshjes së Huas. Secila palë do të zbatojë dhe do të jetë në përputhje me çdo vendim të tillë.

g) Palët do të përcaktojnë shumën e shpërblimit të arbitrave dhe personave të tjerë sikurse do të kërkohet për kryerjen e procedurave të arbitrazhit. Nëse Palët nuk bien dakord mbi këtë shumë përpara se Gjykata e Arbitrazhit të mblidhet, Gjykata e Arbitrazhit do të paguajë kostot e tij në procedurat e arbitrazhit. Kostot e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen ndërmjet dhe do të mbulohen nga palët në mënyrë të barabartë. Çdo pyetje në lidhje me ndarjen e kostove të Gjykatës së Arbitrazhit apo procedurat për shlyerjen e këtyre kostove do të vendoset nga Gjykata e Arbitrazhit.

h) Gjykata e Arbitrazhit do të zbatojë rregulloret dhe urdhrat e zbatueshme në Mbretërinë e Arabisë Saudite, si dhe parimin e barazisë.

i) Dispozitat e arbitrazhit të përcaktuara në këtë seksion do të jenë në vend të çdo procedurë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të Marrëveshjes së Huas dhe çdo pretendimi të palëve ndaj njëra-tjetrës që lindin sipas saj.

j) Njoftimi apo ndonjë proces në lidhje me ndonjë procedurë sipas këtij seksioni mund të dërgohet në mënyrën e parashikuar në seksionin 11.01. Palët në Marrëveshjen e Huas heqin dorë nga të gjitha kërkesat e tjera për dërgimin e një njoftimi apo procesi të tillë.

Neni XI
Dispozita të ndryshme

Seksioni 11.01 Njoftimet dhe kërkesat. Çdo njoftim apo kërkesë që kërkohet apo lejohet të jepet apo të bëhet, sipas Marrëveshjes së Huas do të jetë me shkrim. Me përjashtim sa parashikohet ndryshe në seksionin 12.03, ky njoftim apo kërkesë do të konsiderohet e dhënë apo e bërë rregullisht, kur i është dorëzuar dorazi ose me postë të regjistruar, telegram, telefon, teleks apo radiogram palës tjetër për të cilin kërkohet apo lejohet të jepet apo të bëhet në adresën e kësaj pale të specifikuar në Marrëveshjen e Huas apo në ndonjë adresë tjetër që kjo palë do të ketë vendosur, duke i dërguar njoftim palës që jep këtë njoftim apo që bën këtë kërkesë.

Seksioni 11.02 Dëshmitë e Autoritetit për të kryer veprime në emër të huamarrësit. Huamarrësi do t'i japë Fondit dëshmi të mjaftueshme të autoritetit të personit apo personave që në emër të Huamarrësit do të marrin çdo veprim apo do të nënshkruajnë çdo dokument që kërkohet apo lejohet të merret apo nënshkruhet nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huas dhe nënshkrimin model të vërtetuar të këtij personi.

Seksioni 11.03 Veprimi në emër të Huamarrësit: a) Çdo veprim që kërkohet apo lejohet të merret dhe çdo dokument që kërkohet apo lejohet të nënshkruhet, në zbatim të Marrëveshjes së Huas, në emër të Huamarrësit, duhet të merret apo nënshkruhet nga përfaqësuesi i Huamarrësit të caktuar në Marrëveshjen e Huas, për qëllimet e këtij seksioni apo ndonjë personi të autorizuar me shkrim nga ai.

b) Çdo modifikim apo zgjerim i dispozitave të Marrëveshjes së Huas mund të bihet dakord në emër të Huamarrësit me një instrument me shkrim të nënshkruar në emër të Huamarrësit nga përfaqësuesit e caktuar në zbatim të nënseksionit (a) të këtij seksioni apo ndonjë personi të autorizuar me shkrim nga ai; me kusht që për mendimin e këtij përfaqësuesi, ky modifikim apo zgjerim është i arsyeshëm në rrethanat dhe nuk do të rrisë në mënyrë thelbësore detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas. Fondi mund të pranojë ekzekutimin nga ky përfaqësues apo person tjetër të çdo instrumenti apo dëshmie vendimtare që në mendimin e këtij përfaqësuesi çdo modifikim apo zgjerim i dispozitave të Marrëveshjes së Huas të

ndikuara nga një instrument i tillë është i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do të rrisë në mënyrë thelbësore detyrimet e Huamarrësit.

Seksioni 11.04 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Huas në kopje. Marrëveshja e Huas mund të nënshkruhet në disa kopje, secila prej tyre do të jetë origjinale.

Neni XII
Data efektive; përfundimi i marrëveshjes së Huas

Seksioni 12.01 Kushtet pararendëse të efikasitetit të Marrëveshjes së Huas. Marrëveshja e Huas do të jetë efektive atëherë kur dëshmitë e pranueshme për Fondin i janë dhënë Fondit:

a) se nënshkrimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes së Huas në emër të Huamarrësit janë autorizuar rregullisht dhe ratifikuar nga të gjitha veprimet e domosdoshme qeveritare dhe të tjera; dhe

b) kanë ndodhur të gjitha ngjarjet e specifikuara në Marrëveshjen e Huas si kushte për efikasitetin.

Seksioni 12.02 Opinionet ligjore dhe certifikatat. Si pjesë e dëshmisë për t'u dhënë në zbatim të seksionit 12.01, Fondit do t'i jepet një opinion apo opinione të përshtatshme për Fondin, të autoritetit ligjor qeveritar të pranueshme për Fondin ose nëse Fondi kërkon, një certifikatë të pranueshme për Fondin të një zyrtari kompetent të Huamarrësit, që tregon se:

a) Marrëveshja e Huas është autorizuar apo ratifikuar rregullisht nga dhe nënshkruar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe është e detyrueshme ligjërisht mbi Huamarrësin në përputhje me kushtet e tij; dhe

b) çështje të tjera, sikurse do të specifikohet në Marrëveshjen e Huas ose sikurse kërkohen nga Fondi në lidhje me të.

Seksioni 12.03 Data efektive: a) Me përjashtim sikurse bihet dakord ndryshe nga Fondi dhe Huamarrësi, Marrëveshja e Huas do të hyjë në fuqi dhe efekt në datën kur Fondi t'i ketë dhënë Huamarrësit njoftimin e pranimit nga ana e tij të dëshmisë që kërkohet nga seksioni 12.01.

c) Nëse, përpara datës efektive, ka ndodhur ndonjë ngjarje që do t'i kishte dhënë Fondit të drejtën të pezullojë të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e Huas nëse Marrëveshja e Huas do të ishte bërë efektive, Fondi mund të shtyjë dërgimin e njoftimit të referuar në paragrafin (a) të këtij seksioni deri kur kjo ngjarje të ketë përfunduar së ekzistuari.

Seksioni 12.04 Përfundimi i Marrëveshjes së Huas, pasi nuk është bërë efektive. Nëse Marrëveshja e Huas nuk ka hyrë në fuqi dhe efekt në datën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllimet e këtij seksioni, Fondi mund që, në çdo kohë më pas sipas zgjedhjes së tij, të ndërpresë Marrëveshjen e Huas, duke i dhënë njoftim Huamarrësit. Me dhënien e këtij njoftimi, Marrëveshja e Huas dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë.

Seksioni 12.05 Përfundimi i Marrëveshjes së Huas dhe pagesa e plotë. Nëse dhe kur e gjithë shuma e principalit të Huas së tërhequr nga Llogaria e Huas dhe e gjithë tarifa e Huas dhe tarifa të tjera që i janë shtuar Huas do të jenë paguar, Marrëveshja e Huas dhe të gjitha detyrimet e palëve të parashikuara në marrëveshje do të përfundojnë menjëherë.

LIGJ
Nr. 84/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2019, PËR PROJEKTIN "TRANSPORT I QËNDRUESHËM NË TIRANË (DKTI)"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2019, për projektin "Transport i qëndrueshëm në Tiranë (DKTI)",

sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 24.6.2021.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2019, PËR PROJEKTIN "TRANSPORT I QËNDRUESHËM NË TIRANË (DKTI)"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë, të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar premtimit financiar të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 120/2019, e datës 9 maj 2019),

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një kredi të butë, në vlerë të përgjithshme deri në 50 000 000 euro (me fjalë: pesëdhjetë milionë euro), e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim për zbatimin e projektit "Transport i qëndrueshëm në Tiranë (DKTI)", nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar, se projekti vlen për t'u mbështetur në pikëpamje të politikave zhvillimore dhe nëse vazhdon të konfirmohet aftësia kredimarrëse e Republikës së Shqipërisë, si dhe nëse Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, për sa kohë nuk është ai vetë marrësi i kredisë. Projekti nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau kredi apo shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 apo shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ato, si dhe procedura e prokurimit përcaktohen në kontratat, që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të huas dhe të financimit nuk lidhen brenda një periudhe katërvjeçare pas vitit të premtimit. Për këtë shumë afati përfundon me mbarimin e datës 31 dhjetor 2023.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve, që mund të lindin në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pagesat eventuale për shlyerjen e detyrimeve, që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë, në kontekstin e lidhjes dhe të zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1. Tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe taksa e tatime të ngjashme indirekte, që lindin në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Taksa të tjera të veçanta konsumi merren përsipër nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Krahas kësaj, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe të furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huave dhe shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr, sipas rastit, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar. Secila prej palëve në marrëveshje mund ta zgjidhë atë në çdo kohë me shkrim, duke respektuar afatin paraprak gjashtëmujor.

4. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

5. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese, përmes bisedave apo negociatave përkatëse.

Bërë në Tiranë, më 29.4.2021, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

LIGJ
Nr. 92/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), PËR MARRËVESHJEN E HUAS NDËRMJET AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR LINJËN E KREDISË PËR AGJENCINË E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për

marrëveshjen e huas ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për linjën e kredisë për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.7.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13167, datë 26.7.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

Version nënshkrimi
Numri i veprimit (52468)

MARRËVESHJE GARANCIE
E LINJËS SË KREDISË SË DISPONUESHME PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Datë 11 qershor 2021

TABELA E LËNDËS

NENI I – TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET
Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe e Kushteve Standarde
Seksioni 1.02 Përkufizimet
Seksioni 1.03 Interpretimi
NENI II – GARANCIA; DETYRIME TË TJERA
Seksioni 2.01 Garancia
Seksioni 2.02 Procedura
NENI III – TË NDRYSHME
Seksioni 3.01 Njoftimet
Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

MARRËVESHJE GARANCIE

Marrëveshje e datës 11 qershor 2021 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

PREAMBULË

Duke pasur parasysh se Garantuesi dhe Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave kanë kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e Projektit;

duke pasur parasysh se, sipas një marrëveshje huaje, të kësaj date, ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, si Huamarrës dhe Bankës ("Marrëveshja e Huas", siç përcaktohet në Termat dhe në Kushtet Standarde), Banka ka rënë dakord t'i japë një hua Huamarrësit në shumën deri në 100,000,000 euro (njëqind milionë euro), në bazë të termave dhe të kushteve të përcaktuar ose referuar në Marrëveshjen e Huas, por vetëm me kusht që Garantuesi të garantojë detyrimet e Huamarrësit, sipas Marrëveshjes së Huas, siç parashikohet në këtë Marrëveshje; dhe

duke pasur parasysh se, Garantuesi, duke pasur parasysh se Banka hyn në Marrëveshjen e Huas me Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë detyrime të tilla të Huamarrësit.

tashmë, si rrjedhojë, me anë të kësaj, palët bien dakord si më poshtë:

Neni I
Termat dhe Kushtet Standarde; përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe e Kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe e Kushteve Standarde të Bankës të datës 1 tetor 2018, përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht këtu (dispozita të tilla referohen më poshtë si Termat dhe Kushtet Standarde).

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën dhe skedulet), përveç nëse përcaktohet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në Preambulë kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atyre në të, termat e përcaktuar në Termat dhe në Kushtet

Standarde kanë kuptimet përkatëse të dhëna atyre në të dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit" nënkupton ministrin e Financave dhe Ekonomisë të Garantuesit.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një neni ose seksioni të specifikuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij neni ose seksioni të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II
Garancia; detyrime të tjera

Seksioni 2.01 Garancia

Garantuesi garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si detyruesi kryesor dhe jo thjesht si sigurues, pagesën e kërkuar dhe të përpiktë të çdo dhe të gjitha shumave të kërkueshme, sipas Marrëveshjes së Huas, qoftë në maturimin e deklaruar, me përshpejtim ose ndryshe, dhe përmbushjen e përpiktë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, të gjitha siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 2.02 Procedura

a) Garantuesi konfirmon se ka njohuri për termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Huas.

b) Banka bie dakord që çdo kërkesë për pagesë për Garantuesin, sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe një kërkesë e tillë për pagesë do të përcaktojë shumën e papaguar, sipas Marrëveshjes së Huas dhe që duhet të paguhet nga Garantuesi, datën kur kjo shumë do të paguhet nga Garantuesi, e cila do të jetë një datë jo më pak se tri ditë pune nga data e njoftimit të kërkesës.

Neni III
Të ndryshme

Seksioni 3.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 10.01 të Termave dhe të Kushteve Standarde, përveç që çdo njoftim do të konsiderohet se dorëzohet dorazi, me postë ose në formatin PDF ose format të ngjashëm me postë elektronike:

Për Garantuesin:

Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për BERZH-in:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Administrimit të Operacioneve/Veprimi nr. 52468
Telefon: +44 20 7338 6000
E-mail: oad@ebrd.com

Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

Për qëllime të seksionit 9.03(b) të Termave dhe të Kushteve Standarde dhe në përputhje me seksionin 6.02(b) të Marrëveshjes së Huas, opinioni ose opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të Garantuesit nga ministri i Drejtësisë, forma indikative e së cilës është parashtruar në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, sipas rregullave, kanë siguruar që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në tri kopje dhe dorëzohet nga palët, në ditën dhe vitin e shkruar në fillim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga:_____
Emri: Anila Denaj
Funksioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:_____
Emri: Odile Renaud-Basso
Funksioni: President

BASHKËLIDHUR
FORMA INDIKATIVE E OPINIONIT
LIGJOR TË GARANTUESIT
[Letër me kokë e ministrit të Drejtësisë]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

[Datë]

Zonja dhe zotërinj,

Lënda: Opinioni ligjor mbi Marrëveshjen e Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Marrëveshjen e Huas midis Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të dyja të datës [ ] (veprimi nr. 52468).

Më [ ] 2021 Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave ("**Huamarrësi**") dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("**Banka"**) lidhën një marrëveshje huaje ("**Marrëveshja e Huas**") dhe Republika e Shqipërisë dhe Banka lidhën një marrëveshje garancie nëpërmjet së cilës Republika e Shqipërisë garantoi detyrimet e Huamarrësit në favor të Bankës ("**Marrëveshja e Garancisë**").

Në këtë opinion, fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas do të kenë të njëjtat kuptime këtu.

Në cilësinë time si ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, kam inspektuar kopjen e nënshkruar të Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Garancisë dhe të gjithë dokumentacionin tjetër përkatës dhe kam shqyrtuar Kushtetutën e Shqipërisë së bashku me ligjet, statutet, dokumentet dhe çështje të tjera dhe kam kryer hetime të tjera që i çmoj të nevojshme ose të përshtatshme për qëllimin e dhënies së këtij opinioni. Sa më sipër, jam i mendimit dhe deklaroj përkatësisht, se:

a) [Nga *[vendosni referencën për autorizimin e qeverisë (ose atë të një personi ose organi tjetër) dhënë përfaqësuesit të Huamarrësit për të negociuar dhe nënshkruar Garancinë në emër të Republikës së Shqipërisë],* Presidenca *[ose ndonjë person ose organ tjetër i autorizuar]* i autorizuar [ ], ministri i Financave dhe Ekonomisë], për të përfunduar dhe ekzekutuar Garancinë në emër të Republikës së Shqipërisë. Autoriteti i dhënë [ ], për të ndërmarrë veprime të tilla, në emër të Republikës së Shqipërisë, vazhdoi të ishte në fuqi dhe efekt në kohën e nënshkrimit të marrëveshjeve të përmendura.

b) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë *[ose ndonjë person apo organ tjetër i tillë i autorizuar]*, pasi shqyrtoi draftet e negociuara të Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Garancisë, vendosën *[Vendosni datën e miratimit]* të miratojnë draftet e përmendura të Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Garancisë.

c) Në përputhje me dispozitat e nenit 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, traktatet që ndërmarrin detyrime financiare nga Republika e Shqipërisë, i nënshtrohen ratifikimit të miratimit nga Asambleja Parlamentare e Republikës së Shqipërisë.

d) Në përputhje me parashikimet e neneve 2, 7 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenet 117, 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ekzekutimi, dorëzimi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Huas dhe lidhja e Marrëveshjes së Garancisë u miratuan nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me *[citoni ligjin e miratuar nga Parlamenti, i cili miratoi ratifikimin e Marrëveshjes së Huas]*.

e) Në përputhje me dispozitat e *[vendosni ligjin përkatës]* kërkesa në lidhje me publikimin e ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë është përmbushur.

f) Në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kërkesat në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin dhe zbatimin e Marrëveshjes së Garancisë janë përmbushur.

g) Të gjitha aktet, kushtet dhe autorizimet që duhet të ekzekutohen, përmbushen dhe kryhen për të mundësuar Republikën e Shqipërisë, si Garantuesi dhe Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, si Huamarrësi për të lidhur në mënyrë të ligjshme, të ushtrojë të drejtat e saj, dhe të kryejë detyrimet e parashikuara në Marrëveshjen e Garancisë dhe Marrëveshjen e Huas, përkatësisht, janë përmbushur dhe kryer në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë.

h) Detyrimet e Republikës së Shqipërisë si Garantuesi dhe Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të

Depozitave si Huamarrësi, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Garancisë dhe të Huas, përkatësisht, përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Garantuesit dhe Huamarrësit dhe janë të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre përkatëse.

i) Detyrimet e Republikës së Shqipërisë të përcaktuara në Marrëveshjen e Garancisë përbëjnë detyrime ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe janë miratuar në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

Me respekt,

Ministri i Drejtësisë
Republika e Shqipërisë

VERSION NËNSHKRIMI

Numri i veprimit (52468)

MARRËVESHJE HUAJE
E LINJËS SË KREDISË SË DISPONUESHME PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NDËRMJET AGJENCISË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Datë 11 Qershor 2021

TABELA E LËNDËS

NENI I – TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIME
Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe e Kushteve Standarde
Seksioni 1.02 Përkufizime
Seksioni 1.03 Interpretimi
NENI II – KUSHTET KRYESORE TË HUAS
Seksioni 2.01 Shuma dhe monedha
Seksioni 2.02 Kushte të tjera financiare të Huas
Seksioni 2.03 Transferimet e fondeve
NENI III – EKZEKUTIMI I PROJEKTIT
Seksioni 3.01 Angazhime të tjera mbështetëse të projektit
Seksioni 3.02 Angazhime të pajtueshmërisë sociale dhe mjedisore
Seksioni 3.03 Shpeshtësia e raportimit dhe kërkesat e paraqitjes
NENI IV – ANGAZHIMET FINANCIARE DHE OPERACIONALE
Seksioni 4.01 Të dhënat dhe raportet financiare
Seksioni 4.02 Angazhime negative financiare
Seksioni 4.03 Kryerja e biznesit dhe operacioneve
NENI V – PEZULLIMI; PËRSHPEJTIMI; ANULIMI
Seksioni 5.01 Pezullimi
NENI VI - HYRJA NË FUQI
Seksioni 6.01 Kushtet para hyrjes në fuqi
Seksioni 6.02 Opinionet ligjore
Seksioni 6.03 Përfundimi për moshyrje në fuqi
NENI VII - TË NDRYSHME
Seksioni 7.01 Njoftimet
SKEDULI 1 – PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

MARRËVESHJE HUAJE
Marrëveshje e datës 11 qershor 2021 ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave ("Huamarrësi") dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka").

PREAMBULË

Duke pasur parasysh se Banka është themeluar për të siguruar financim për projekte specifike për të nxitur tranzicionin ndaj ekonomive të hapura drejt tregut dhe për të promovuar iniciativën private dhe sipërmarrëse në vende të caktuara të angazhuara dhe që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

duke pasur parasysh se Huamarrësi synon të zbatojë Projektin që përshkruhet në skedulin 1, i cili është projektuar për të asistuar Huamarrësin në gatishmërinë e fondeve për të përmbushur detyrimet e tij ndaj Depozitave të Siguruara (siç përcaktohet ai term në këtë Marrëveshje), në përputhje me Ligjin për sigurimin e depozitave në Republikën e Shqipërisë;

duke pasur parasysh se Republika e Shqipërisë dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e Projektit;

duke pasur parasysh se sipas një marrëveshjeje garancie të kësaj date ndërmjet Republikës së Shqipërisë si Garantues dhe Bankës ("Marrëveshja e Garancisë", siç përcaktohet në Termat dhe

Kushtet Standarde), Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord në bazë të, *ndër të tjera*, sa më sipër për t'i dhënë një hua Huamarrësit në shumën deri 100,000,000 euro (njëqind milionë euro), në bazë të termave dhe të kushteve të përcaktuar ose të përmendur në këtë Marrëveshje;

tashmë, si rrjedhojë, me anë të kësaj, palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Termat dhe Kushtet Standarde; përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe e Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe të Kushteve Standarde të Bankës të datës 1 tetor 2018, përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht këtu, me përjashtim të rasteve, kur Manuali i Disbursimit i BERZH-it nuk do të zbatohet (dispozita të tilla referohen më poshtë si Termat dhe Kushtet Standarde).

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën dhe skedulet), përveç nëse përcaktohet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në preambulë kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atyre në të, termat e përcaktuar në Termat dhe në kushtet standarde kanë kuptimet përkatëse të dhëna atyre në të dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Përfaqësues i Autorizuar i Huamarrësit" nënkupton drejtorin e përgjithshëm të Huamarrësit.

"ClientNet" nënkupton portalin *online* të Bankës për transmetimin e dokumenteve dhe të informacionit ndërmjet Bankës dhe klientëve të saj dhe çdo faqe interneti zëvendësuese, siç Banka mund të njoftojë herë pas here Huamarrësin.

"Kërkesat e përcaktuara të performancës" nënkupton kërkesat e performancës 1 deri në 8 dhe 10 (ose, siç mund të kërkojë konteksti, ndonjë prej këtyre kërkesave të performancës) të Kërkesave të Performancës të prillit 2019 dhe të lidhura me Politikën Sociale dhe Mjedisore të Bankës të prillit 2019.

"Politika dhe procedurat e zbatimit" nënkupton Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të Bankës, të datës 4 tetor 2017.

"Raport vjetor mjedisor dhe social" nënkupton një raport mbi çështjet mjedisore dhe sociale në formë dhe thelb të pranueshme për Bankën.

"Ligj social dhe mjedisor" nënkupton çdo ligj të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, punëtorëve, komuniteteve ose personave të prekur nga projekti.

"Vit fiskal" nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon në datën 1 janar të çdo viti.

"Autoritet qeveritar" nënkupton qeverinë e garantuesit ose të çdo nënndarjeje politike të tij, qoftë shtetërore, rajonale ose lokale dhe çdo agjenci, autoritet, degë, departament, organ rregullator, gjykatë, bankë qendrore ose subjekt tjetër që ushtron kompetenca ose funksione ekzekutive, legjislative, gjyqësore, tatimore, rregullatore ose administrative ose kompetenca ose funksione të ose që i përkasin qeverisë ose çdo nënndarjeje të saj (duke përfshirë çdo organ mbikombëtar) dhe të gjithë zyrtarët, agjentët dhe përfaqësuesit e secilit nga sa më sipër.

"Depozitë/a e siguruar/a" nënkupton "depozitat e siguruara në një bankë ose degë të saj" dhe "depozitat e siguruara në SCA", siç këta terma përcaktohen në LDI.

"Politikë investimesh" nënkupton një politikë investimi që është miratuar zyrtarisht herë pas here nga Këshilli Drejtues i Huamarrësit.

"Rast sigurimi" ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në LDI.

"Ligj për bankat" nënkupton ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, të Republikës së Shqipërisë, siç mund të ndryshohet herë pas here.

"Ligj për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e bankave" nënkupton ligjin nr. 133/2016, për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e bankave të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar herë pas here.

"Ligj për SCA-të" nënkupton ligjin nr. 52 / 2016, për shoqatat e kursimeve dhe të kredive dhe unionet e tyre, të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar herë pas here.

"LDI" nënkupton ligjin për sigurimin e depozitave, ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, të ndryshuar me pikën "i" të ligjit nr. 39/2016, "Për

disa ndryshime dhe amendime në ligjin nr. 53/2014, "Për sigurimin e depozitave" të Republikës së Shqipërisë dhe me pikën "ii" të ligjit nr. 132/2016, "Mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2014, "Për sigurimin e depozitave" të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar më tej herë pas here.

"Institucion anëtar financiar" nënkupton çdo bankë, shoqatë kursimi dhe kredie ose institucion tjetër financiar që është anëtar i skemës së sigurimit të depozitave të Huamarrësit dhe ka kuptimin që i jepet termit "Subjekt anëtar i skemës së sigurimit të depozitave" në LDI.

"Statut" nënkupton Statutin e Huamarrësit, siç mund të ndryshohet herë pas here.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një neni, seksioni ose skeduli të specifikuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij neni ose seksioni, ose skeduli të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Kushtet kryesore të Huas

Seksioni 2.01 Shuma dhe monedha

Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar ose të përmendur në këtë Marrëveshje, shumën deri 100,000,000 euro (njëqind milionë euro).

Seksioni 2.02 Kushte të tjera financiare të Huas

a) shuma minimale e transferimit të fondeve do të jetë 5,000,000 euro (pesë milionë euro);

b) shuma minimale e parapagimit do të jetë 5,000,000 euro (pesë milionë euro);

c) shuma minimale e anulimit do të jetë 5,000,000 euro (pesë milionë euro);

d) datat e pagesës së interesit do të jenë 30 maj dhe 30 nëntor çdo vit.

e) 1. Huamarrësi do të shlyejë Huan në këste gjysmëvjetore të barabarta (ose sa më të barabarta të jetë e mundur) në secilën datë të pagesës së interesit të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së Huas që është 30 maj 2022 dhe datën e fundit të shlyerjes së Huas që është 30 nëntor 2028, me kusht që asnjë shumë e çfarëdo transferimi fondesh të mos alokohet në ndonjë datë shlyerjeje që bie më pak se një vit pas datës së një transferimi të tillë.

2. Pavarësisht sa më lart, në rast se: i. Huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e Huas para datës së parë të shlyerjes së Huas të specifikuar në këtë seksion 2.02(e); dhe ii. Banka zgjat datën e fundit të disponueshmërisë të specifikuar në seksionin 2.02(f) më poshtë në një datë që bie pas datës së parë të shlyerjes së Huas, atëherë shuma e çdo transferimi fondesh të kryer në ose pas datës së parë të shlyerjes së Huas do të alokohet për shlyerje në shuma të barabarta me disa data të shlyerjes së Huas që bien pas datës së një transferimi të tillë (me Bankën që përshtat shumat e alokuara sipas nevojës, për të arritur numra të plotë në secilin rast). Banka do të njoftojë herë pas here Huamarrësin në lidhje me alokime të tilla;

f) Data e fundit e disponueshmërisë do të jetë data që bie në një datë fikse që përfaqëson përvjetorin e 2-të (e dytë) të nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose një datë të tillë të mëvonshme që Banka, sipas diskrecionit të saj, mund të vendosë pas marrjes së një kërkese paraprake me shkrim nga Huamarrësi (kërkesë që do të siglohet ose ndryshe aprovohet nga Garantuesi) dhe do të njoftojë Huamarrësin dhe Garantuesin;

g) Norma e tarifës së angazhimit do të jetë 0.5% në vit. Tarifa e angazhimit do të llogaritet dhe paguhet në përputhje me Termat dhe me Kushtet Standarde, duke përfshirë seksionin 3.05(a) të kësaj Marrëveshjeje;

h) Norma e komisionit fillestar do të jetë 0.5% e shumës maksimale totale të principalit të Huas, siç përcaktohet në seksionin 2.01;

i) Huaja i nënshtrohet një norme të ndryshueshme interesi.

Seksioni 2.03 Transferimet e fondeve

a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here gjatë periudhës së angazhimit/ disponueshmërisë vetëm për qëllimin e përcaktuar në skedulin 1 dhe për të financuar:

1. "Rastin e sigurimit", siç përcaktohet në LDI.

b) Huamarrësi mund të kërkojë disbursim, duke paraqitur në Bankë një kërkesë origjinale për një disbursim të tillë, të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit ose një person i caktuar nga një përfaqësues i tillë i autorizuar në formularin e skedulit 2 dhe kryesisht të pranueshme për Bankën, të paktën 7 (shtatë) ditë pune para datës së propozuar të një disbursimi të tillë. Kjo kërkesë do të jetë e parevokueshme dhe detyruese për Huamarrësin, përveç nëse Banka bie dakord

ndryshe. Disbursimi do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet e Projektit dhe do të zbatohet për Projektin, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

c) Pavarësisht seksionit 3.05(c) të Termave dhe të Kushteve Standarde, Huamarrësi ka zgjedhur që Komisioni Fillestar të mos paguhet nga shuma e disponueshme dhe në vend të kësaj të paguajë komisionin fillestar nga burimet e veta. Pagesa e komisionit fillestar nga Huamarrësit do të kryhet në përputhje me seksionin 3.05(d) të Termave dhe të Kushteve Standarde.

Neni III
Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01 Angazhime të tjera mbështetëse të Projektit

Përveç sipërmarrjeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin IV të Termave dhe të Kushteve Standarde, Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

a) do t'i sigurojë Garantuesit një kopje origjinale të nënshkruar/të ekzekutuar të Marrëveshjes së Huas;

b) do të njoftojë Garantuesin për të gjitha kërkesat e bëra nga Huamarrësi për Bankën për disbursime, ndryshime, heqje dorë dhe pëlqime.

Seksioni 3.02 Angazhime të pajtueshmërisë sociale dhe mjedisore

Pa kufizuar parimin e përgjithshëm të seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

a) Huamarrësi do të kryejë biznesin dhe operacionet e Huamarrësit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës 2 dhe 4 dhe ligjin mjedisor dhe social.

Seksioni 3.03 Shpeshtësia e raportimit dhe kërkesat e paraqitjes

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të paraqesë, çdo gjashtë muaj, raportet periodike të Projektit, të referuara në seksionin 4.04(a)(v) të Termave dhe të Kushteve Standarde, brenda 120 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit, derisa Projekti të ketë përfunduar. Këto raporte do të përfshijnë veçoritë e mëposhtme specifike:

1. Informacionin e mëposhtëm të përgjithshëm:

A. Ndryshimet kryesore të personelit te stafi ose bordi i Huamarrësit;

B. Çdo ndryshim në anëtarësimin e ndonjë institucioni financiar anëtar;

C. Çështjet që mund të ndikojnë në koston ose zbatimin e Projektit;

D. Çdo zhvillim ose aktivitet, që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të Huamarrësit ose të çdo institucioni financiar anëtar;

E. Çdo zhvillim ose aktivitet, që mund të kërkojë që Huamarrësi t'i paguajë çdo depozituesi të ndonjë institucioni financiar anëtar;

F. Çdo ndryshim në tarifat e pagueshme për Huamarrësin nga ndonjë ose të gjitha institucionet financiare anëtare; dhe

G. Çdo ndryshim në politikën e investimeve.

2. Detajet lidhur me pagesat e bëra në përmbushje të detyrimeve të tij ndaj depozitave të siguruara, në përputhje me LDI, në lidhje me çdo institucion financiar anëtar, sipas detyrimeve të tij ligjore të konfidencialitetit, që rrjedhin nga ligjet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Një deklaratë e shkurtër mbi statusin e pajtueshmërisë me secilën prej angazhimeve të përfshira në Marrëveshjen e Huas.

4. Raportin vjetor mjedisor dhe social të plotësuar.

b) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë, për çdo ndryshim të propozuar të ndonjë termi ose dispozite në LDI, ligjin për bankat, ligjin për SHKK-në ose ligjin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen nga bankat dhe të mbajë Bankën të informuar për procesin e miratimit të këtyre ndryshimeve.

c) Në rast se Huamarrësi ka tërhequr shuma, sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paraqesë raporte periodike në Bankë, siç mund të kërkohet nga Banka herë pas here, në lidhje me përdorimin e fondeve të tërhequra sipas kësaj Marrëveshjeje, shumat që Huamarrësi ka paguar për sa u përket depozitave të siguruara, në lidhje me secilën dhe çdo Ngjarje të sigurimit dhe shumën totale të të gjitha depozitave të siguruara në lidhje me një ngjarje të sigurimit të paguar dhe/ose për t'u paguar, të gjitha në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

d) Menjëherë pas ndodhisë së ndonjë incidenti që mund të ndikojë materialisht në pozicionin financiar të Huamarrësit ose ndonjë zhvillim ose

ndodhi të ndonjë ngjarjeje, që mund të kërkojë që Huamarrësi të paguajë në përmbushje të detyrimeve të tij ndaj depozitave të siguruara në përputhje me LDI të çdo institucioni financiar anëtar, Huamarrësi do t'i japë njoftim Bankës, duke specifikuar natyrën e një incidenti të tillë dhe çdo hap që Huamarrësi po ndërmerr për ta korrigjuar atë, nëse ka ndonjë, sipas detyrimeve ligjore të konfidencialitetit të Huamarrësit, që rrjedhin nga ligjet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

e) Sapo të vihet në dijeni për ndodhinë e ndonjë incidenti ose aksidenti në lidhje me Huamarrësin, që ka ose mund të ketë një efekt të dukshëm negativ te mjedisi, punëtorët, shëndeti ose siguria publike ose në punë, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe menjëherë pas kësaj do t'i japë njoftim Bankës, duke specifikuar natyrën e një incidenti ose aksidenti të tillë dhe çdo hap që Huamarrësi po ndërmerr për ta korrigjuar atë. Kur një incident përfshin informacionin sensitiv në lidhje me një person ose ndonjë rrezik për hakmarrjeje, njoftimi fillestar për Bankën nuk do të përfshijë asnjë detaj të identitetit të personave të përfshirë. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër:

1. Një incident ose aksident ka të bëjë me Huamarrësin, nëse ndodh në ndonjë vend të përdorur nga Huamarrësi, ose nëse është shkaktuar nga objektet, pajisjet, automjetet e përdorura për ose që kanë lidhje me Huamarrësin (pavarësisht nëse përdoren ose jo në ndonjë vend të Huamarrësit dhe pavarësisht nëse përdoren ose jo nga persona të autorizuar ose të paautorizuar);

2. Një incident ose aksident konsiderohet të ketë një efekt të dukshëm negativ te mjedisi ose shëndeti ose siguria publike ose në punë; nëse:

A. Çdo ligj i zbatueshëm kërkon dërgimin e njoftimit, për një incident ose aksident të tillë, tek çdo Autoritet Qeveritar;

B. Një incident ose aksident i tillë përfshin fatkeqësinë e çdo personi (pavarësisht nëse ky person është i punësuar nga Huamarrësi);

C. Më shumë se një person (pavarësisht nëse këto persona janë ose jo të punësuar nga Huamarrësi) ka marrë dëmtime serioze ku kërkohet shtrimi në spital;

D. Një incident i tillë përfshin dhunë dhe ngacmim, bullizëm, frikësim dhe/ose shfrytëzim, duke përfshirë çdo formë të dhunës me bazë gjinore;

E. Një incident i tillë përfshin punë të detyruar dhe të fëmijëve, në lidhje me biznesin dhe operacionet e Huamarrësit; ose

F. Publiku është vënë ose mund të vihet në dijeni mbi një incident ose aksident të tillë, qoftë përmes mbulimit nga media ose ndryshe.

f) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo kundërshtim ose peticion të rëndësishëm nga punëtorët ose anëtarët e publikut, të drejtuar për, ose lidhur me biznesin dhe operacionet e Huamarrësit, që mund të ketë një efekt negativ material. Brenda dhjetë ditëve pas çdo njoftimi të tillë, Huamarrësi do të paraqesë një raport të pranueshëm për Bankën, duke specifikuar rezultatin e hetimit të Huamarrësit për një kundërshtim ose peticion të tillë, dhe çdo hap të ndërmarrë ose që propozohet të ndërmerret nga Huamarrësi, për të zgjidhur çështjet e ngritura në kundërshtim ose peticion.

g) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën (por jo më vonë se 60 ditë para se të merret ndonjë vendim në lidhje me një pushim të tillë kolektiv nga puna, të planifikuar), që prek të paktën 10% të totalit të punonjësve të Huamarrësit ose 30 nga të punësuarit e tij (cilado të jetë më e vogël), për një periudhë 30-ditore. Në rastin e ndonjë pushimi kolektiv nga puna, të planifikuar, që prek të paktën 25% të totalit të punonjësve të Huamarrësit ose 500 nga të punësuarit e tij (cilado të jetë më e vogël) për një periudhë 30 ditë, në kohën kur i jep një njoftim të tillë Bankës, Huamarrësi do t'i japë gjithashtu Bankës një plan të zbatueshëm për menaxhimin e procesit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara të performancës 2.

Neni IV
Angazhimet financiare dhe operacionale

Seksioni 4.01 Të dhënat dhe raportet financiare

a) Huamarrësi do të mbajë procedurat, të dhënat dhe llogaritë e duhura, për të pasqyruar, në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranuara ndërkombëtarisht, të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme, operacionet dhe gjendjen financiare të Huamarrësit dhe Ndërmarrjeve të tij, nëse ka ndonjë, dhe të përshtatshme për të monitoruar dhe regjistruar progresin e Projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që do të vijnë nga ai).

b) Huamarrësi:

1. Do të ketë të dhënat, llogaritë dhe pasqyrat financiare (përfshirë bilancin, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e ndryshimeve në pozicionin financiar dhe shënimet mbi to), dhe të dhënat, llogaritë dhe pasqyrat financiare të ndërmarrjeve të tij, për çdo vit fiskal, të audituar nga auditorë të pavarur të pranueshëm për Bankën, në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të pranuara ndërkombëtarisht;

2. Do t'i japë Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se katër muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal:

A. Kopje të vërtetuara të pasqyrave të tij financiare për një vit të tillë fiskal, siç është audituar;

C. Informacion mbi depozitat e institucioneve financiare anëtare;

D. Informacion mbi portofolin e fondeve të disponueshëm për Huamarrësin, në rast se Huamarrësit i kërkohet t'u paguajë depozituesve të ndonjë institucioni financiar anëtar; dhe

3. Do t'i paraqesë Bankës informacione të tjera në lidhje me këto të dhëna, llogari dhe pasqyra financiare, dhe auditimin e tyre, siç mund të kërkojë Banka herë pas here me arsye.

Seksioni 4.02. Angazhime negative financiare

a) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin, siç Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1. Të hyjë në ndonjë marrëveshje ose angazhim, për të garantuar ose në ndonjë mënyrë ose në çdo kusht për t'u bërë i detyruar për të gjithë ose për ndonjë pjesë të ndonjë detyrimi financiar ose tjetër të një personi tjetër, përfshirë çdo ndërmarrje ose filial ose institucion financiar anëtar, përveç asaj që kërkohet në përputhje me LDI, në rast se institucioni financiar anëtar nuk mund të respektojë detyrimin e tij financiar ndaj depozituesve të tij;

2. Të hyjë në çdo transaksion me çdo person, përveç në rrjedhën e zakonshme të biznesit, mbi kushte të zakonshme tregtare dhe në bazë të angazhimeve të tregut *(arm's length)* ose të krijojë ndonjë agjenci të vetme dhe ekskluzive të blerjeve ose të shitjeve, ose të hyjë në ndonjë transaksion përmes të cilit Huamarrësi mund të paguajë më shumë se çmimi i zakonshëm tregtar për çdo blerje ose mund të marrë më pak se çmimi i plotë komercial *ex-works* (çmimi që përfshin pjesën e transportit nga prodhuesi te shitësi) (subjekt i zbritjeve normale të tregtisë) për produktet ose shërbimet e tij;

3. Të shesë, japë me qira ose të disponojë në ndonjë mënyrë tjetër ndonjë nga pasuritë e tij që kërkohen për të kryer në mënyrë të efektshme operacionet e tij ose disponimi i të cilit mund të cenojë aftësinë e tij për të përmbushur në mënyrë të pranueshme cilindo nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç se në rrjedhën normale të biznesit ku Huamarrësi kërkon likuiditet në mënyrë për të përmbushur detyrimet e tij sipas LDI-së;

4. Të ndërmarrë ose të lejojë ndonjë bashkim, konsolidim ose riorganizim korporativ;

5. Të ulë tarifat e pagueshme për Huamarrësin nga ndonjë ose të gjitha institucionet financiare anëtare, përveç atyre të përshkruara nga LDI-ja;

6. Të ndryshojë nivelin e mbulimit të sigurimit për depozitues për çdo bankë për çdo shumë mbi 50,000 euro (pesëdhjetë mijë euro);

7. Të investojë asetet e Huamarrësit përveç atyre të përshkruara nga LDI-ja; dhe

8. Të ndryshojë politikën e investimeve.

b) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, përveç nëse informon Bankën të paktën 30 ditë përpara, ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin, siç mund të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme:

1. Të hyjë në ndonjë kontratë menaxhimi ose angazhimi të ngjashme, me të cilën biznesi ose operacionet e tij menaxhohen nga ndonjë person tjetër, përfshirë çdo ndërmarrje ose filial; ose

2. Të formojë ndonjë ndërmarrje.

c) Huamarrësi nuk do të bëjë ose lejojë që të ekzistojnë hua ose paradhënie, përveç atyre të parashikuara nga LDI-ja ose depozita (përveç depozitave në rrjedhën e zakonshme të biznesit në bankat me reputacion) me persona të tjerë ose investime në ndonjë person, duke përfshirë çdo ndërmarrje ose filial ("investimi"); me kusht, megjithatë, që Huamarrësi do të jetë i lirë të bëjë çdo investim në përputhje me politikën e investimeve (siç mund të ndryshojë herë pas here) dhe të sigurojë një kopje të së cilës i është dhënë Bankës.

d) Huamarrësi përfaqëson dhe garanton që ndërmarrjet e mësipërme të Huamarrësit janë

plotësisht në përputhje me ligjin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti me LDI.

Seksioni 4.03 Kryerja e biznesit dhe operacioneve

Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

a) do të kryejë biznesin dhe operacionet e tij, në përputhje me standardet dhe praktikat administrative, financiare, inxhinierike dhe të shëndosha të njohura ndërkombëtarisht, dhe duke marrë parasysh të gjitha politikat kryesore të funksionimit;

b) do të kryejë menjëherë të gjitha veprimet brenda kompetencave të tij, për të ruajtur ekzistencën e tij ligjore, për të vazhduar veprimtarinë e tij dhe për të marrë, ruajtur dhe rinovuar të gjitha të drejtat, pronat, kompetencat, privilegjet dhe ekskluzivitetet që janë të nevojshme për ushtrimin e biznesit të tij, duke përfshirë realizimin e Projektit;

c) do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo propozim për të ndryshuar, pezulluar ose shfuqizuar çdo dispozitë të statutit dhe t'i japë Bankës një mundësi të përshtatshme për të komentuar mbi këtë propozim, përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim mbi të.

Neni V
Pezullimi; përshpejtimi; anulimi

Seksioni 5.01 Pezullimi

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e seksionit 7.01(a)(xvii) të Termave dhe të Kushteve Standarde:

a) Çdo ndryshim në LDI, ligjin për bankat, ligjin për SHKK-në ose ligjin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen nga bankat, që mund të ndikojë negativisht në operacionet e Huamarrësit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, detyrimet e mundshme të Huamarrësit dhe renditjen e Huamarrësit dhe pretendimet e depozituesve, në lidhje me depozitat e siguruara pas ndodhisë së një ngjarjeje të sigurimit, përveç atyre të aprovuara nga Banka me shkrim; ose

b) Statuti do të jetë ndryshuar, pezulluar, abroguar, shfuqizuar ose hequr dorë përveç asaj të aprovuar nga Banka me shkrim.

Neni VI
Hyrja në fuqi

Seksioni 6.01. Kushtet para hyrjes në fuqi

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e seksionit 9.02(c) të Termave dhe të Kushteve Standarde, si kushte shtesë për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Garancisë:

a) Marrëveshja e Garancisë ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe do të jetë në fuqi dhe efekt të plotë.

Seksioni 6.02. Opinionet ligjore

a) Për qëllime të seksionit 9.03(a) të Termave dhe të Kushteve Standarde, opinioni ose opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të Huamarrësit nga Përgjegjësi i Sektorit Juridik, kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 2.

b) Për qëllime të seksionit 9.03(b) të Termave dhe të Kushteve Standarde, opinioni ose opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të Garantuesit nga ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03. Përfundimi për moshyrjen në fuqi

Data 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 9.04 të Termave dhe të Kushteve Standarde.

Neni VII
Të ndryshme

Seksioni 7.01 Njoftimet

a) Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 10.01 të Termave dhe të Kushteve Standarde, përveç që çdo njoftim do të konsiderohet se dorëzohet dorazi, me postë ose në formatin PDF ose format të ngjashëm me postë elektronike:

Për Huamarrësin:
Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, pall. "Edit Al-It", nr. 317
Tiranë
Shqipëri

Në vëmendje të: Drejtorit të përgjithshëm
E-mail: gmamani@asd.gov.al

Për BERZH-in:
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Administrimit të Operacioneve/Operacioni nr. 52468
Telefon: +44 20 7338 6000
E-mail: oad@ebrd.com

b) Banka mund të ftojë Huamarrësin të regjistrohet për të përdorur *ClientNet* ose një formë tjetër të komunikimit elektronik dhe, nëse Huamarrësi dhe Banka bien dakord të përdorin *ClientNet* ose një formë tjetër të komunikimit elektronik, çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër nga Huamarrësi për Bankën ose nga Banka për Huamarrësin (përveç ndonjë njoftimi, aplikimi ose komunikimi tjetër që kërkohet nga kjo Marrëveshje [ose ndonjë Marrëveshje tjetër Financimi] të jetë në një kopje origjinale, e vërtetuar ose në letër) mund, sipas termave dhe kushteve të *ClientNet* ose një formë tjetër të komunikimit elektronik, të jepet ose bëhet duke postuar këtë njoftim, aplikim ose komunikim tjetër në *ClientNet* ose të dërguar në përputhje me kushtet e rëna dakord në lidhje me atë formë tjetër të komunikimit elektronik.

c) Çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër të dorëzuar dorazi, me postë ose faks ose përmes *ClientNet* ose një formë tjetër të komunikimit elektronik të rënë dakord, do të jetë efektive vetëm kur merret (ose vihet në dispozicion) në formë të lexueshme, me kusht që çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër që merret (ose vihet në dispozicion) pas orës 05:00 pasdite, në vendin ku pala, të cilës i është dërguar njoftimi, aplikimi ose komunikimi përkatës, ka adresën e saj për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet se bëhet efektive në ditën vijuese.

d) Më poshtë janë emrat, titujt dhe adresat e postës elektronike të personave të caktuar si kontaktet fillestare të Huamarrësit për qëllimet e çdo ftese që Banka mund t'i dërgojë Huamarrësit në lidhje me *ClientNet*.

Emri	***Funksioni***	***Adresa email***	***Gjuha - anglisht, rusisht frëngjisht***
Arben Beja	Përgjegjës i Sektorit të Analizës së Riskut	abeja@asd.gov.al	Anglisht
Ermila Petoshati	Përgjegjës i Sektorit Juridik	epetoshati@asd.gov.al	Anglisht
Ornela Shqarri	Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Investimeve	oshqarri@asd.gov.al	Anglisht

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë siguruar që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në gjashtë kopje nga palët në ditën dhe vitin e shkruar në fillim.

AGJENCIA SHQIPTARE E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Nga:_____
Emri: Genci Mamani
Funksioni: Drejtor i përgjithshëm

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:_____
Emri: Odile Renaud-Basso
Funksioni: President

SKEDULI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i Projektit është të sigurojë Huamarrësin me likuiditet dhe të ndihmojë Huamarrësin në përmbushjen e detyrimeve të tij ligjore, që rrjedhin nga një ngjarje sigurimi, për të paguar ose transferuar në lidhje me depozitat e siguruara, në përputhje me LDI-në dhe ligjin mbi rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e bankave në Republikën e Shqipërisë.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, subjekt i modifikimeve të tyre, siç Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A: 100 milionë euro, linja e kredisë së disponueshme.

3. Projekti pritet të përfundojë deri në afatin e datës së fundit të shlyerjes së Huas.

SKEDULI 2
FORMULAR I OPINIONIT LIGJOR TË HUAMARRËSIT
[Duhet të shtypet me logon zyrtare të Huamarrësit]

European Bank for Reconstruction and Development
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

[Data]

Zonja dhe zotërinj:

Re: Opinioni ligjor për Marrëveshjen e Huas ndërmjet *[vendosni emrin e plotë, ligjor të Huamarrësit, siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas]* dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në lidhje me Huan për Projektin *[vendosni emrin e Projektit, siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas].*

Në datën *[vendosni datën e Marrëveshjes së Huas],* Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka") lidhi një marrëveshje huaje ("Marrëveshja e Huas") me *[Vendosni emrin e plotë, ligjor të Huamarrësit, siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas*] ("Huamarrësi") për të asistuar në financimin e Projektit *[vendosni emrin e Projektit, siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas]* ("Projekti"), duke paraqitur një Hua në shumën prej *[vendosni shumën dhe monedhën e Huas, siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas]*.

Në të njëjtën ditë, duke pasur parasysh që Banka ka lidhur Marrëveshjen e Huas *[vendosni emrin e plotë, sovran të anëtarit të BERZH-it, siç paraqitet në Marrëveshjen e Garancisë]* ("Garantuesi") lidhi një marrëveshje garancie ("Marrëveshja e Garancisë") me Bankën.

Termat e përkufizuar në Marrëveshjen e Huas përdoren në këtë letër, siç përkufizohen në Marrëveshjen e Huas.

Në përputhje me seksionin 9.02(a) të Termave dhe të Kushteve Standarde, Marrëveshja e Huas dhe Marrëveshja e Garancisë nuk do të hyjnë në fuqi derisa provat, në formë dhe në thelb të kënaqshme për Bankën, t'i jenë dorëzuar Bankës se ekzekutimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes së Huas në emër të Huamarrësit është autorizuar ose ratifikuar sipas rregullave nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare dhe korporative. Në përputhje me seksionin 9.03(a) të Termave dhe të Kushteve Standarde, si pjesë e kësaj dëshmie, Huamarrësit i kërkohet të paraqesë ose të marrë masa që Bankës t'i paraqitet një opinion ose opinione (në formë dhe në thelb të kënaqshme për Bankën) të këshilltarit të pranueshëm nga Banka, duke treguar, ndër të tjera, se Marrëveshja e Huas është autorizuar ose ratifikuar sipas rregullave, dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht të detyrueshëm të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij.

Në përputhje me seksionin [6.02] të Marrëveshjes së Huas, një opinion i tillë ligjor duhet të jepet në emër të Huamarrësit nga *[vendosni titullin e zyrtarit që jep opinionin]*.

Në cilësinë time si *[vendosni titullin e zyrtarit që jep opinionin]* i Huamarrësit, kam inspektuar një kopje të nënshkruar të Marrëveshjes së Huas dhe të gjithë dokumentacionin tjetër përkatës dhe kam shqyrtuar ligjet, statutin, dokumentet dhe çështje të tjera dhe kam kryer hetime të tjera që i çmoj të nevojshme ose të përshtatshme për qëllimin e dhënies së këtij opinioni. Sa më sipër, jam e mendimit dhe deklaroj përkatësisht, se:

a) Huamarrësi është përcaktuar nga *[citoni ligjin, statutin, dekretin ose rezolutën përkatëse të Garantuesit që përcaktoi Huamarrësin]* dhe ekziston në mënyrë të vlefshme, sipas ligjeve të Garantuesit, me fuqinë

për të shkaktuar detyrime sipas Marrëveshjes së Huas.

b) Në datën [*vendosni datën e rezolutës së organit qeverisës të Huamarrësit që aprovon Marrëveshjen e Huas]*, *[vendosni emrin e plotë ligjor të organit qeverisës të Huamarrësit të autorizuar për të aprovuar Marrëveshjen e Huas]* të Huamarrësit, sipas kompetencave të saj në bazë të *[citoni dispozitën përkatëse të aktit themeltar ose statutit të Huamarrësit që autorizon organin qeverisës të Huamarrësit që të aprovojë Marrëveshjen e Huas]*, vendosi që:

1. teksti i Marrëveshjes së Huas të aprovohet nga Huamarrësi;

2. përmbushja e Marrëveshjes së Huas të autorizohet nga Huamarrësi; dhe

3. *[Vendosni emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit që ekzekutoi Marrëveshjen e Huas]* është i autorizuar të nënshkruajë dhe dorëzojë Marrëveshjen e Huas në emër të Huamarrësit.

c) Bashkëlidhur ndodhet një përkthim i saktë dhe besnik me origjinalin në gjuhën angleze të *[citoni rezolutën e organit qeverisës të Huamarrësit që aprovon Marrëveshjen e Huas],* duke autorizuar dhe konfirmuar çështjet e përmendura në paragrafin pararendës dhe një rezolutë e tillë është në fuqi dhe efekt të plotë dhe nuk është ndryshuar.

d) Në *[vendosni vendndodhjen e nënshkrimit të Marrëveshjes së Huas*] në datën *[vendosni datën e Marrëveshjes së Huas*], Marrëveshja e Huas u nënshkrua sipas rregullave dhe u dorëzua nga *[vendosni emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit që ekzekutoi Marrëveshjen e Huas]* në emër të Huamarrësit sipas *[citoni rezolutën e organit qeverisës të Huamarrësit që aprovon Marrëveshjen e Huas]*.

Sa më sipër, konkluzioni im është se Marrëveshja e Huas është autorizuar ose ratifikuar sipas rregullave dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj.

Bashkëlidhur ndodhen përkthime të sakta dhe besnike me origjinalin në gjuhën angleze të dispozitave përkatëse të *[citoni çdo ligj, statut, dekret ose rezolutë të Garantuesit dhe statutin, kartën dhe rezolutën e Huamarrësit të përmendur në këtë opinion]*, në bazë të së cilës është lëshuar opinioni i mësipërm. Secili dokument i tillë është në fuqi dhe efekt të plotë dhe nuk është ndryshuar.

d) Në *[vendosni vendndodhjen e nënshkrimit të Marrëveshjes së Huas]* në datën *[vendosni datën e Marrëveshjes së Huas]*, Marrëveshja e Huas u nënshkrua sipas rregullave dhe u dorëzua nga *[vendosni emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit që ekzekutoi Marrëveshjen e Huas]* në emër të Huamarrësit sipas *[citoni rezolutën e organit qeverisës të Huamarrësit që aprovon Marrëveshjen e Huas]*.

Sa më sipër, konkluzioni im është se Marrëveshja e Huas është autorizuar sipas rregullave ose ratifikuar dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj.

Bashkëlidhur ndodhen përkthime të sakta dhe besnike me origjinalin në gjuhën angleze të dispozitave të *[citoni çdo ligj, statut, dekret ose rezolutë të Garantuesit dhe statutin, kartën dhe rezolutën e Huamarrësit të përmendur në këtë opinion],* në bazë të së cilës është lëshuar opinioni i mësipërm. Çdo dokument i tillë është në fuqi dhe efekt të plotë dhe nuk është ndryshuar.

Me respekt,

[Vendosni emrin dhe titullin e zyrtarit që jep këtë opinion.]

[Rendisni shtojcat.]

SKEDULI 3
FORMA E KËRKESËS PËR TËRHEQJE FONDI

Drejtuar: Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim _____[1]

- One Exchange Square,
- London EC2A 2JN
- United Kingdom.
- Në vëmendje të: Njësisë për Administrimin e Operacioneve

Re: Marrëveshja e Huas e datës[2] ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave (Huamarrësi)

Monedha dhe shuma e Huas: 100 milionë euro

Numri i veprimit: 52468

[1] Vendosni datën e aplikimit.

[2] Vendosni datën e Marrëveshjes së Huas.

Numri i aplikimit[3]: _____

Me anë të së cilës ne kërkojmë disbursimin e mëposhtëm në llogarinë e specifikuar më poshtë, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huas të përmendur më lart:

Monedha e Huas: Euro

Shuma e kërkuar[4]: Euro_____

_____

Monedha e Pagesës: Euro _____

Data e vlerës[5]: [Sa më shpejt të jetë e mundur, në një datë të zgjedhur nga BERZH-i, sipas diskrecionit të tij, por jo më vonë se][6] _____[7]

Udhëzimet e pagesës (detajet e Bankës):

1.Numri i llogarisë së marrësit të pagesës:

_____

2. Numri i llogarisë së marrësit të pagesës/Kodi IBAN:

_____

Kodi SWIFT i Bankës së Marrësit të Pagesës:

_____

Emri i Bankës së Marrësit të Pagesës:

_____

Adresa e Bankës së Marrësit të Pagesës:

_____

Referenca e Pagesës (nëse ka ndonjë)[8]: _____

Me anë të së cilës ne vërtetojmë dhe përfaqësojmë se:

a) Një "Ngjarje sigurimi", siç përcaktohet në LDI ka ndodhur në lidhje me institucionin financiar anëtar (a) më poshtë.

Emri:_____

_____

Data:_____

_____

3.

b) Shuma e depozitave të Garantuara që Huamarrësit do t'i kërkohet të mbulojë vlerësohet të jetë:

[9] _____

_____

d) Ne kemi/nuk kemi[10] kërkuar më parë disbursim, në lidhje me ngjarjen e mësipërme të sigurimit;

e) Të ardhurat e kësaj disbursimi do të aplikohen për Projektin, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Huas.

f) Huamarrësi është në përputhje me detyrimet e tij, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huas; dhe

g) Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në gjendjen financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Huas.

Kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

Me respekt,

Nga dhe për llogari të Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave.

Emri dhe nënshkrimi:

_____

_____

Funksioni

_____

_____

Bashkëlidhur - Numri i përgjithshëm i fletëve përmbledhëse: ____

---

3 Vendosni numrin e aplikimit. Huamarrësi duhet të numërojë secilën kërkesë në mënyrë të njëpasnjëshme.

4 Vendosni shumën në shifra dhe fjalë.

5 Data kur llogaria e BERZH-it do të debitohet.

6 Nëse disbursimi kërkohet për një datë specifike të vlerës, kjo gjuhë në kllapa mund të fshihet.

7 Kjo datë nuk duhet të jetë më herët se 7 ditë pune, pasi kërkesa e disbursimit të jetë dorëzuar te BERZH-i.

8 Nëse asnjë, BERZH do të specifikojë emrin e Huamarrësit.

9 Vendosni shumën në shifra dhe në fjalë.

10 Fshini çfarë nuk është e zbatueshme.

DEKRET
Nr. 13167, datë 26.7.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe të nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 92/2021, "Për ratifikimin e marrëveshje së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për linjën e kredisë për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 93/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW) PËR MBËSHTETJEN E REFORMËS NË SEKTORIN ENERGJETIK NË SHQIPËRI - FAZA I

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri - faza I, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.7.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13168, datë 26.7.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE HUAJE
E DATËS 15 QERSHOR 2021 NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN ("KfW" DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("HUAMARRËSI") TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DH E EKONOMISË PËR 100,000,000.00 EURO – HUA E BAZUAR NË POLITIKA (PBL) – MBËSHTETJE E REFORMËS NË SEKTORIN ENERGJETIK NË SHQIPËRI – FAZA 1

BMZ - NR. 3010 00 421
HUAJA NR. 30006

PËRMBAJTJA

PREAMBULË
1. Huaja
2. Disbursimi
3. Tarifat
4. Interesi
5. Shlyerja dhe parapagimi
6. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi
7. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë
8. Paligjshmëria
9. Kostot dhe detyrimet publike
10. Detyrimet e veçanta
11. Përfundimi i Marrëveshjes
12. Përfaqësimi dhe deklaratat
13. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me programin
14. Dispozitat e përgjithshme
Shtojca 1. Njoftimi i tërheqjes së fondeve
Shtojca 2. Zotimet e pajtueshmërisë.

PREAMBULË

KfW, Agjencia Franceze për Zhvillim ("AFD") dhe Huamarrësi kanë rënë dakord mbi iniciativat e politikave, duke përcaktuar objektivat, politikat dhe veprimet siç përshkruhen në një udhërrëfyes nën Memorandumin e Mirëkuptimit mbi një përdorim të huadhënies të bazuar në politika të përbashkëta për programin "Mbështetje e Reformës në Sektorin Energjetik në Shqipëri", siç u ra dakord ndërmjet palëve të lartpërmendura më 14 dhjetor 2018 për të përmirësuar proceset e reformës sektoriale në sektorin energjetik në Shqipëri.

Termat dhe kushtet e Huas përputhen me kërkesat e OECD-së, të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohjen si Ndihmë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Mbi këtë bazë dhe me kusht që Republika Federale e Gjermanisë të japë një garanci për Huan, KfW do të japë një Hua në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

Sipas kushteve të Memorandumit të Mirëkuptimit, AFD-ja ka shprehur synimin e saj për të bashkëfinancuar Programin (siç përcaktohet më poshtë) me anë të një huaje që do t'i jepet Huamarrësit sipas një marrëveshjeje të veçantë huaje ("Marrëveshja e Huas e AFD-së").

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një Hua që nuk tejkalon një total prej 100,000,000.00 eurosh ("Huaja") (me fjalë: njëqind milionë euro).

1.2 Qëllimi. Qëllimi i Huas është të mbështesë reformat e Qeverisë së Shqipërisë në sektorin energjetik ("Programi"). Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e Programit me një marrëveshje të veçantë ("Marrëveshje e Veçantë") që do të nënshkruhet nga KfW-ja dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila do të veprojë si njësi zbatuese e programit ("Njësia për Zbatimin e Programit") dhe do të nënshkruhet si e pranuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësues i Huamarrësit.

1.3 Taksat, tarifat, detyrimet doganore. Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi, si dhe detyrimet doganore, nuk do të financohen nga Huaja.

2. Disbursimi

2.1 Kërkesat për disbursim. KfW-ja do të disbursojë Huan në një disbursim të vetëm për Huamarrësin pas marrjes së një Njoftimi të Tërheqjes së Fondeve të përfunduar dhe ekzekutuar siç duhet dhe me kusht që të jenë përmbushur të gjitha kushtet pararendëse të disbursimit në përputhje me nenin 2.3 (Kushtet pararendëse të disbursimit). Njoftimi për Tërheqjen e Fondeve është i parevokueshëm dhe do të jetë i plotë dhe i vlefshëm vetëm, nëse: i. është i parevokueshëm dhe është dorëzuar pranë KfW-së jo më vonë se në orën 12 të mesditës CET në ditën e dhjetë bankare (siç përcaktohet në nenin 14.1, "Dita e punës") para datës së disbursimit të referuar në Njoftimin e Tërheqjes së Fondeve; dhe ii. është kryesisht në formën e shtojcës 1 (Njoftimi i Tërheqjes së Fondeve).

2.2 Afati për kërkimin e disbursimeve. KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 31.3.2022.

2.3 Kushtet para disbursimit. KfW-ja është e detyruar që të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi do të ketë provuar, në një formë të pranueshme për KfW-në, me anë të paraqitjes së një opinioni ligjor, si dhe paraqitjes së kopjeve të vërtetuara (secila me një përkthim zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ky opinion ligjor, se Marrëveshja e Huas është ligjërisht efektive dhe e zbatueshme dhe, në veçanti, se:

i. Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas së drejtës së tij kushtetuese dhe dispozitave të tjera ligjore të zbatueshme për përmbushjen e vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

ii. KfW-ja është e përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesi dhe të gjitha detyrimet, komisionet dhe kostot e ngjashme në Shqipëri për dhënien e Huas;

b) KfW-ja zotëron një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Veçantë, secila e nënshkruar me fuqi ligjërisht detyruese, dhe

c) modelet e nënshkrimeve të përmendura në nenin 12.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit) të kësaj Marrëveshjeje janë marrë nga KfW-ja;

d) garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 7 (Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë) është në fuqi dhe efekt pa kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit të përcaktuar në nenin 3.2 (Tarifa e menaxhimit) të kësaj Marrëveshjeje;

f) nuk ka ndodhur asnjë arsye për zgjidhjen e Marrëveshjes, as ndonjë incident që do të përbënte shkak për zgjidhjen e Marrëveshjes me anë të njoftimit ose skadimit ose konstatimit apo plotësimit të një kushti (arsye e mundshme për zgjidhjen e Marrëveshjes);

g) nuk kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme që parandalojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

h) Huamarrësi ka siguruar prova të pranueshme për KfW-në se janë përmbushur objektivat dhe mjetet e verifikimit (siç përcaktohet në shtojcën 2 të Marrëveshjes së Veçantë).

Para disbursimit të Huas, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë dokumente dhe prova të tjera që i çmon të nevojshme sipas diskrecionit të saj, për të konstatuar kushtet paraprake për disbursimin, të përcaktuara në këtë seksion.

2.4 Detaje të procedurës së disbursimit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit dhe, në veçanti, provën për t'u siguruar nga Huamarrësi që dokumenton se shuma e kërkuar e Huas po përdoret për qëllimin e rënë dakord në Marrëveshjen e Veçantë për t'u nënshkruar nga KfW-ja dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe për t'u nënshkruar si e pranuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësuese e Huamarrësit.

2.5 E drejta për anulimin e disbursimit. Në bazë të përmbushjes së detyrimeve të tij sipas nenit 10 (Detyrime të veçanta), Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të Huas me miratimin paraprak të KfW-së kundrejt pagesës së Kompensimit të Mospranimit, në pajtim me dhe siç përcaktohet në nenin 2.6 (Kompensimi i mospranimit).

2.6 Kompensimi i mospranimit. Nëse Huamarrësi anulon disbursimin e një shume të Huas për të cilën një normë interesi është përcaktuar tashmë, sipas nenit 2.5 (E drejta për anulimin e disbursimit.) ose nëse shuma e kësaj Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 2.2 (Afati për kërkimin e disbursimeve), Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, sipas kërkesës së saj, shumën që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja si rezultat i mosdisbursimit të shumës së Huas ("Kompensimi i Mospranimit"), me përjashtim të rasteve kur mosdisbursimi përbën shkelje të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja. KfW-ja do të llogarisë shumën e kompensimit të mospranimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit.

3. Tarifat

3.1 Tarifa e Angazhimit. Huamarrësi do të paguajë një tarifë të pakthyeshme angazhimi prej 0.25% në vit ("Tarifa e angazhimit") për shumat e padisbursuara të Huas.

Tarifa e angazhimit është e kërkueshme për pagesë mbi bazë gjashtëmujore në datat 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, për herë të parë në datën 15 nëntor 2021, por jo më parë se në datën përkatëse pas ditës kur kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi dhe efekt sipas nenit 14.10 (Hyrja në fuqi dhe efekt) të kësaj Marrëveshjeje.

Tarifa e angazhimit do të llogaritet, nëse është e zbatueshme, me efekt prapaveprues, për periudhën që fillon nëntë muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që do të zgjasë deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të plotë të disbursimeve nga Huaja.

3.2 Tarifa e Menaxhimit. Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë të përgjithshme, të njëhershme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 0.50% të shumës së Huas të përcaktuar në nenin 1.1 (Shuma) ("Tarifa e menaxhimit").

Tarifa e menaxhimit është e pagueshme në rastin më të hershëm të të dyja datave të mëposhtme: i. para disbursimit të parë; ose ii. pas kalimit të tre muajve që prej nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja ose me kalimin e një periudhe njëmujore pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe efekt (cilado nga datat e përcaktuara sipas pikës "ii" është më e vonshme). Tarifa e menaxhimit është e kërkueshme për pagesë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht ose vetëm pjesërisht ose nëse nuk është disbursuar.

4. Interesi

4.1 Interesi. Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së interes si më poshtë:

Norma fikse e interesit e caktuar pas disbursimit të Huas. Huamarrësi do të paguajë normë interesi mbi Huan sipas dispozitave të mëposhtme:

a) Norma e interesit. Huamarrësi do të paguajë normë interesi për secilën shumë të disbursuar të Huas në një normë ("Norma fikse e interesit") të përcaktuar nga KfW-ja brenda dy ditësh pune (siç përcaktohet në nenin 14.1 (Ditë pune) të kësaj Marrëveshjeje, para disbursimit të shumës përkatëse të Huas dhe që do të përbëhet nga:

i. Norma e shkëmbimit e përcaktuar në bazë të faqes Rojters "ICAPEURO" ose nëse kjo faqe nuk përmban detajet e nevojshme ose nëse nuk është e aksesueshme, në faqen *Bloomberg* "ICAE" (ose në një faqe vijuese që zëvendëson faqet Rojters ose *Bloomberg* të përcaktuara më lart). Nëse të dyja faqet nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme ose janë të pazëvendësueshme, KfW-ja do të përcaktojë këtë normë mbi bazën e kostove të saj efektive të financimit në tregun e kapitalit në euro për maturimet që u korrespondojnë periudhave përkatëse të interesit fiks, sa më afër që të jetë e mundur,

ii. plus një marzh prej 1.06% (me fjalë: një pikë zero gjashtë për qind) në vit.

Nëse norma e interesit e llogaritur në përputhje me sa më lart bie nën 0% në vit, norma fikse e interesit do të jetë 0% në vit.

Norma fikse e interesit e përcaktuar në këtë mënyrë do të zbatohet derisa të jetë marrë kësti i fundit i shlyerjes, në pajtim me skedulin e shlyerjes të përcaktuar në nenin 5.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Konsolidimi. Nëse është kryer më shumë se një disbursim nga Huaja, KfW-ja do të konsolidojë normat e interesit të caktuara për secilën shumë Huaje në një normë interesi të vetëm pas secilit disbursim. Kjo normë e konsoliduar interesi fiks do t'i korrespondojë mesatares së ponderuar të normave individuale të interesit të rrumbullakosura deri në 1/10,000 të një pike për qind, nëse presja dhjetore e parë e hequr është më e ulët se 5 ose e rrumbullakosur deri në 1/10,000 të një pike për qind, nëse presja e parë dhjetore e hequr është e barabartë ose më e madhe se 5, dhe do të jetë baza për llogaritjen e mëtejshme të interesit nga data e secilit disbursim deri në disbursimin e ardhshëm. Pas disbursimit të plotë të Huas, norma mesatare e interesit e përcaktuar në këtë mënyrë do të zbatohet derisa kësti i fundit i shlyerjes të jetë marrë në përputhje me skedulin e shlyerjes të përcaktuar në nenin 5.1 (Grafiku i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

c) Njoftimi i normës së interesit. KfW-ja do t'i njoftojë Huamarrësit Normën Fikse të Interesit të caktuar sipas nenit 4.1(a) (Norma e interesit) të kësaj Marrëveshjeje, pa vonesë, pasi të jetë caktuar. KfW-ja do t'i njoftojë Huamarrësit normën e interesit të konsoliduar sipas nenit 4.1(b) (Konsolidimi) të kësaj Marrëveshjeje në datën e ardhshme të pagesës (siç përcaktohet në nenin 4.3 (Datat e pagesës) të kësaj Marrëveshjeje.

4.2 Llogaritja e interesit. Interesi për një shumë Huaje të disbursuar do të faturohet nga data (duke e përjashtuar) në të cilën shuma përkatëse e Huas disbursohet nga llogaria e Huas që mbahet me KfW-në për Huamarrësin deri në datën (duke përfshirë) kur shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së, të përcaktuar këtu në nenin 6.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) të kësaj Marrëveshjeje. Interesi do të llogaritet në pajtim me nenin 6.1 (Llogaritja) të kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Datat e pagesës. Interesi do të jetë i kërkueshëm në shuma të prapambetura për pagesë në datat e përcaktuara më poshtë (secila e referuar si "Datë pagese"):

a) para datës së kërkueshme të kështit të shlyerjes së parë, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më parë se në datën e pagesës pas datës kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në bazë të nenit 14.10 (Hyrja në fuqi dhe në efekt) të kësaj Marrëveshjeje;

b) në datën e kërkueshme të kështit të shlyerjes së parë sipas nenit 5.1 (Skeduli i shlyerjes) së bashku me këtë këst;

c) më pas, në datat e kërkueshme të kësteve të shlyerjes sipas nenit 5.1 (Skeduli i shlyerjes).

5. Shlyerja dhe parapagimi

5.1 Skeduli i shlyerjes. Huamarrësi do të shlyejë Huan si më poshtë:

	Data e kërkueshme	Kësti i shlyerjes
1	15.11.24	5,263,157.89
2	15.5.25	5,263,157.89
3	15.11.25	5,263,157.89
4	15.5.26	5,263,157.89
5	15.11.26	5,263,157.89
6	15.5.27	5,263,157.89
7	15.11.27	5,263,157.89

8	15.5.28	5,263,157.89
9	15.11.28	5,263,157.89
10	15.5.29	5,263,157.89
11	15.11.29	5,263,157.89
12	15.5.30	5,263,157.89
13	15.11.30	5,263,157.89
14	15.5.31	5,263,157.89
15	15.11.31	5,263,157.89
16	15.5.32	5,263,157.89
17	15.11.32	5,263,157.89
18	15.5.33	5,263,157.89
19	15.11.33	5,263,157.98

Ky skedul i shlyerjes mund të rregullohet herë pas here në përputhje me nenin 5.3 (Skeduli i rishikuar i pagesës).

5.2 Parapagimi. Sa më poshtë do të zbatohen për parapagimet:

a) E drejta për parapagim. Huamarrësi, në pajtim me paragrafët e mëposhtëm 5.2(b) (Njoftimi) deri te 5.2(e) (Kompensimi) ka të drejtë të shlyejë shuma Huaje para datës së kërkueshme të planifikuar, nëse ky parapagim është të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje në pajtim me nenin 5.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Njoftimi. Një parapagim i një shume Huaje në pajtim me nenin 5.2(a) (E drejta për parapagim) i nënshtrohet një njoftimi parapagimi nga Huamarrësi drejtuar KfW-së, jo më vonë se dita e pesëmbëdhjetë e punës (siç përcaktohet në nenin 14.1 (Dita e punës) të kësaj Marrëveshjeje) para datës së synuar të parapagimit. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të caktojë datën dhe shumën e parapagimit dhe detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e deklaruar.

c) Tarifa e parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë Huaje me normë fikse interesi, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesë, shumën që është e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja si rezultat i këtij parapagimi ("Kompensimi i parapagimit"). KfW- ja do të përcaktojë shumën e Kompensimit të Parapagimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një të dhënë të shumës së tarifës së parapagimit, para njoftimit të kërkuar të parevokueshëm për shlyerjen në bazë të nenit 5.2(b) (Njoftimi).

d) Shumat e kërkueshme. Së bashku me parapagimin, në pajtim me nenin 5.2(a) (E drejta për parapagim), Huamarrësi do të paguajë shumat e mëposhtme:

i. çdo kompensim parapagimi të kërkueshëm si rezultat i parapagimit në pajtim me nenin 5.2(c) (Kompensimi i parapagimit); dhe

ii. të gjithë interesin e mbledhur mbi shumën e parapaguar të Huas dhe çdo pagesë tjetër ende të papaguar, sipas kësaj Marrëveshjeje, që është akumuluar deri në datën e parapagimit;

e) Kompensimi. Shumat e parapaguara të Huas do të kompensohen kundrejt kështit të fundit të ripagimit, në përputhje me skedulin e ripagimit të parashikuar në nenin 5.1 të kësaj Marrëveshjeje (Skeduli i ripagimit), përveç se nëse KfW-ja në diskrecionin e saj zgjedh një tjetër alternativë kompensimi në raste individuale.

5.3 Skeduli i rishikuar i shlyerjes. Në rastin kur zbatohet neni 5.2 (Parapagimi) i kësaj Marrëveshjeje, KfW-ja do t'i dërgojë Huamarrësit një skedul të rishikuar shlyerjeje që do të bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe do të zëvendësojë grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

6. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

6.1 Llogaritja. Interesi, tarifa e angazhimit, kamatëvonesa, në pajtim me nenin 6.5 (Kamatëvonesa), kompensimi i plotë për shumat e prapambetura në pajtim me nenin 6.6 (Kompensimi me shumë të plotë), kompensimi i mospranimit dhe kompensimi i parapagimit do të llogariten mbi bazën e një viti me 360 ditë, me muaj me tridhjetë ditë.

6.2 Data e kërkueshme. Nëse një pagesë që duhet të kryhet në lidhje me këtë Marrëveshje bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është ditë pune, Huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në ditën pasuese të punës. Nëse dita pasuese e punës bie në muajin e ardhshëm kalendarik, kjo pagesë duhet të kryhet në ditën e fundit të punës të muajit kalendarik aktual.

6.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit.

Huamarrësi do të çlirohet nga detyrimet e tij të pagesës, në lidhje me këtë Marrëveshje, nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse do t'i jenë kredituar KfW-së në disponim të saj të lirë pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00 paradite në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në Frankfurt

am Main, Republika e Gjermanisë, numër IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01, që përcakton datën e kërkueshme si referencë shtesë (Ref. VVVVMMDD)

6.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa, sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse këto të drejta nuk njihen nga një vendim deklarues ose nuk miratohen nga KfW-ja.

6.5 Kamatëvonesa.

Nëse ndonjë këst shlyerjeje ose parapagim në pajtim me nenin 5.2 (Parapagimi) nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të caktojë kamatëvonesë në normën prej 200 pikësh bazë mbi normën fikse të interesit në vit të përcaktuar në nenin 4.1 (Interesi) për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën kur këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 6.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit). Kjo kamatëvonesë duhet të paguhet menjëherë me kërkesën fillestare të KfW-së.

6.6 Kompensimi me shumë të plotë. Për shumat e prapambetura (me përjashtim të këmbimeve të shlyerjeve dhe të parapagimeve të përmendura në nenin 6.5 (Kamatëvonesa) të kësaj Marrëveshjeje), KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim në shumë të plotë nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës me një normë prej 200 pikësh bazë në vit mbi normën fikse të interesit në bazë të nenit 4.1 (Interesi) të kësaj Marrëveshjeje. Kompensimi në shumë të plotë duhet të paguhet menjëherë pas kërkesës fillestare të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të provojë që nuk është shkaktuar asnjë dëm ose që dëmet kanë qenë në shuma më të vogla se sa kompensimi në shumë të plotë.

6.7 Kompensimi. KfW-ja ka të drejtë të kompensojë pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera të Huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

6.8 Llogaritë e bëra nga KfW-ja. Në mungesë të gabimeve të dukshme, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja të shumave të kërkueshme, në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, përbëjnë të dhëna provuese *prima facie (Anscheinsbeweis).*

7. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të marrë garanci nga Republika Federale e Gjermanisë për pretendimet e pagesave, sipas kësaj Marrëveshjeje para disbursimit të parë.

8. Paligjshmëria

Nëse, në ndonjë juridiksion të zbatueshëm, përmbushja e detyrimeve të KfW-së, siç parashikon Marrëveshja ose financimi ose mbajtja e Huas, bëhen të paligjshme, pas njoftimit të Huamarrësit,

i. angazhimi i KfW-së anulohet menjëherë; dhe

ii. Huamarrësi do të shlyejë të gjithë shumën e Huas në datën e specifikuar nga KfW-ja në njoftimin që i është dërguar Huamarrësit (jo para datës së fundit të ndonjë periudhe mospagimi të zbatueshme që lejon ligji).

Për shmangien e dyshimit, çdo anulim i kësaj Marrëveshjeje do t'i nënshtrohet nenit 2.6 (Tarifa e Mosshfrytëzimit) dhe çdo shlyerje e Huas, sipas kësaj Marrëveshjeje, përbën një paradhënie dhe do t'u nënshtrohet dispozitave të përcaktuara në nenin 5.2(c) (Tarifa e Parapagimit) dhe (d) (Shumat e kërkueshme).

9. Kostot dhe detyrimet publike

9.1 Ndalimi i zbritjeve ose i mbajtjeve. Huamarrësi kryen të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa asnjë zbritje për taksat, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rast se Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për arsye të tjera që të kryejë zbritje ose ndalesa të tilla mbi pagesat, pagesat e kryera nga Huamarrësi do të rriten në atë shumë që është e nevojshme për KfW-në, në mënyrë që të marrë të plota shumat e kërkueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje pas zbritjes së taksave dhe detyrimeve.

9.2 Kostot. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha shpenzimet dhe kostot, që shkaktohen në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e Huas, veçanërisht kostot e remitancave dhe të transferimit (duke përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mbajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me këtë Marrëveshje, si dhe të drejtave që lindin prej saj.

9.3 Taksat dhe tarifat e tjera. Huamarrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike, që shkaktohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, mbi lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW-ja parapaguan këto taksa ose detyrime, Huamarrësi do t'i transferojë ato pa

vonesë, me kërkesë, në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 6.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) të kësaj Marrëveshjeje ose në llogari tjetër, siç specifikohet nga KfW-ja.

10. Detyrime të veçanta

10.1 Zbatimi i Programit dhe informacioni i veçantë. Huamarrësi, për këtë qëllim i përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Programin, në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe teknike, standardet mjedisore dhe sociale dhe, kryesisht, në pajtim me konceptin e Programit të rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe KfW-së;

b) do të vërë në dispozicion, sa më shpejt që të jetë e nevojshme dhe me terma dhe kushte të pranueshme për KfW-në, fondet, lehtësitë, shërbimet, siç kërkohet, përveç të ardhurave të Huas, për kryerjen e Programit dhe për funksionimin dhe mirëmbajtjen e objekteve/shërbimeve të Programit;

c) do të garantojë që veprimtaritë e departamenteve dhe agjencive të tij, në lidhje me zbatimin e Programit të kryhen dhe të koordinohen në përputhje me politikat dhe procedurat e mira administrative;

d) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të garantojë mbajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë qartë zbatimin dhe progresin e Programit;

e) do t'i japë mundësinë, në çdo kohë, KfW-së dhe agjentëve të saj që të inspektojnë ata libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të lidhur me zbatimin e Programit;

f) do t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhënat mbi Programin dhe ecurinë e tij të mëtejshme që KfW-ja mund të kërkojë;

g) do të njoftojë menjëherë KfW-në për çdo rast, siç përcaktohet në nenin 11.1(h), pasi të vihet në dijeni për ndodhjen e rastit;

h) do të njoftojë menjëherë dhe me iniciativën e vet, KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin ose qëllimin e Programit;

i) me vullnetin e vet dhe pa vonesë të panevojshme do të informojë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht arritjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje; dhe

j) do t'i japë KfW-së në të njëjtën kohë të gjitha informacionet në lidhje me Programin, në të njëjtën kohë kur informacioni i tillë i është dhënë AFD-së, dhe do t'i japë KfW-së ndonjë dhe të gjitha informacionet dhe të dhënat e tilla shtesë mbi Programin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, siç mund të kërkojë KfW-ja.

10.2 Detaje të Zbatimit të Programit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë, në lidhje me nenin 10.1 (Zbatimi i Programit dhe informacion i posaçëm) të tij me anë të Marrëveshjes së Veçantë, e cila do të firmoset si e pranuar nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

10.3 Sipërmarrja e Përputhshmërisë. Huamarrësi ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në shtojcën 2 (Zotimet e përputhshmërisë).

10.4 Monitorimi i Programit. Huamarrësi dhe KfW-ja herë pas here, me kërkesë të secilës palë, do të konsultohen dhe shkëmbejnë mendime mbi zhvillimin e Programit dhe progresin e arritur, në lidhje me zbatimin e reformave të sektorit. Para çdo konsultimi dhe shkëmbimi të mendimeve të tilla, Njësia e Zbatimit të Programit do t'i japë KfW-së për shqyrtim dhe komente një raport mbi ecurinë e arritur në zbatimin e Programit, në detaje të tilla siç mund të kërkojë KfW-ja në mënyrë të arsyeshme.

10.5 Renditja *pari passu*. Huamarrësi garanton dhe përfaqëson se detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen dhe do të përdoren minimalisht *pari passu* me të gjitha borxhet e tjera të jashtme të pasiguruara dhe jo të varura dhe Huamarrësi do të garantojë në masën e lejuar me ligj, që ky klasifikim të garantohet edhe për të gjitha borxhet e jashtme të ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura. Në këtë Marrëveshje, "Borxh i jashtëm" nënkupton një detyrim të Huamarrësit, i cili:

i. drejtohet nga një sistem ligjesh që nuk janë ato të Huamarrësit; ose

ii. është i pagueshëm në një monedhë që nuk është ajo e vendit të Huamarrësit; ose

iii. është i pagueshëm ndaj një personi të regjistruar, me vendqëndrim, rezident ose me zyra qendrore ose vend kryesor biznesi jashtë vendit të Huamarrësit.

11. Përfundimi i Marrëveshjes

11.1 Arsyet për përfundimin. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në nenin 11.2

(Pasojat ligjore të ndodhjes së një arsyeje për ndërprerjen), nëse lind një rrethan,ë që përbën shkak të rëndësishëm *(Wichtiger Grund)*. Këto përfshijnë, në veçanti, rrethanat e mëposhtme:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet e pagesës ndaj KfW-së kur bëhen të kërkueshme;

b) janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes të Veçantë, si dhe ndonjë marrëveshjeje tjetër ligjërisht detyruese ndaj kësaj Marrëveshjeje;

c) kjo Marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues ndaj Huamarrësit ose nuk mund të jetë më e zbatueshme ndaj Huamarrësit;

d) ndonjë deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim ose garanci e konsideruar nga KfW-ja, thelbësore për dhënien dhe mbajtjen e Huas, rezulton i/e rremë/e, çorientues/e ose i/e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme, që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

f) Huamarrësi nuk mund të provojë se shumat e Huas janë përdorur për qëllimin e caktuar;

g) Huamarrësi ndërpret pagesat e tij ndaj kreditorëve, nuk ka aftësi paguese ose fillon bisedimet me një ose më shumë prej kreditorëve të Huamarrësit mbi një moratorium, heqje dorë nga borxhet e papaguara, shtyrje të pagesave ose ndërprerje të shërbimit të borxhit;

11.2 Pasojat ligjore të ndodhjes së një arsyeje për zgjidhjen e Marrëveshjes. Nëse ka ndodhur një prej rasteve të përmendura në nenin 11.1 (Arsyet për përfundim), KfW-ja mund të pezullojë menjëherë disbursimet, sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 11.1(a) ose në të gjitha rastet e tjera të specifikuara në nenin 11.1 (Arsyet për përfundim), brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja që gjithsesi duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, me pasojën që detyrimet e saj, sipas kësaj Marrëveshjeje, pushojnë dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të plotë ose të pjesshme të shumës së papaguar të Huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Nenet 6.5 (Kamatvonesa) dhe 6.6 (Kompensimi me shumë të plotë) zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

11.3 Kompensimi për dëmet. Nëse kjo Marrëveshje zgjidhet pjesërisht ose tërësisht, Huamarrësi do të paguajë kompensimin e mospranimit, në përputhje me nenin 2.6 (Kompensimi i mospranimit) dhe/ose kompensimin e parapagimit, në përputhje me nenin 5.2(c) (Kompensimi i parapagimit).

12. Përfaqësimi dhe deklaratat

12.1 Përfaqësimi i Huamarrësit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë do të përfaqësojnë Huamarrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Personat e caktuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe të autorizuar me anë të modeleve të nënshkrimeve do të përfaqësojnë Huamarrësin në të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e Programit dhe të kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë nëse revokimi i saj i shprehur nga përfaqësuesi i Huamarrësit i autorizuar në atë kohë nuk është marrë nga KfW-ja.

12.2 Adresat. Deklarimet ose njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen si kopje origjinale. Të gjitha njoftimet ose deklaratat e tjera të bëra, në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në:
KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Germany

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri

12.3 Ndryshimet. Çdo shtesë ose ndryshim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk do të kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave.

13. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me programin

13.1 Publikimi i informacionit lidhur me programin nga KfW-ja. Për të qenë në përputhje me parimet e pranuara në nivel ndërkombëtar për

transparencë dhe efikasitet maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e kategorizimit dhe vlerësimit mjedisor dhe shoqëror, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa zbatohen marrëveshjet lidhur me Programin dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si "Periudha e plotë").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së (tp://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/en).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja apo palët e treta në pajtim me nenin 13.3 më poshtë (Transferimi i informacioneve lidhur me programin te palët e treta dhe publikimi i tyre) më poshtë), në lidhje me Programin dhe mënyrën se si financohet, nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të detajuar sensitiv financiar ose biznesi, në lidhje me palët e përfshira në Program ose financimin e tij, të tilla si:

a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzimet dhe raportet e brendshme të korporatës;

d) të dhënat personale të personave fizikë;

e) vlerësimin e brendshëm të KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

13.2 Transferimi i informacioneve lidhur me programin te palët e treta. KfW-ja ndan informacione të përzgjedhura mbi Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë periudhës së plotë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet me subjektet e poshtëshënuara:

a) filialet e KfW-së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;*

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarëve të tyre, në veçanti, Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarëve të saj;

e) AFD-ja.

13.3 Transferimi i informacioneve lidhur me programin te palët e treta dhe publikimi i tyre. Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën se si financohet përgjatë periudhës së plotë me subjektet e mëposhtme, që publikojnë seksionet që lidhen me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllimet e Iniciativës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare (http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen_fakten/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html);

b) Tregu dhe InvestimiGjerman(GTAI),për qëllimeteinformacionit përtregun (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/welcome.html);

c) OECD-ja, për qëllimin e raportimit të flukseve/qarkullimeve financiare, në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (http://www.oecd.org/);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval), për qëllime të vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit të përgjithshëm të zhvillimit gjerman për të garantuar transparencë dhe efikasitet (https://www.deval.org/en/);

e) AFD-ja.

13.4 Transferimi i informacioneve lidhur me programin te palët e treta (duke përfshirë publikimin e tyre). KfW-ja, gjithashtu, rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion, në lidhje me Programin dhe mënyrën se si financohet ai gjatë periudhës së plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk transferohet, i tejkalojnë interesat e KFW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Huamarrësit, në veçanti përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 13.1 (Publikimi i informacioneve lidhur me programin nga KfW-ja), i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion te palët e treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave ligjore ose

rregullatore ose për të pohuar ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

14. Dispozita të përgjithshme

14.1 Ditë pune. Nëse i referohet kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me një "Ditë pune", kjo nënkupton një ditë të ndryshme nga e shtuna ose e diela në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë janë të hapura për biznes të përgjithshëm.

14.2 Vendi i përmbushjes. Vendi i përmbushjes për të gjitha detyrimet, sipas kësaj Marrëveshjeje është Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë.

14.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose nëse ekziston një boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të saj. Palët e kësaj Marrëveshjeje do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme ligjërisht, që është sa më afër frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët do të plotësojnë çdo boshllëk në dispozita me një dispozitë ligjërisht të vlefshme që është sa më afër frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

14.4 Ndryshimet me shkrim. Ndryshimet dhe shtesat në këtë Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim. Palët mund të heqin dorë nga kjo kërkesë me shkrim vetëm me anë të formës me shkrim.

14.5 Transferimi. Huamarrësi nuk mund të delegojë ose transferojë, rëndojë me peng ose hipotekë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje Huaje.

14.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo Marrëveshje Huaje rregullohet nga ligji gjerman.

14.7 Periudha e kufizimit/parashkrimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje skadojnë pas pesë vjetësh nga fundi i vitit në të cilin ky pretendim ka lindur dhe kur KfW-ja ka marrë dijeni për rrethanat që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni të tyre pa neglizhencë flagrante.

14.8 Heqja dorë nga imuniteti. Nëse dhe në masën që Huamarrësi aktualisht ose në të ardhmen në çdo juridiksion pretendon imunitet për vete ose sendet e tij pasurore dhe në masën që një juridiksion i jep imunitet Huamarrësit dhe sendeve të tij pasurore nga padia, ekzekutimi, sekuestroja ose procesi tjetër ligjor, Huamarrësi bie dakord në mënyrë të parevokueshme që të heqë dorë nga ky imunitet ndaj padive dhe në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, në masën më të plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet, në lidhje me ekzekutimin e ndonjë vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i. "ambientet e misionit" të tashme ose të ardhme, sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar më 1961, "ambientet konsullore" të tashme ose të ardhme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar më 1963-shin ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii. një pasuri e patundshme që futet në sferën e nenit 3, paragrafët 1–3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001, "Mbi pasuritë e patundshme shtetërore";

iii. çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë tashmë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas së drejtës publike, traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara prej saj.

14.9 Mosmarrëveshjet ligjore

a) Arbitrazhi. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje do të zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, do të zbatohen sa më poshtë:

i. Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitra që do të emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të zbatueshme herë pas here.

ii. Gjykimi në arbitrazh do të kryhet në Frankfurt am Main. Gjuha e procedimit do të jetë gjuha angleze.

14.10 Hyrja në fuqi dhe efekt. Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi dhe efekt deri në datën kur KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim nga Huamarrësi që procedurat e brendshme ligjore janë përmbushur nga Huamarrësi (data e marrjes në KfW).

Nëse Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi brenda gjashtë muajve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje ose çdo afati tjetër të pranuar nga

KfW-ja, që prej asaj date dhe deri në datën e marrjes së njoftimit të lartpërmendur me shkrim, KfW-ja do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja, duke i dërguar njoftim me shkrim Huamarrësit.

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, më KfW	Tiranë, më 15 qershor 2021 Republika e Shqipërisë
_____	_____
Emri: Sarah Bongard Funksioni: Principal Portofolio Manager	Emri: Anila Denaj Funksioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë
_____	_____
Emri: Bjorn Thies Funksioni: Director KFW, Tirana	Emri: Funksioni:

SHTOJCA 1
NJOFTIMI I TËRHEQJES SË FONDEVE

[Letër me kokë e Huamarrësit]

Drejtuar: KfW
Departmenti: TMa3/TMa5
Palmengartenstraße 5-9
60325 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)

Kërkesë për disbursim nr.

Lënda: Marrëveshje e Huas nr. .... datë _____, për një shumë euro

I referohemi nenit 2 të Marrëveshjes së Huas të lartpërmendur dhe Marrëveshjes së Veçantë (siç përcaktohet këtu) dhe kërkojmë në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar të disbursojmë një Shumë të Huas prej EURO (me fjalë: .Euro) në llogarinë tonë vijuese, vlera [Data]:

Për disbursim:

Pala përfituese përfundimtare:	SWIFT Field 59 (MT 103) / Field 58 (MT202)
IBAN /Numri i llogarisë i bankës përfituese:	
Emri i bankës që mban llogarinë:	SWIFT Field 57
BIC i bankës që mban llogarinë:	
IBAN /Numri i llogarisë së bankës që mban llogarinë në bankën ndërmjetësuese	
Emri i bankës ndërmjetësuese:	SWIFT Field 56 Gjithashtu (nëse banka e përfituesit nuk është e vendosur në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe BIC i korrespondentit të bankës në atë vend)
Banka ndërmjetësuese BIC:	
Referenca:	

Me anë të kësaj konfirmojmë se janë përmbushur të gjitha kushtet për disbursim, siç përcaktohet në nenin 2, duke përfshirë, veçanërisht, kushtin e përcaktuar në nenin 2.3(h) të Marrëveshjes së Huas të lartpërmendur.

Me anë të kësaj konfirmojmë se Marrëveshja e Huas e lartpërmendur është akoma në fuqi dhe efekt, se në lidhje me Marrëveshjen e Huas nuk ekziston asnjë rast i mospagimit dhe asnjë rast i mundshëm mospagimi (secili, siç përcaktohet aty).

……..
në …..... 20@
....
Emri:
Funksioni:

SHTOJCA 2
ZOTIMET E PAJTUESHMËRISË

1. PËRKUFIZIME

"Praktikë shtrënguese" është pengimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të penguar ose dëmtuar drejtpërsëdrejti ose jo ndonjë palë ose pronën e ndonjë pale, me qëllim ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një pale.

"Praktikë e marrëveshjes së fshehtë" është një marrëveshje midis dy ose më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një pale tjetër.

"Praktikë korruptive" është premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja mbi, marrja, pranimi ose kërkesa e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të padrejtë të çdo natyre, për dikë ose nga kushdo, me qëllim që të ndikojë në veprimet e dikujt ose të shkaktojë mosveprimin e një personi;

"Praktikë mashtrimi" është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim, që, me qëllim ose nga pakujdesia, çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përftimit të një përfitimi financiar ose shmangies së një detyrimi;

"Praktikë penguese": i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. veprime, me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë, në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

"Person" çdo person fizik, juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

"Praktikë e sanksionueshme", praktikë shtrënguese, praktikë e marrëveshjes së fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (siç përkufizohen dhe këta terma këtu), që është: i. e paligjshme, sipas ligjit gjerman ose atij të zbatueshëm; dhe ii. që ka ose mund të ketë ndikim material ligjor ose në reputacion tek Marrëveshja ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së ose në zbatimin e saj.

"Sanksionet", sanksionet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare të administruara, miratuara ose zbatuara nga çdo organ sanksionues.

"Organ sanksionues" Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

"Lista e sanksioneve" çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të emëruara që janë objekt i Sanksioneve, siç miratohet nga çdo organ sanksionues.

2. DHËNIA E INFORMACIONIT

Huamarrësi, për këtë qëllim, i përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, do të:

a) sipas kërkesës së KfW-së do të vendosë menjëherë në dispozicion të saj të gjitha informacionet përkatëse me "njih klientin tënd" ose informacione të ngjashme, në lidhje me Huamarrësin;

b) paraqet menjëherë, me kërkesë të KfW-së, të gjitha informacionet dhe dokumentet lidhur me Programin të Huamarrësit dhe (nën)kontraktuesve

të tij dhe palëve të tjera të lidhura, të cilat KfW-ja i kërkon për përmbushjen e detyrimeve për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të punës me Huamarrësin që nevojitet për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me iniciativën e saj, sapo merr dijeni ose ka dyshime për çdo praktikë të sanksionueshme, pastrim parash dhe/ose financim terrorizmi, që lidhet me Programin;

d) do t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhëna mbi Programin dhe progresin e tij të mëtejshëm që KfW-ja mund të kërkojë për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) u mundëson KfW-së dhe agjentëve të tij që të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Programin që ka Huamarrësi dhe (nën)kontraktuesit e tij saj dhe palëve të lidhura dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Huamarrësit, Huamarrësi pretendon se asnjë person që vepron në emër të Huamarrësit me Programin, nuk ka kryer ose nuk kryen praktika të sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi.

Përfaqësimi dhe garancia të parashtruara në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato duhet të përsëriten në çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë pagese të interesit, në çdo rast referuar rrethanave mbizotëruese të asaj dite.

4. VEPRIMET

Huamarrësi merr përsipër, sapo ai ose KfW-ja merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë praktikë të sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi, që të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në veçanti, Huamarrësi i përgjigjet menjëherë dhe me hollësitë e pranueshme çdo njoftimi nga KfW-ja dhe dorëzon dokumentet mbështetëse për çdo përgjigje ndaj kërkesave të KfW-së.

5. MOSVEPRIMET

Huamarrësi nuk hyn në transaksione ose nuk angazhohet në veprimtari të tjera në lidhje me Programin që mund të përbëjnë shkelje të sanksioneve.

DEKRET
Nr. 13168, datë 26.7.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe të nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 93/2021, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri – faza I".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 450, datë 30.6.2021

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË PAJISJEVE SPORTIVE, QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR, SI DHE PROCEDURAT E PËRJASHTIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 7, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që jepen si ndihmë apo sponsorizohen nga institucionet ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar, të cilat përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi

mbi vlerën e shtuar, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Organizatat sportive shqiptare paraqesin në ministrinë përgjegjëse për sportin kërkesën për përjashtim nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të materialeve dhe të pajisjeve të listuara në shtojcën bashkëlidhur këtij vendimi, përpara importimit të tyre, të shoqëruara me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet organizatës sportive shqiptare dhe institucionit ndërkombëtar dhe kopjen e projektit të bashkëpunimit, nëse ka një të tillë;

b) Aktin zyrtar të institucionit ndërkombëtar për dhënien e ndihmës apo sponsorizimit për materialet dhe pajisjet sportive që përjashtohen, sipas shtojcës, për organizatën sportive shqiptare;

c) Listën e hollësishme të materialeve dhe të pajisjeve sportive, të shoqëruar me vlerën e tyre tregtare apo me faturën tregtare;

ç) Vendimin e organizatës sportive për shpërndarjen e materialeve dhe të pajisjeve sportive, sipas destinacionit e sasive përkatëse.

3. Ministria përgjegjëse për sportin vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi. Kur përmbushen parashikimet sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për sportin i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, përpara importimit të materialeve dhe të pajisjeve sportive, kërkesën për përjashtim nga detyrimet doganore e tatimi mbi vlerën e shtuar.

4. Organizatat sportive shqiptare, që kanë paraqitur kërkesën për përjashtim nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të materialeve dhe të pajisjeve sportive të listuara në shtojcën bashkëlidhur këtij vendimi, të kryejnë procedurat ligjore për tërheqjen e tyre në doganë dhe transportimin deri në mbërritjen në destinacionin final, sipas dokumentacionit të dorëzuar prej tyre, në ministrinë përgjegjëse për sportin.

5. Në rast të konstatimit të mospërdorimit të materialeve dhe të pajisjeve sportive, sipas qëllimit për të cilin janë importuar nga organizatat sportive shqiptare, ministria përgjegjëse për sportin informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

6. Vendimi nr. 306, datë 24.5.2006, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË

LISTA E MATERIALEVE DHE E PAJISJEVE SPORTIVE, QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR

I. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË ATLETIKËS

1. Pengesa për garat 110 m, 400 m dhe 3000 m
2. Disqe për hedhje
3. Gjyle për hedhje në peshat e ndryshme
4. Çekiç për hedhje në pesha të ndryshme
5. Shtiza për hedhje në pesha të ndryshme
6. Pedana kërcimesh së gjati e trehapësh
7. Shtrat kërcimi me shkop
8. Steka kërcimesh së larti dhe me shkop
9. Shkopa kërcimi me shkop
10. Mbajtëse steke për kërcimet
11. Kronometra
12. Shkopa stafete
13. Blloqe starti
14. Pistoletë starti
15. Kapsolla për pistoletë e startit
16. Dyshekë për kërcimin së larti dhe atë me shkop
17. Tapet sintetik tartan pllakë ose lëndë e parë për shtrimin e pistës së atletikës
18. Ngjitës për tapetin sintetik tartanin
19. Bojë për të bërë vizimet e pistës
20. Tuta sporti (pambuku, sintetike dhe fëshfëshe)
21. Materiale uniforma paraqitje; kanotierë, mbathje për femra dhe meshkuj, bluza, çorape, këpucë me thumba, atlete;
22. Vegla force
23. Boshte dhe rrota shtange;
24. Rripa shtange;
25. Kombinat force;
26. Pedanë force;
27. Shtrat force;
28. Fotofinish elektronik;
29. Tabela për dhënie të rezultateve;
30. Kompjuter elektronik për regjistrimin e atleteve në fotofinish;
31. Fasho llastiku;
32. Gjunjza llastiku;
33. Kaviljere llastiku;
34. Telekamerë për të regjistruar garat për efekt shkencor medodik;

35. Aparat fotografik;
36. Pistë vrapimi elektronike;
37. Biçikletë elektronike për stërvitje;
38. Step elektronik për stërvitje;
39. Kuba për të kryer ushtrime pliometrike;

II. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË ALPINIZMIT

1. Litar alpin;
2. Rrip sigurimi;
3. Çelësa sigurie;
4. Kazma alpine;
5. Kthetra;
6. Çanta shpine;
7. Shalur;
8. Çadra alpine;
9. Pajisje të murit alpin;
10. Dyshek alpin;
11. Mur alpin i montueshëm dhe i çmontueshëm me bazë punime druri dhe plastike;
12. Këpucë alpine;
13. Mushama alpine;
14. Kaska mbrojtëse për kokën;

III. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BOKSIT

1. Ring dhe aksesorët e tij (litarë, tuba metalikë, tapete, shkallë, jastëkë sfungjeri, tuba plastikë);
2. Thasë lëkure për stërvitje boksi të modele dhe përmasave të ndryshme;
3. Dardha boksi prej lëkure për stërvitje vetjake;
4. Llapeta boksi prej lëkure për stërvitje vetjake;
5. Doreza boksi të tipave të ndryshëm për ndeshje dhe stërvitje sipas standardeve për mosha të ndryshme;
6. Kokore mbrojtëse sipas standardeve për ndeshje dhe stërvitje;
7. Mbrojtëse të organeve gjenitale;
8. Gomina për mbrojtjen e dhëmbëve;
9. Komplet për palestër force të standardit tip, si dhe pajisje speciale për boksin;
10. Uniforma sportive (mbathje, kanotierë, tuta etj.);
11. Bandazhe të standardit tip për mbrojtjen e duarve;
12. Dyshekë muri për stërvitje;
13. Kompjuter për të parë pikët;

IV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BASKETBOLLIT

1. Tabela basketbolli;
2. Mbajtëse tabelash basketbolli;
3. Kosha basketbolli;
4. Tabela elektronike basketbolli;
5. Mbajtëse të 24";
6. Kronometra loje joelektronike;
7. Topa;
8. Bluza;
9. Fasha llastiku;
10. Kaviliere;
11. Kostum sportiv;
12. Mbathje;
13. Çorape;
14. Jelekë;
15. Këpucë sportive;
16. Çanta sportive;
17. Mbajtëse topash;
18. Rrjeta koshash;
19. Telekamerë për regjistrimin e ndeshjeve;
20. Pajisje të lojës 3x3 (fushë, konstruksion, aparaturë);
21. Sistem kamerash IRC;
22. Shkallë lëvizëse (4 shkallë me gjatësi 5 m).

V. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË ÇIKLIZMIT

1. Makinë tip fugon për të shoqëruar ekipin kombëtar;
2. Motoçikletë;
3. Biçikletë profesionale;
4. Pjesë këmbimi për biçikletat;
5. Uniforma sportive të ekipit kombëtar;
6. Foto finish, me të gjitha pajisjet përbërëse;
7. Veshmbathje dhe uniforma sportive (pantallonçina për çiklizëm, këpucë sportive çiklizmi, fanella verore dhe dimërore për çiklizëm, tuta sportive dhe mushama mbrojtëse nga shiu, kaska mbrojtëse për çiklizëm, doreza sportive;
8. Pajisje sportive ndihmëse, stërvitore dhe për gara (kronometër, diktofon, cilindër, kardiofrekuenciometër);
9. Aparatura dhe mjete të përgatitjes speciale fizike (pista ecjeje vrapimi, shtanga, gira, litarë dhe topa të ndryshëm);

VI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË DANCIT SPORTIV

1. Kostume latine për femra dhe meshkuj;

2. Kostume standarde për meshkuj dhe femra;
3. Kostume latine për meshkuj e femra për formacione latine standarde;
4. Këpucë standarde dhe latine për femra dhe meshkuj;
5. Aksesorë të ndryshëm, si çanta sportive, kostume trajnimi, kravata, sipas manualeve të veshjeve të njohura nga IDSF (Federata Ndërkombëtare e Dancit Sportiv);

VII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË FUTBOLLIT

1. Tapet bari natyral
2. Impiante vaditëse
3. Makineri mirëmbajtjeje të fushave me aksesorët
4. Sisteme ndriçimi të stadiumeve
5. Tabelë elektronike
6. Ndenjëse plastike për spektatorët në stadium
7. Tapet bari artificial me aksesorët për instalimin e tij
8. Makineri mirëmbajtjeje për fusha me bar artificial
9. Kostum sportiv
10. Bluza
11. Mbathje
12. Geta
13. Çorape
14. Kapele
15. Kapuç
16. Doreza
17. Jelekë
18. Këpucë sportive
19. Çanta sportive
20. Çanta për mjekët sportivë
21. Topa
22. Materiale didaktike stërvitore
23. Materiale dhe aksesorë të stadiumeve (porta, rrjeta, flamuj, pajisje vizimi etj.)
24. Shina mbrojtëse të lojtarëve dhe aksesorë ndihmës (shirita kapiteni, mbajtëse flokësh, peshqirë);
25. Televizorë dhe pajisje marrëse satelitore;
26. Kamera, pajisje transmetimi satelitor;
27. Sistem komunikimi për arbitrat;
28. Fëshfëshe shiu;
29. Xhupa;
30. Tapet sintetik për fusha dhe aksesorët për instalimin e tij;
31. Parket për fusha dhe aksesorët për instalimin e tij;

32. Makineri mirëmbajtjeje për tapet sintetik futsali;
33. Makineri mirëmbajtjeje për parket futsali
34. Sistem Audio Stadiumi;
35. Sistem akses kontrolli të stadiumeve;
36. Sistem CCTV (kamera + aksesore);
37. Sistem VAR për stadium (fugon, hardware, server, kompiuter, monitor, sistem intercom audio – mikrofon, kufje, përshtatës, kamera video, pajisje regjistrimi video dhe audio, patchpanel, kabëll me konektorë, rack, software);
38. Sistem VAR për stadium (licenca);
39. Goal line technology (mikro-kamer, fushë magnetike me bazë fibre, software).

VIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË GJIMNASTIKËS

1. Tapet gjimnastikor për gjimnastikën ritmike dhe artistike me bazament druri
2. Dyshek sfungjeri për stërvitje dhe gare
3. Paralele e shkallëzuar
4. Unaza
5. Hekur gjimnastikor
6. Tra ekuilibri
7. Kalë me doreza
8. Pedanë rrafëse
9. Pajisje gare për gjimnastikën ritmike (fjongo, topa, rrathë, birila)
10. Pjesë ndërrimi të veglave gjimnastikore
11. Tapet për vrapimin e gjimnastëve gjatë garës (rrugë vrapimi)
12. Kalë kërcimi për femra e meshkuj;
13. Rrugicë për kërcime, për garë e stërvitje;
14. Trampolinë;
15. Materiale, uniforma paraqitje, kanatjere, pantallona, kostume sintetike, meshkujsh e femrash, dhe mbathje (kostume gare);
16. Aparatura elektronike për vlerësimin e garave;
17. Aksesorë ndihmës për kalë me doreza;
18. Aksesorë ndihmës për kalë kërcimi për femra e meshkuj;
19. Aksesorë ndihmës për pedanë rrahëse;
20. Shpinore;
21. Rrip mesi;

IX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË HENDBOLLIT

1. Topa
2. Shënues pikësh-gjyqtarie
3. Rrjeta
4. Porta

5. Veshje dhe uniforma sportive-tuta komplet
6. Këpucë
7. Orë elektronike
8. Kronometër, bilbila, pompa
9. Kartonë me ngjyrë për gjyqtarinë
10. Çanta sportive;
11. Shtresa plastike tartani ose ger-flowr etj., për shtrim fushe;
12. Matëse presioni për topat;
13. Çanta për mbajtjen e topave;
14. Jelekë;
15. Mbajtëse topash;
16. Rrjeta për beach-hendbollin;
17. Rrjeta për mbrojtjen e shikuesve qe vendosen mbrapa portave;
18. Sistem komunikimi për arbitrat;
19. Mbrojtëse të organeve gjenitale;
20. Gomina për mbrojtjen e dhëmbëve;
21. Fasha llastiku;
22. Kavilier;
23. Aparatura dhe mjete të përgatitjes speciale fizike (pista ecjeje vrapimi, shtanga, gira, litarë dhe topa të ndryshëm);
24. Bojë për të bërë vizimet e fushave;
25. Ngjitës për tapetin sintetik tartanin.

X. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË KARATESË

1. Tatami (tapet);
2. Tabela elektronike (matës për mbajtjen e kohës së ndeshjeve, pushimet, pikët etj.);
3. Kimono (uniforma e plotë e garës-xhaketë, pantallona dhe rrip);
4. Doreza për ndeshje;
5. Dhëmbëza (mbrojtëse për dhëmbët);
6. Peshore elektronike;
7. Tuta komplet (bluzë dhe pantallona);
8. Këpucë sportive;
9. Çanta sportive;
10. Kronometra për stërvitje;
11. Thasë lëkure për stërvitje;
12. Llapeta prej lëkure për stërvitje vetjake.
13. Komplet për palestër force të standardit tip (vegla force, boshte dhe rrota shtange, kombinat force, shtrate force, gira etj);
14. Kukulla për stërvitje;

15. Telekamera për regjistrimin e ndeshjeve;
16. Televizorë/ekrane (për shfaqjen e pikëve gjatë garave);
17. Pajisje speciale për artet marciale (vegla për shtimin e fleksibilitetit, pesha qe vendosen te duart apo këmbët, etj.);

XI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SPORTEVE ME KUAJ

1. Pengesa për garën me pengesa;
2. Mjete transporti rimorkio për transportimin e kuajve;
3. Ushqime të ndryshme për kuaj;
4. Shala, mbulesa, frerë, kapistra dhe aksesorë të ndryshëm për mbathjen e kuajve;
5. Vegla të ndryshme për mbathjen e kuajve, patkonj, graso, krehër, brusha etj;
6. Komplete sportive për kalorësit pjesëmarrës në garë (çizme, kapele, kostum, dorashka, kamxhikë etj.);
7. Kuaj sportivë të racave të ndryshme;

XII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË MUNDJES

1. Tapete mundjeje prej sfungjeri;
2. Orë (shënues pikësh) elektronike;
3. Peshore elektronike;
4. Veshje sportive (kostume mundjeje dhe këpucë sportive mundjeje);
5. Vegla force;
6. Tabela elektronike për mbajtjen e kohës së ndeshjeve;
7. Çanta sportive;
8. Kronometra për stërvitje;
9. Kukulla bullgare;
10. Tapet mundje komplet;
11. Vegla force për stërvitje (kompleks).

XIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË NOTIT

1. Aparatura elektronike për matjen e kohës së garave dhe aksesorët e tyre;
2. Linjat ndarëse të korsive të pishinës dhe aksesorët e saj;
3. Pajisje sportive ndihmëse për stërvitjen e notarëve;
4. Kronometra;
5. Uniforma sportive (uniforma prezantimi, uniforma për garë);

XIV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË QITJES

1. Pushkë sportive – kalibri 5.6 mm;
2. Pushkë sportive me ajër- kalibri 4.5 mm;
3. Pistoleta sportive – kalibri 5.6 mm;
4. Pistoleta sportive me ajër – kalibri 4.5 mm;

5. Fishekë sportivë - kalibri 5.6 mm;
6. Saçme sportive – kalibri 4.5 mm;
7. Veshje speciale (xhupa, pantallona e këpucë);
8. Aksesorë dhe pjesë ndërrimi të armëve;
9. Mjete optike (stereogypa) për shkimin e goditjeve;
10. Aparate elektrike për ndërrimin e shenjave të qitjes;
11. Shenja qitjeje prej letre;
12. Pajisje për hedhjen e pjatelave në qitjen me pjatel;
13. Veshje speciale për qitjen me pjatel (jelekë, doreza, këpucë, kapele, pantallona, çanta);
14. Fishekë për qitjen me pjatel;
15. Pjatela për qitjen me pjatel

XV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË PESHËNGRITJES

1. Kompjuter për pasqyrimin e rezultateve teknike të garave;
2. Tabela elektronike për shfaqjen e rezultateve teknike të garës;
3. Boshtet klasike të peshëngritjes;
4. Disqe klasike të peshëngritjes me madhësi 50, 25, 20, 15, 10, 5, 2.2, 1 dhe 0.5 kg;
5. Pedana (stërvitore dhe të garës);
6. Pajisje të ndryshme sportive për sallat stërvitore (shkallë suedeze, kaluç, kutia, mbajtëse të disqeve të shtangës, litarë të ndryshëm kërcimi);
7. Veshje të ndryshme sportive (kostum sportiv, bluzë dhe pajisje të peshëngritësit, si rrip mesi, bandazhe të ndryshme për kyçet e duarve dhe te gjunjët, këpucë);

XVI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË PINGPONGUT

1. Tavolina pingpongu;
2. Raketa;
3. Topa;
4. Shënues pikësh gjyqtarie;
5. Rrjeta;
6. Parapeta;
7. Faqe raketash;
8. Uniforma sportive – tuta komplet;
9. Këpucë pingpongu;
10. Veshje- bluzë, të mbathura;
11. Tavolinë gjyqtarie;
12. Ngjitëse faqesh rakete;
13. Kronometër;
14. Kartonë me ngjyra për gjyqtarët;

XVII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË RADIOAMATORIZMIT

1. Radiostacione 100 W;
2. Ushqyes;
3. Grup antenash;

XVIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË VOLEJBOLLIT

1. Pajisje volejbolli (shtylla, rrjeta, antena);
2. Topa volejbolli dhe beach-volley;
3. Uniforma sportive-komplete (çanta sportive, tuta sportive këpucë sportive, mbathje, gjunjëza);
4. Shtylla volejbolli dhe beach-volley, së bashku me mbrojtëset e tyre;
5. Kullë për gjyqtarët;
6. Rrjeta volejbolli dhe beach-volley, së bashku me antena;
7. Shtresë plastike me tartan ose me ger-flowr për fushën e volejbollit;
8. Flamur për gjyqtarët anësorë;
9. Bilbila për gjyqtarët;
10. Matëse presioni për topat;
11. Tabela me numra nga 1-22, për ndërrimin e lojtarëve;
12. Mbajtëse topash (kosha me rrota);
13. Çanta për mbajtjen e topave;
14. Uniforma sportive për gjyqtarët (Bluza, pantallona, atlete, çanta);
15. Uniforma sportive për lojtarët (bluza, mbathje, tuta sportivë, xhupa sportivë, gjunjëza, këpucë, atlete, çanta sportive);
16. Tabelë elektronike për mbajtjen e pikëve gjatë garave;
17. Sinjalizues për pushimet;
18. Numërator tryeze për mbajtjen e pikëve;
19. Topa snow –volley;
20. Pompa për fryrjen e topave të volejbollit, beach-volley e snow-volley;
21. Manometër elektronik për matjen e presionit te topave;
22. Kronometër për matje kohe;
23. Kartonët profesional të përdorur nga gjyqtarët e volejbollit;
24. Bilbil profesional i përdorur nga gjyqtarët e volejbollit;
25. Matës për lartësinë e rrjetës së volejbollit, beach-volley dhe snow-volley;
26. Tapete profesional për volejbollin;
27. Tapete për minivolley dhe street-volley;
28. Sisteme shtyllash profesionale;
29. Rrjetë profesionale volejbolli, beach-volley e snow-volley;
30. Antena profesionale volejbolli, beach-volley e snow-volley;
31. Shirita profesionalë për vizimin e fushave të beach-volley dhe snow-volley;
32. Pajisje për komunikimin e gjyqtarëve gjatë ndeshjes;

33. Pajisje e cila lidhet me protokollin elektronik "Litescore";
34. Pajisje për "Livestream" të ndeshjeve;
35. Uniforma komplete për ekipet kombëtare të të gjithë moshave.

XIX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SKIVE

1. Komplet skish;
2. Porta;
3. Veshje sportive skish;
4. Lift-stërvitor skish;
5. Makinë për prodhim bore "Snougan" (topa bore);
6. Makinë për shtypjen e borës dhe përgatitjen e pistës (Batipista);
7. Motor bore transporti dhe emergjence, "Snouxhet";
8. Pajisje mekanike e rregullimit, kontrollit dhe kolaudimit të skive;
9. Tapet bari plastik për rrëshqitje në kushte verore;

XX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË TAEKWONDOS

1. TATAM-tapet për ndeshje me përmasa 12x12;
2. Matës elektronik pikëzimi;
3. DOBOKE-xhaketë, pantallona dhe rrip;
4. Mjete ndihmëse (stërvitore), si pistë vrapimi, thasë dhe llapeta;
5. Komplete për ndeshje (mbrojtëse trupi, mbrojtëse koke-kokore, mbrojtëse gjenitale për meshkuj dhe femra, mbrojtëse e parakrahëve, mbrojtëse kërciri);

XXI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË XHUDOS

1. Tatam (tapet);
2. Tabelë elektronike (matës për mbajtjen e kohës së ndeshjeve, pushimeve, pikët etj.);
3. Kimono (veshje për ndeshje-xhaketa, pantallona, rrip);
4. Peshore elektronike;
5. Tuta komplet (bluzë dhe pantallona);
6. Këpucë sportive;
7. Çanta sportive;
8. Kronometra për stërvitje;

XXII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË TENISIT

1. Raketa për të rritur;
2. Raketa, për fëmijë, të madhësive të ndryshme;
3. Topa të gjelbër për stërvitje;
4. Topa të gjelbër për gara;

5. Topa të butë për stërvitje;
6. Topa me kërcim mesatar për stërvitje;
7. Fije për lidhjen e raketave;
8. Makina për lidhjen e raketave;
9. Minirrjetë tenisi;
10. Shirita për lidhjen e bishtit të raketës;
11. Çanta tenisi;
12. Veshje sportive (tuta, bluza, t-shirte, mbathje, kapele, shirita koke, atlete, etj);
13. Pajisje elektronike dhe ekrane Led për rezultatet dhe regjistrim dhe ritransmetim e pamjeve të rënies së topit në fushë apo jashtë saj;
14. Pajisje elektronike për të gjithë parametrat e lëvizjes së topit (shpejtësi, forcë etj.);
15. Acrilic resurfacer;
16. Court patch Binder;
17. Plexicushion base coat;
18. Plexicushion;
19. Fortified pave (të gjitha ngjyrat);
20. Line Paint Hi-Hide WHITE (Acrilic i bardhë për vijat e fushës);
21. Silica-sand 84 (rërë silici);
22. Amortizatorë raketash tenisi;
23. Fasheta kyçesh (për duar dhe këmbë) (shirita).

XXIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SHAHUT

1. Pajisje elektronike të fushës së shahut;
2. Kompjuter për mësimin e shahut;
3. Tabela elektronike demonstrative;
4. Ora elektronike tryeze, specifike për shahun;
5. Ora elektronike muri për shahun;
6. Fusha dhe gurë shahu (komplete);
7. Tabela demonstrative muri, të thjeshta.
8. Stema, emblema etj;
9. Mbajtëse çelësash;
10. Veshje zyrtare për ekipet përfaqësuese (Kostume etj);
11. Këmisha.

XXIV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BOWLING

1. Pjesë këmbimi mekanike, elektrike e elektronike;
2. Solucione për pastrimin dhe mirëmbajtjen e pistave të bowling-ut;
3. Topa bowling-u;
4. Këpucë për sportistët (që përdoren gjatë linjës);
5. Birila për lojën e bowlingut;

XXV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BILARDOS

1. Tryeza bilardoje (të tipave dhe të përmasave të ndryshme, Pool Snooker, Carom, Birila);
2. Steka të tipave të ndryshme;
3. Aksesorë për tryezat e bilardos (llambadarë, gurë, bilardo, copë për veshje tryezash bilardoje, mbajtëse stekash, sahatë elektronikë, sahatë mbajtës të gurëve, gropa, xhepa, trekëndësha, stanok, kupa etj.

XXVI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BODYBILDING

1. Boshte shtange dhe pesha të ndryshme;
2. Gira;
3. Makineri (biçikleta statike, makina vrapimi, makina të ndryshme për stërvitjen e grupmuskujve).

XXVII. KOMITETI OLIMPIK SHQIPTAR

1. Materiale promocionale për ekipin olimpik shqiptar; (Stema, emblema, mbajtëse çelësash, veshje sportive (bluzë tute, tuta, kapele, këpucë sportive), manuale;
2. Veshje përfaqësimi zyrtar (kostume për femra dhe meshkuj, këmisha, këpucë);
3. Aksesorë të ndryshëm për delegacionet sportive zyrtare (flamuj, postera, videofilma, mbajtëse të flakës olimpike, pishtar).

XXVIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË GOLFIT

1. Çanta golfi;
2. Shkopinj golfi për të gjitha moshat;
3. Topa golfi;
4. Fanella golfi;
5. Pantallona golfi;
6. Xhaketa golfi;
7. Këpucë golfi për të gjitha moshat;
8. Simulator golfi;
9. Sete golfi komplet (çantë, shkopinj, topa, peshqirë, kapele, doreza golfi);
10. Pajisje për mirëmbajtje fushe golfi;

XXIX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË RAFTING

1. Gomone;
2. Kanoe;
3. Kayak;
4. Kataraft;
5. Lopata;

6. Skafandra;
7. Veshje *rafting*;
8. Xhup uji;
9. Çorape;
10. Këpucë *rafting*;
11. Kostum sportiv;
12. Bluzë sportive;
13. Xhup sportiv;
14. Kapele;
15. Atlete;
16. Çanta sportive;
17. Aksesorë (litar, bilbil);
18. Prozhektor;
19. Kamerë filmimi antiujë;
20. Aparat fotografik antiujë;

XXX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË AERONAUTIKËS

1. Parashuta;
2. Instrumente variometër;
3. Instrumente gps;
4. Sedilje parashutë;
5. Parashuta rezervë;
6. Veshje pilotësh;
7. Kaska;
8. Avionë të vegjël *ultralight*;
9. Parashuta për ngritje nga toka me tërheqje;
10. Pajisje *vericel* për ngritje velash nga toka;
11. Pajisje aeromodelizmi fluturuese;
12. Paramotorë;
13. Elika paramotorësh;

XXXI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË LUNDRIMIT ME VELA

1. Barka dhe mjete lundrimi me vela;
2. Barka dhe mjete lundrimi me motor;
3. Barka dhe mjete lundrimi me rrema;
4. Kanoe;
5. Kayak;
6. Pajisje për transportimin e barkave në tokë dhe në plazh (karele);
7. Pajisje të bregëzimit të mjeteve dhe barkave;
8. Pajisje të ndriçimit në bord, breg, ujë dhe nën ujë;

9. Veshje sportive;

XXXII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SPORTIT PËR TË GJITHË

1. Veshje sportive
2. Shirita kufizues;
3. Materiale dekorative (fjongo, topa, tullumbace);

XXXIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BADMINTONIT

1. Raketa badmintoni;
2. Tapete fushe badmintoni;
3. Shuttle (fluturashka), plastike dhe pende;
4. Uniforma sportive bluza, mbathje;
5. Komplete kostumi sportiv;
6. Makinë për thurjen e raketës, elektronike;
7. Makinë për thurjen e raketës, manuale;
8. Tabela pikëzimi elektronike;
9. Tabela pikëzimi manuale;
10. Stativ mbajtjeje rrjete;
11. Rrjeta.

XXXIV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SNOOKER-IT

1. Tryeza snookeri (të tipave dhe të përmasave të ndryshme);
2. Steka të tipave të ndryshme;
3. Aksesorë për tryezat e snookerit (llambadarë, gurë, copë për veshje tryezash snookeri, mbajtëse stekash, sahat elektronik, sahat mbajtës të gurëve, gropa, xhepa, trekëndësha, stanok etj.

XXXV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SPORTIT SHKOLLOR

1. Topa për disiplina të ndryshme sportive stërvitore;
2. Vegla force për palestra shkolle;
3. Dyshek sfungjeri gjimnastike për stërvitje ne shkolle;
4. Tatami (tapet) për mundje dhe disiplinën judo;
5. Kanoe, Lopata për kanoe;
6. Komplet, veshje sportive për ski për moshën 3-18 vjeç;
7. Tapet bari plastik për rrëshqitje me ski në kushte verore për kurse fëmijë, nxënës;
8. Çadra alpine për ekskursione me nxënësit e shkollave;
9. Tabela basketbolli; Mbajtëse tabelash basketbolli; Kosha basketbolli për shkollat
10. Bluza sportive dhe kapele;
11. Tavolina pingpongu, raketa, topa pingpongu;

12. Shirita kufizues;
13. Materiale dekorative (fjongo, topa, tullumbace);
14. Litar kërcimi;
15. Topa Profesional Futbolli;
16. Topa Profesional Volejbolli;
17. Topa Profesional Handbolli;
18. Topa Profesional Basketbolli;
19. Çanta Sportive;
20. Bilbil profesional;
21. Jelek sportiv;
22. Mbajtëse topash;
23. Cadra alpine për ekskursione për nxënësit e shkollave;
24. Komplete skish;
25. Kalë kërcimi;
26. Pedanë;
27. Shpinore;
28. Kronometra;
29. Megafon;
30. Peshore;
31. Kostume për judo / mosha 5-18 vjeç;

XXXVI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SPORTIT UNIVERSITAR

1. Veshje sportive/ T-Shirt;
2. Tuta Sportive(mbathje);
3. Kostume Sportive (bluze + tuta);
4. Xhupa Sportiv;
5. Shirita kufizues;
6. Topa Profesional Futbolli;
7. Topa Profesional Volejbolli;
8. Topa Profesional Hendbolli;
9. Topa Profesional Basketbolli;
10. Çanta Sportive;
11. Materiale dekorative (fjongo);
12. Materiale dekorative (topa);
13. Materiale dekorative (tullumbace);

XXXVII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË VROJTUESVE TË PLAZHIT DHE SHPËTIMIT NË UJË

1. Kamerdare rreth shpëtimit në ujë;

2. Baywatch;
3. Defibrilator;
4. Manikin për përdorim mësimor;
5. Barelë pluskuese shpëtimi;
6. Tavolinë sërfi shpëtimi;
7. Dylbi;
8. Megafon;
9. Jelek shpëtimi;
10. Litar/Cimë;
11. Rul statik;
12. Uniformë Vrojtuesi Plazhi (bluzë, pantallona, xhup sportiv, kapele);
13. Mjet lundrimi me motor (motor boat);
14. Mjet lundrimi pa motor (boat).

XXXVIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË ZHYTJES

1. Kompresor për zhytje nënujore;
2. Bombola për zhytje nënujore;
3. Pajisje për zhytje nënujore;
4. Kostume termike për zhytje të thatë dhe të njomë;
5. Xhupa për zhytje nënujore;
6. Rregullator i mishelës së ajrit për zhytje;
7. Gomone motorike;
8. Maskë oksigjeni për zhytje.

XXXIX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË TEQBALL

1. Tavolinë Teq One;
2. Tavolinë Teq Smart;
3. Tavolinë Teq Lite;
4. Tapet gome / plastike;
5. Shkallë ulëse portative për evente (maksimumi 100 persona);
6. Barriera kufizuese 2.3 x 1.1 m për veprimtari.

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 279, datë 14.7.2021

PËR RREGULLAT DHE MËNYRAT E ZBATIMIT TË SANKSIONEVE ADMINISTRATIVE PËR MJETET LUNDRUESE TURISTIKE DHE TË ARGËTIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr. 127/2020, "Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit", ministri i Brendshëm dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZOJNË:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton procedurat, rregullat dhe mënyrën e zbatimit të sanksioneve administrative në rastet kur konstatohen shkelje me mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit.

2. Ky udhëzim zbatohet për lëvizjen e të gjitha mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit në hapësirën detare shqiptare dhe ujërat e brendshme tokësore.

3. Ky udhëzim nuk zbatohet për mjetet lundruese në përdorim të Forcave të Armatosura, të kapitenarisë së porteve, të forcave të policisë, të doganave dhe të organeve të tjera të parashikuara me ligj.

KREU II
KONTROLLI I AKTIVITETIT TË MJETEVE LUNDRUESE

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit kur konstaton mjete lundruese, objekt të ligjit nr. 127/2020, "Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit", (në vijim ligji), që lëvizin në dete, liqene, rezervuarë dhe lumenj ose kur transportohen në rrugë automobilistike, ushtron kontroll të dokumentacionit vetëm në rastet e mëposhtme:

a) ka indicie/informacion të arsyeshëm mbi subjektin;

b) konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit ujor.

2. Nëse mjetet lundruese nuk janë të regjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detare (ZRMLD), sipas detyrimeve të parashikuara në nenin 5 të ligjit, punonjësit e policisë bëjnë bllokimin e mjetit lundrues dhe informojnë shërbimet e Policisë Kufitare dhe Migracionit, përgjegjëse për territorin. Policia Kufitare dhe Migracionit, pas verifikimit të shkeljes së konstatuar, në bashkëpunim me zyrat vendore të kapitenarisë, kryejnë procedurat e mëtejshme për marrjen e masave administrative.

3. Subjekti që importon një mjet lundrues depoziton pranë ZMRLD-së një kopje të deklaratës së importit të konfirmuar nga autoritetet e Policisë Kufitare, e cila me kërkesën e pronarit ose bashkëpronarit bën regjistrimin e mjetit lundrues.

4. Në rast se gjatë inspektimeve Drejtoria e Përgjithshme Detare konstaton mjete lundruese që nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara në ligj, njofton shërbimet e Policisë Kufitare dhe Migracionit për marrjen e masave administrative.

5. Në rastet kur gjatë kontrollit të mjetit lundrues konstatohet se drejtuesit, pronarët apo bashkëpronarët e mjetit lundrues janë në shkelje të detyrimeve të parashikuara në nenin 13, të ligjit, përveç masave administrative për shkeljen e konstatuar, mjeti lundrues shoqërohet në stacionin e Policisë Kufitare, përgjegjëse për territorin, si dhe materialet përkatëse i përcillen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor.

KREU III
PROCEDURA E KONSTATIMIT DHE VEPRIMIT PËR KUNDËRVAJTJET

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, për shkeljet e konstatuara nga drejtuesit e mjeteve lundruese, vepron sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në nenin 14 të ligjit.

2. Punonjësi i policisë përpilon procesverbalin e konstatimit të shkeljes, sipas modelit nr. 1 bashkëlidhur, procesverbal i cili mbahet në dy kopje, një kopje për kundërvajtësin dhe një kopje dorëzohet në stacionin e Policisë Kufitare.

3. Shefi i stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, referuar shkeljes së konstatuar, në bazë të procesverbalit model nr. 1, merr vendim për:

3.1 Masën e dënimit me gjobë të kundërvajtësit;

3.2 Kohëzgjatjen e bllokimit administrativ apo zhbllokimit të mjetit lundrues;

3.3 Heqjen e dëshmisë së aftësisë për drejtimin e mjetit lundrues, sipas shkronjës "j", të nenit 14, të ligjit nr. 127/2020;

3.4 Mbyllje të subjekteve të certifikuara për ndërtimin, riparimin, rikonstruktimin e mjeteve lundruese.

4. Në zbatim të nenit 14 të ligjit, punonjësi i policisë mban dhe plotëson procesverbalin tip, sipas lidhjeve pjesë përbërëse e këtij udhëzimi për:

4.1 Konstatimin e shkeljes administrative nga kundërvajtësi apo nga subjektet, sipas pikës 3.4 të këtij udhëzimi;

4.2 Dorëzimin e mjetit lundrues në pikën e bllokimit;

4.3 Rikthimin e mjetit lundrues.

5. Në rastet e dënimit me gjobë një kopje e vendimit, sipas modelit nr. 2, i dorëzohet kundërvajtësit kundrejt firmës dhe pretendimeve të tij, një kopje i dorëzohet Sektorit të Financës në komisariatin/drejtorinë e kufirit dhe migracionit dhe kopja e tretë qëndron në fletën e bllokut të gjobave në stacionin e Policisë Kufitare.

5.1 Pagesa e gjobës bëhet brenda 5 (pesë) ditëve dhe për çdo ditë vonese, deri në një muaj, aplikohet kamatëvonesë në masën 2% të gjobës.

5.2 Administrimi i vendimit për vendosjen e gjobës dhe kryerja e veprimeve të kontabilitetit në regjistrat përkatës kryhen sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

6. Për shpenzimet e ndërhyrjes, të transportit, të parkimit dhe të zhbllokimit të mjetit lundrues, të kryera nga policia, aplikohen tarifat e përcaktuara sipas pikave 4 dhe 5, të urdhrit nr. 35, datë 5.2.2016, "Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Policia e Shtetit", të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

7. Punonjësi i policisë, për rastet kur dispozita e shkelur parashikon masën e bllokimit administrativ të mjetit lundrues ose të mjeteve të tjera që kanë shërbyer për transportin e tyre, bën shoqërimin e mjetit lundrues në pikën e bllokimit të tyre dhe përpilon procesverbalin e dorëzimit të mjetit lundrues, sipas modelit nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7.1 Procesverbali, sipas pikës 7 të udhëzimit, përpilohet në 3 (tri) kopje, një kopje i dorëzohet kundërvajtësit, një kopje qëndron në pikën e bllokimit dhe kopja e tretë dorëzohet brenda ditës në stacionin e Policisë Kufitare.

7.2 Mjeti i bllokuar, me vendim sipas modelit nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi, lihet në ruajtje në pikën e bllokimit të mjeteve lundruese, kundrejt konfirmimit të marrjes në dorëzim nga punonjësi i policisë, deri në përfundim të procedurave të marrjes së vendimit përfundimtar. Kur vendimi përfundimtar është dënimi me gjobë, mjeti mbahet i bllokuar deri në likuidimin e vlerës së gjobës.

7.3 Për evidentimin e mjeteve lundruese të bllokuara, në pikën e bllokimit krijohet një regjistër i veçantë i sekretuar.

8. Mjetet lundruese të bllokuara zhbllokohen me marrjen e vendimit, sipas modelit nr. 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi, nga shefi i stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, pas verifikimit për përmbushjen e detyrimeve, si më poshtë:

a) plotësimin e afatit dhe përmbushjen e detyrimeve duke bërë shënimet në regjistrin përkatës;

b) likuidimin e detyrimeve financiare si:

i. vlera e gjobës së përcaktuar në procesverbalin përkatës;

ii. shpenzimet e ndërhyrjes;

iii. shpenzimet e transportit (vetëm në rastet kur veprimi është kryer me mjetet e policisë);

iv. shpenzimet e parkimit.

8.1 Në pikën e bllokimit të mjeteve lundruese punonjësi i policisë përpilon në dy kopje procesverbalin për rikthimin e mjetit, sipas modelit nr. 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi, nga të cilat një kopje i jepet subjektit, ndërsa kopja tjetër i bashkëlidhet dokumenteve të mjetit lundrues, të cilat janë pjesë e arkivit të stacionit të Policisë Kufitare.

9. Në raste të veçanta, me urdhër të drejtorit të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, mjeti lundrues lihet në ruajtje në venddislokimin e mjeteve lundruese të Policisë Kufitare.

10. Zyra e regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare, në rast të konstatimit të shkeljes së afateve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 8 dhe në pikën 3, të nenit 9, njofton Policinë Kufitare për vijimin e procedurave të vënies së sanksionit administrativ të

përcaktuar në nenin 14, të ligjit. ZRMLD-ja bën regjistrimin e mjetit lundrues, pas depozitimit të dokumentit vërtetues të shlyerjes së masës administrative me gjobë të vendosur nga oficeri i Policisë Kufitare.

11. Kur konstatohen shkelje në fabrikat, kantieret detare, ofiçinat e prodhimit dhe riparimit të mjeteve lundruese, referuar germës "ë", të pikës 1 dhe 3, të nenit 14 të ligjit, shefi i stacionit të Policisë Kufitare merr vendim bazuar në procesverbalin e konstatimit të shkeljes, sipas modelit nr. 7 dhe 8, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

12. Në rastet e dënimit me gjobë një kopje e vendimit për vendosjen e gjobës i dorëzohet kundërvajtësit kundrejt firmës dhe pretendimeve të tij, një kopje i dorëzohet Sektorit të Financës në komisariatin/drejtorinë e kufirit dhe migracionit dhe kopja e tretë qëndron në fletën e bllokut të gjobave në stacionin e Policisë Kufitare.

13. Në zbatim të pikës 3, të nenit 14 të ligjit, dënimi me gjobë mund të shoqërohet me masën plotësuese të mbylljes së fabrikës/kantierit detar/ofiçinës nga 30 (tridhjetë) deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

14. Kryerja nga mjeti lundrues i një veprimtarie të kundërligjshme, sipas rasteve të përcaktuara në shkronjën "h", të pikës 1, të nenit 14, të ligjit, shefi i stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit merr vendim, sipas modelit nr. 9, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

KREU IV
ANKIMIMI ADMINISTRATIV

1. Për vendosjen e masave administrative, kundërvajtësi mund të bëjë ankim në drejtorinë vendore për kufirin dhe migracionin, brenda 30 ditëve nga dita e nesërme e marrjes në dijeni të vendosjes së masës administrative.

2. Ndaj vendimit të marrë nga drejtoria vendore për kufirin dhe migracionin kundërvajtësi mund të bëjë ankim në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e marrjes në dijeni të tij.

3. Ndaj vendosjes së masës administrative të konfiskimit, sipas shkronjës "h", të pikës 1, të nenit 14 të ligjit, kundërvajtësi mund të bëjë ankim në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e marrjes në dijeni.

4. Ndaj vendimeve të marra kundërvajtësi mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Dokumentet e përpiluara për masa administrative, për shkeljet që bëhen me mjetet lundruese, ruhen 1 (një) vit pas përfundimit të ekzekutimit të vendimit.

2. Mjetet lundruese objekt i këtij udhëzimi, kur kalojnë në favor të shtetit dorëzohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi Drejtoria e Përgjithshme Detare njoftohet për mjetet që sekuestrohen.

3. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 314, datë 29.5.2018, "Për mënyrën e regjistrimit, përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese", shfuqizohet.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit drejtoritë vendore të kufirit dhe migracionit dhe drejtoritë vendore të policisë dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Model nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000
Nr. regj._____ _____, më ___.___.2021.

PROCESVERBAL

I KONSTATIMIT TË SHKELJES

(Punonjësi PSH)

Data __, muaji ___, viti _____, ora _____, Sektori _____, vendi _____ .
Unë i nënshkruari _____ konstatova se kundërvajtësi:
_____, adresa: _____
(emër, mbiemër)
Lloji i mjetit _____, tipi _____, emri_____ nr. matrikullit: _____, sasia e motorëve _____.
Me pronar të mjetit _____, adresa _____,
ose fabrika/kantieri detar/ofiçina pronë e shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____,
(emër, mbiemër)
ka shkelur ligjin nr. 127, datë 15.10.2020, neni _____
_____
_____

Kundërvajtësi deklaron: _____
_____
_____
_____

Për shkeljet e konstatuara propozoj:

Sanksioni: Të gjobitet me _____ (_____) lekë.

Sanksione plotësuese: Bllokim administrativ

Kundërvajtësi të paraqitet _____ ora _____, data ___. ___. _____.

Kundërvajtësi	**Përpiluesi i procesverbalit**
(_____)	(_____)
(emër, mbiemër, firma)	*(grada, emër, mbiemër, firma)*

Model nr. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000 _____, më ___.___.2021.
Nr. regj._____

VENDIM

PËR VENDOSJEN E MASËS ADMINISTRATIVE GJOBË

Në _____, viti _____, muaji _____, data ___, ora _____,
unë i nënshkruari _____Shefi i Stacionit/Komisariatit të Policisë
(grada, emër, mbiemër)
Vendore të KM _____; pasi u njoha me procesverbalin e konstatimit të shkeljes nr. ____, datë __.__._____,

Kundërvajtësi deklaron: _____
_____
_____
_____

VENDOSA:

Për shkeljet e konstatuara:
Sanksioni: Të gjobitet me _____ (_____) lekë.
Sanksione plotësuese:

1. Heqjen e dëshmisë së aftësisë për drejtimin e mjetit lundrues për 60 ditë;
2. Shpenzime ndërhyrjeje _____ (_____) lekë;
3. Shpenzime transporti_____ (_____) lekë;
4. Shpenzime për ruajtje për ditë qëndrimi (_____) lekë;
5. Shpenzime për bllokimin _____ (_____) lekë;
6. Shuma e detyrimit_____ (_____) lekë;

Kundërvajtësi të paraqitet _____ ora _____, data ___. ___. _____.

Kundërvajtësi
(_____)
(emër, mbiemër, firma)

Shefi i Stacionit/Komisariatit të PKM-së
(_____)
(grada, emër, mbiemër, firma)

Model nr. 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000
Nr. regj._____

_____, më ___.___.2021.

VENDIM

PËR BLLOKIMIN ADMINISTRATIV TË MJETIT LUNDRUES

Në _____, viti _____, muaji _____, data ___, ora _____,
unë i nënshkruari _____ oficer i Policisë Kufitare pranë Drejtorisë
(grade, emër, mbiemër)
Vendore të KM-së_____; pasi u njoha me procesverbalin e konstatimit të shkeljes nr. ____, datë __.__._____,

VENDOSA:

Të bëjë bllokimin administrativ të mjetit lundrues tip _____, lloji _____, emri _____, nr. matrikulli: _____, sasia e motorëve _____, me nr. _____ dhe _____, gjatësia _____, pronë e shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____.
Mjeti bllokohet administrativisht për _____ ditë, për arsye se drejtuesi i tij _____ i vitlindjes _____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____ ka shkelur me këtë mjet ligjin nr. 127, datë 15.10.2020, neni 14, germat: "b"; "c"; "ç"; dhe "d", _____.

Së bashku me mjetin lundrues të lartpërmendurit i bllokohen dhe sendet e poshtëshënuara:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____

Procesverbali mbyllet me numër rendor _____.

Pronari (drejtuesi i mjetit)
(_____)
(emër, mbiemër, firma)

Shefi i Stacionit të PKM-së
(_____)
(grada, emër, mbiemër, firma)

Model nr. 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000
Nr. regj._____

_____, më ___.___.2021.

PROCESVERBAL

PËR DORËZIMIN E MJETIT LUNDRUES NË PIKËN E BLLOKIMIT

I mbajtur sot më datë ___.___._____, pranë pikës së bllokimit _____, për dorëzimin e mjetit lundrues tip _____, lloji _____, emri _____, nr. matrikulli: _____, sasia e motorëve _____, numrat e motorëve: 1) _____ dhe 2) _____ gjatësia _____, ngjyra _____, në pronësi të _____, në përdorim të _____.

Mjeti lundrues dorëzohet sipas inventarit të mëposhtëm:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

Marrësi në dorëzim

_____
(grada, emër, mbiemër, firma)

Dorëzuesi

_____
(grada, emër, mbiemër, firma)

Pronari i mjetit lundrues

_____
(emër, mbiemër, firma)

Model nr. 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. regj._____ _____, më __.__.2021.

VENDIM

PËR ZHBLLOKIMIN E MJETEVE LUNDRUESE

_____

Mjeti lundrues tip _____, lloji _____, emër _____, nr. matrikulli: _____, të zhbllokohet pasi plotësoi afatin dhe likuidoi detyrimet financiare.

Shefi i Stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit _____
(grada, emër, mbiemër, firma)

Model nr. 6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. regj._____ _____, më ___.___.2021.

PROCESVERBAL

PËR RIKTHIMIN E MJETIT LUNDRUES

Procesverbal i mbajtur sot më datë ___.___.___, në pikën e bllokimit të mjeteve lundruese _____, për zhbllokimin e mjetit lundrues të tipit _____, lloji _____, emri _____, nr. matrikullit: _____, me ____ motor/ë, me nr. motori _____ dhe _____, në pronësi të _____.

Mjeti lundrues i dorëzohet pronarit sipas inventarit të mëposhtëm:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

Mbyllet me nr. rendor ____ (_____).

DORËZUESI

_____
(grada, emër, mbiemër, firma)

MARRËSI NË DORËZIM

_____
(emër, mbiemër, firma)

Model nr. 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000
Nr. regj._____ _____, më ___.___.2021.

VENDIM

PËR VENDOSJEN E MASËS ADMINISTRATIVE GJOBË
PRONARIT TË FABRIKËS OSE KANTIERIT DETAR

Në _____, viti _____, muaji _____, data _____.
Unë _____ punonjës policie pranë Drejtorisë Vendore të KM-së
(grada, emër, mbiemër)
_____, në përputhje me nenin 188, të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 127, datë 15.10.2020, pasi bëra verifikimin e ngjarjes dhe të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, plotësuar nga punonjësi i policisë _____,

VENDOSA:

Masën administrative ndaj pronarit të fabrikës (ofiçinës, kantierit) _____, shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në _____,
Me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____.

Pronari i fabrikës/kantierit detar/ofiçinës, në shkelje të nenit 10, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 127, datë 15.10.2020, si dhe bazuar në nenin 14, germa "ë", të tij, gjobitet me _____, _____.

Pronari i fabrikës
(_____)

Shefi i Stacionit/Komisariatit të PKM-së
(_____)
(grada, emër, mbiemër, firma)

(Model nr. 8)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000
Nr. regj._____ _____, më ___.___.2021

VENDIM

PËR VENDOSJEN E MASËS ADMINISTRATIVE MBYLLJE TË AKTIVITETIT TË FABRIKËS/KANTIERIT DETAR/OFIÇINËS

Në _____, viti _____, muaji _____, data _____, unë _____
(grade, emër, mbiemër)
Shefi i Stacionit/Komisariatit të Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit.
_____, në përputhje me nenin 188, të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 127, datë 15.10.2020, pasi bëra verifikimin e ngjarjes dhe të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, plotësuar nga punonjësi i policisë _____,

VENDOSA:

Mbylljen e aktivitetit të fabrikës (ofiçinës, kantierit detar) _____, pronë e shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____.

Fabrika (kantieri detar, ofiçina) të mbyllë aktivitetin për _____ ditë, në raste të përsëritjes së shkeljes nga pronari i saj, të nenit 10, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 127, datë 15.10.2020, si dhe bazuar në pikën 3, të nenit 14, të këtij ligji.

Kundër kësaj mase administrative pronari i objektit të bllokuar ka të drejtë ankimimi sipas akteve ligjore.

Pronari i fabrikës
(_____)

Shefi i Stacionit/Komisariatit në PKM
(_____)
(grada, emër, mbiemër, firma)

Model nr. 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000
Nr. regj._____ _____, më ___.___.2021.

VENDIM

PËR VENDOSJEN E MASËS ADMINISTRATIVE KONFISKIM TË MJETIT LUNDRUES

Në _____, viti _____, muaji _____, data _____,
Unë _____ punonjësi i policisë pranë Drejtorisë Vendore të KM _____,
(grada, emër, mbiemër)
në përputhje me nenin 14, pika 1, germa "h", të ligjit nr. 127, datë 15.10.2020, pasi bëra verifikimin e ngjarjes dhe të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, plotësuar nga punonjësi i policisë _____,

VENDOSA:

Masën administrative të konfiskimit ndaj mjetit lundrues me pronarë/bashkëpronarë, drejtues mjeti lundrues _____, shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____, të mjetit _____ me nr. matrikulli _____, me ___motor/ë me KF_____, me nr. serie _____.

Pronari/bashkëpronari, drejtues i mjetit lundrues, _____ me nr. regjistrimi detar/ofiçinës, në shkelje të nenit 14, pika 1, germa "h", të ligjit nr. 127, datë 15.10.2020, të bëhet konfiskimi i mjetit lundrues.

Kundër këtij vendimi shtetasi ka të drejtë të ndjekë rrugët e ankimimit në organet e drejtësisë.

Pronari/b/pronari, drejtues i mjetit lundrues
(_____)

Shefi i Stacionit/Komisariatit të PKM-së
(_____)
(grada, emër, mbiemër)

UDHËZIM
Nr. 13, datë 9.7.2021

PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2021 DHE TË MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2021

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 26 dhe të nenit 51, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2021, sesioni i dytë, të jenë:

a) Gjuhë e huaj	24 gusht 2021
b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi	27 gusht 2021
c) Matematikë	31 gusht 2021
ç) Provimi me zgjedhje	3 shtator 2021

2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të jenë:

a) Gjuhë e huaj	24 gusht 2021
b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi	27 gusht 2021
c) Matematikë	31 gusht 2021
ç) Teori profesionale e integruar	3 shtator 2021

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore, miratuar me urdhrin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë:

a) Fillojnë në orën 10:00.

b) Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.

c) Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:

a) Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i parë.

b) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2020–2021 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 17 gusht 2021.

c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2020, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021.

ç) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, që kanë të njësuar dokumentet shkollore nga QSHA-ja dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021.

6. Kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronjat "c" dhe "ç" të këtij udhëzimi, të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar/Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (këtu e në vijim "DRAP/ZVAP") në vendbanimet e tyre.

7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja "b", "c" dhe "ç", të këtij udhëzimi, të plotësojnë formularin AlZ, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë. Këta kandidatë të plotësojnë formularin A1Z, në datat 18–20 gusht 2021.

8. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar të dërgojë zyrtarisht në ZVAP, listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, deri më datë 18 gusht 2021. Drejtori i ZVAP-së, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 18 gusht 2021.

9. Provimet të zhvillohen të përqendruara në ZVAP. ZVAP-të të përcaktojnë qendrat dhe mjediset ku maturantët/kandidatët do të zhvillojnë provimin, duke mundësuar përqendrimin e tyre, sipas kushteve dhe numrit të maturantëve/ kandidatëve.

10. ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare, të marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, qendrën dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës

Shtetërore 2021 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë.

11. Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, brenda datës 16 gusht 2021, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021, sesioni i dytë, dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar njofton për këto qendra dhe mjedise Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).

12. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MASR-së dhe të institucioneve të varësisë.

13. Shpenzimet e përfaqësuesve të MASR-së në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, sipas dispozitave në fuqi.

14. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 183/4, datë 20.5.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, "PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe të vendimit të Komitetit Teknik nr. 1594/9, datë 5.5.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi "deri në datën 20.5.2021" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në një urdhër të dytë".

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 183/5, datë 14.6.2021

PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, "PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të

Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 2435, datë 27.5.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar, bëhet një ndryshim dhe disa shtesa si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, hiqet togfjalëshi "apo të hapura, konferencat" .

2. Pas pikës 1, shtohen pika 1/1 dhe pika 1/2 me përmbajtje si vijon:

"1/1. Ndalohen grumbullimet me më shumë se 50 persona në vende të hapura, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore nga data 15.6.2021 deri në datën 28.6.2021. Grumbullimet sipas kësaj pike të respektojnë masat e distancimit social dhe protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

1/2. Lejohen konferencat me kapacitet të reduktuar deri në 30% të pjesëmarrësve dhe në zbatim të protokollit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik nga datë 1.7.2021. ".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 349, datë 26.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, "PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 3221 prot., datë 19.7.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

l. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi "deri në datën 26.7.2021", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në datën 9.8.2021".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 134, datë 21.7.2021

PËR NDRYSHIMIN E REFERENCËS LIGJORE NË STANDARDET KOMBËTARE TË KONTABILITETIT TË PËRMIRËSUARA

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit",

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të referencës ligjore në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

2. Ndryshimi i referencës ligjore në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara e shtrin efektin që në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", në datën 1 janar 2019.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

SKK 1 "KUADRI I PËRGJITHSHËM PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE" - I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1, 2, 7 dhe 40. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 1 *Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare* (SKK1 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është të japë parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare si dhe konceptet dhe rregullat-bazë për zbatimin e politikave kontabël, të vlerësimeve, të korrigjimit të gabimeve dhe paraqitjen e ngjarjeve ekonomike, pas datës së mbylljes së pasqyrave financiare të përgatitura në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin ~~Nr. 922825~~/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në ~~prill 2004~~maj 2018~~, i ndryshuar~~.
2	Kërkesat e SKK 1 i përmirësuar korrespondojnë me paragrafë të veçantë të SNRF-ve për NVM (2009). Standardi bazohet kryesisht në Seksionin 2 - *Konceptet dhe Parimet e Përhapura Gjerësisht.* Standardi gjithashtu mbështetet në Seksionin 10 – *Politikat Kontabël, Vlerësimet dhe Gabimet* dhe në Seksionin 31 - *Ngjarjet pas Periudhës Raportuese.* Krahasimi i SKK 1 me SNRF për NVM-të (2009) është dhënë në paragrafin 131. Për rastet që nuk janë trajtuar nëpërmjet një politike të veçantë kontabël të SKK 1, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet të miratojnë një politikë të tillë që siguron një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, dhe fluksit të mjeteve monetare së njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9-~~11 të Ligjit për Kontabilitetin~~ Nr. 9228~~.
	FUSHA E ZBATIMIT
7	Paraqitja e vërtetë dhe e besueshme nënkupton që: (a) parimet-bazë dhe kërkesat e tjera, të paraqitura ~~nga neni 9 deri në 12 të~~në ~~Ligjit~~ Ligjin ~~të~~ e Kontabilitetit ~~Nr. 9228,~~ si dhe paragrafët 40-90 të standardit, janë përdorur si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare; (b) aktivet, detyrimet , kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi neto, të paraqitura në pasqyrat financiare, përmbushin kriteret e përkufizimeve të dhëna në këtë standard.
	PARIMET BAZË PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE
40	~~Neni 10 i~~ Ligji~~t~~ ~~të~~ për ~~Kontabilitetit~~ Kontabilitetin ~~Nr. 9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"~~ përcakton parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Paragrafët 40 deri 90 të këtij standardi përshkruajnë këto parime-bazë. Asnjë nga paragrafët e këtij seksioni (paragrafët 40 deri 90) nuk kanë përparësi ndaj ndonjë kërkese specifike të paragrafëve të tjera të SKK 1 ose ndonjë SKK-je tjetër.

SKK 2 "PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE" – I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1, 2, 25, 28, dhe 36. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVAT DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 2 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (SKK 2 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është të japë konceptet dhe rregullat-bazë për paraqitjen e informacionit financiar në pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9-22825~~ "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 2 mbështetej në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK 1) *Paraqitja e pasqyrave financiare,* SNK 7 *Pasqyra e fluksit të parasë* dhe SNK 24 *Shpjegimet mbi palët e lidhura*. Kërkesat e SKK 2 të përmirësuar korrespondojnë me disa paragrafë të SNRF për NVM-të (2009). Standardi bazohet në: Seksioni 3 – *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* Seksioni 4 – *Pasqyra e Pozicionit Financiar* Seksioni 5 - *Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse dhe Pasqyra e të Ardhurave* Seksioni 6 - *Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto dhe Pasqyra e të ardhurave dhe fitimeve të pashpërndara* Seksioni 7- *Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare* Seksioni 8 - *Shënimet e pasqyrave financiare.* Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2009), paraqitet në paragrafin 99. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 2 i përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, ndryshimeve në pozicionin financiar dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9-~~11 të Ligjit ~~nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar~~për kontabilitetin.
	PËRMBAJTJA E PASQYRAVE FINANCIARE DHE KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR PËRGATITJEN E TYRE
25	Në përputhje me kërkesat e Ligjit ~~nr. 9228, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar~~për kontabilitetin, pasqyrat financiare paraqiten në lekë, duke treguar shkallën e rrumbullakimit të shifrave (për shembull, në mijë lekë)
28	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një set të plotë të pasqyrave financiare (duke përfshirë informacionin krahasues (shih paragrafin 19) të paktën ~~çdo~~ një herë në vit, siç kërkohet nga ~~neni 14 i Ligjit nr. 9 228, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~Ligji për kontabilitetin. Kur fundi i periudhës raportuese të një njësie ekonomike ndryshon dhe pasqyrat financiare vjetore paraqiten për një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër se sa një vit, njësia ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese në vijim: (a) faktin në vetvete; (b) arsyen për të përdorur një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër; (c) faktin që shumat krahasuese të paraqitura në pasqyrat financiare (duke përfshirë edhe shënimet përkatëse) nuk janë plotësisht të krahasueshme.
	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
	Rregulla të Përgjithshme
	Formate të veçanta të pasqyrës së pozicionit financiar
36	Nëse njësia ekonomike zgjedh një format tjetër të pasqyrës së pozicionit financiar nga ai i dhënë në shtojcën 1 të këtij Standardi, drejtuesit e kësaj njësie duhet të zgjedhin një format, i cili jep një pamje të vërtetë e të besueshme, referuar në nenin ~~9-~~11 të Ligjit ~~nr. 9 228, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin. Institucionet shtetërore duhet të zbatojnë kërkesat e rregullave të përgjithshme të kontabilitetit publik.

SKK 3 "INSTRUMENTET FINANCIARE" - I PËRMIRËSUAR	
	Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 3 *Instrumentet financiare* (SKK 3 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të instrumenteve financiare si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9228.~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në ~~prill 2004~~maj 2018~~., i ndryshuar.~~
2	SKK 3 mbështetej në standardin ndërkombëtar të kontabilitetit SNK 32 *Instrumentet financiare: paraqitja* dhe SNK 39 *Instrumentet financiare: njohja dhe matja*. SKK 3 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 11 *Instrumentet Financiare Bazë* të SNRF për NVM-të (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të SNRF për NVM-të (2009) është dhënë në paragrafin 45. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 3 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228. "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 4 "INVENTARËT" – I PËRMIRËSUAR	
	Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 4 *Inventaret* (SKK 4 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të inventarëve si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9228.~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në ~~prill 2004~~maj 2018~~., i ndryshuar~~.
2	SKK 4 mbështetej në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, SNK 2 *Inventarët.* SKK 4 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 13 – *Inventarët* SNRF për NVM (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafeve të Standardit me paragrafe të SNRF për NVM (2009) është dhënë në paragrafin 36. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 4 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë një politikë të atillë që siguron një pasqyrim të vërtetë dhe të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësisë ekonomike siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", nxjerrë në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 5 "AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE" - I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 5 *Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale* (SKK 5 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9 228~~25, ~~datë 29.04.2004,~~ "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" publikuar në ~~prill 2004~~maj 2018~~, i ndryshuar~~.
2	SKK 5 mbështetej në një numër standardesh ndërkombëtare të kontabilitetit, përfshirë SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale*, SNK 38 *Aktive jomateriale*, SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve*, SNK 23 *Kostot e huamarrjes* dhe SNRF 5 *Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe operacionet e vijueshme*. **SKK 5 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 16 *Aktivet afatgjata materiale të investuara*, Seksionin 17 *Toka, Ndërtesa, Makineri dhe Pajisje*, Seksionin 18 *Aktivet afagjata jomateriale përveç emrit të mirë*, Seksionin 25 *Kostot e huamarrjes*, Seksionin 27 *Zhvlerësimi i aktiveve*, të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM- të (2009).** Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2009), është dhënë në paragrafin 117. Për rastet, të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 5 e përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe të ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 6 "PROVIZIONET, DETYRIMET DHE AKTIVET E KUSHTËZUARA" - I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 6 *Provizionet, aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara* (SKK6 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të provizioneve, aktiveve dhe detyrimeve të kushtëzuara si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9228,~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 6 mbështetej në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 37 *Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara*. SKK 6 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 21 *Provizionet dhe detyrimet e kushtëzuara* të SNRF për NVM-të (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të SNRF për NVM-të (2009) është dhënë në paragrafin 50. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 6 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228. "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 7 "KONTABILIZIMI I QIRAVE" – I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 7 *Kontabilizimi i qirave* (SKK 7 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të qirave si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin Nr. ~~9228~~ 25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në ~~prill 2004~~maj 2018~~, i ndryshuar~~.
2	SKK 7 mbështetej në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, SNK 17 *Qiratë* dhe shpjegimet e Komitetit të Interpretimit të Standardeve SIC 15. SKK 7 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 20 *Qiratë* të SNRF për NVM(2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM(2009) është dhënë në paragrafin 48. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 7 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësisë ekonomike , siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9 228 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 8 "TË ARDHURAT" – I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 8 *Të ardhurat* (SKK 8 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm në lidhje me të ardhurat nga shitja e mallrave, shërbimeve, interesat, dividendët, shfrytëzimi i pronës dhe kontratat e ndërtimit, në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9 228, datë 29.04.2004,~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 8 mbështetej në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, SNK 11, *Kontratat e ndërtimit* dhe SNK 18, *Të ardhurat*. SKK 8 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 23 – *Të ardhurat* të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM-të (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të *SNRF për NVM-të* (2009) është dhënë në paragrafin 51. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 8 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9 228, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 9 "KOMBINIMET E BIZNESEVE DHE KONSOLIDIMI" – I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 9 *Kombinimet e biznesit dhe konsolidimi* (SKK9 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes, vlerësimit të mëpasshëm, paraqitjes si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare për kombinimet e bizneseve dhe njësitë e kontrolluara, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9228,~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 9 mbështetej në standardin ndërkombëtar të raportimit financiar SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*. SKK 9 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 9 *Pasqyrat e konsoliduara dhe të veçanta* dhe Seksionin 19 *Kombinimet e biznesit dhe emri i mirë* të të SNRF për NVM-të (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të SNRF për NVM-të (2009) është dhënë në paragrafin 65. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 9 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228. "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 10 "GRANTET DHE FORMA TË TJERA TË NDIHMËS" – I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 10, *Grantet dhe forma të tjera të ndihmës* (SKK 10 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të granteve dhe formave të tjera të ndihmës në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin ~~N~~nr. ~~9228,~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 10 mbështetej në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, SNK 20 *Kontabiliteti i granteve qeveritare dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për ndihmën qeveritare*. SKK 10 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 24 – *Grantet qeveritare* të SNRF për NVM (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit Kombëtar me paragrafë të SNRF për NVM (2009) është dhënë në paragrafin 17. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 10 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare të kapitalit të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9 228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 11 "TATIMI MBI FITIMIN" – I PËRMIRËSUAR	
	Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 11 *Tatimi mbi fitimin* (SKK 11 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të tatimit mbi fitimin si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9 228, datë 29.04.2004,~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 11 mbështetej në standardin ndërkombëtar të kontabilitetit SNK 12, *"Tatimi mbi të ardhurat"*. SKK 11 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 29 *Tatimi mbi të ardhurat* të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM-të (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2009) është dhënë në paragrafin 43. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 11 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar.~~për kontabilitetin.

SKK 12 "EFEKTI I NDRYSHIMEVE TË KURSEVE TË KËMBIMIT" – I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 12 *Efekti i kurseve të këmbimit* (SKK12 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes e vlerësimit të mëpasshëm të transaksioneve në monedhë të huaj si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9228,~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 12 mbështetej në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 21, *"Efektet e ndryshimit në kurseve të këmbimit"*. SKK 12 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 30 *Përkthimi i Monedhës së Huaj* të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Njësitë e vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të standardit me paragrafë të SNRF për NVM është dhënë në paragrafin 38. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 12 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228. "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 13 "AKTIVET BIOLOGJIKE DHE MARRËVESHJET KONÇESIONARE" – I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 13 *Aktivet Biologjike dhe Marrëveshjet koncesionare* (SKK 13 i përmirësuar) miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm për aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin ~~Nr~~nr. ~~9228~~ 25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 13 mbështetej në SNK 41, *Bujqësia.* SKK 13 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 34 *Aktivitetet e Specializuara* të SNRF për NVM (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM-të (2009) është dhënë në paragrafin 35. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 13 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare së njësisë ekonomike raportuese, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

SKK 14 "TRAJTIMI KONTABËL I INVESTIMEVE NË PJESËMARRJE DHE SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA" – I PËRMIRËSUAR	
Janë ndryshuar paragrafët 1 dhe 2. Fjalët me vizë në mes fshihen. Fjalët me vizë poshtë shtohen.	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 14 *Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta* (SKK 14 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është të vendosë rregullat e kontabilizimit dhe të paraqitjes së pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuara në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9 228, datë 29.04.2004,~~25 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~maj 2018.
2	SKK 14 mbështetej në standardin ndërkombëtar të kontabilitetit SNK 27, *"Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale", SNK 7, "Pasqyrat e fluksit monetar",* SNK 28, *"Investime në pjesëmarrje",* SNK 21, *"Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit"* dhe interpretimin SIC 12 *Konsolidimi, njësitë ekonomike për qëllime të veçanta.* SKK 14 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 14 *"Investimet në pjesëmarrje"* dhe Seksionin 15 *"Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta"* të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM-të (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2009) është dhënë në paragrafin 33. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 14 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese, siç kërkohet në nenin ~~9~~ 11 të Ligjit ~~nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar~~për kontabilitetin.

URDHËR
Nr. 139, datë 29.7.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Bazuar në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Emis Çerava, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për çështjet e mëposhtme:

1.1 Delegim i kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për kryerjen e të gjitha procedurave të prokurimit publik për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

1.2 Nënshkrimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim të punonjësve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë jashtë qendrës së punës, brenda vendit në largësi mbi 100 km, si dhe ato për jashtë territorit të Shqipërisë.

1.3 Nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësim ligjor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emër të personit që do të përfaqësojë Këshillin e Lartë të Prokurorisë në procese gjyqësore.

1.4 Përfaqësimi ligjor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në proceset gjyqësore, sipas pikës 1.3 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedurial, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqiprisë" i ndryshuar, dhe ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

2. Delegimi i kompetencave përfundon në datën 1.8.2022.

3. Ngarkohet z. Emis Çerava, Sekretar i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

KËRKESË

Shtetasja Enkeleda Ndini kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Ilir Paskal Ndini, i datëlindjes 29.7.1970 , lindur dhe banues në Tiranë.

KËRKUES
Enkeleda Ndini

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 120
Datë: 2021/07/30 14:20:57
fdff0a09-1a1e-4de0-9d4f-896bdf583571

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 416 lekë